

BIBLIOTEKA

8
B. 12



PJETER BOGDANI
DHE VEPRA E TIJ

1374

AKADEMIA E SHKENCAVE E REPUBLIKËS
TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PIETER BOGDANI
DHE VEPRA E TIJ



TIRANË, 1991

REDAKSIA

PROF. ANDROKLI KOSTALLARI (red. përgjegjës),
B. VJ. SHK. SEIT MANSAKU, XHELAL YLLI

DY FJALË PËR LEXUESIN

Në këtë vëllim botohen në një formë të plotë referatet dhe kumtesat që u mbajtën në Konferencën shkencore përkujtimore me temë Pjetër Bogdani dhe vepra e tij, organizuar më 6 dhjetor 1989 nga Akademia e Shkencave të Republikës të Shqipërisë me rastin e 300-vjetorit të vdekjes të këtij atdhetari dhe personaliteti të shquar të kulturës shqiptare.

Nëpërmjet përmbajtjes së larmishme të këtij vëllimi lexuesi do të njihet me figurën dhe veprën poliedrike të Pjetër Bogdanit, si lëvrues dhe përpunues i gjuhës letrare shqipe, si përfaqësuesi më i shquar i letërsisë së vjetër shqiptare, si pjesëmarrës dhe udhëheqës guximtar në lëvizjen çlirimtare për liri e pavarësi në shekullin XVII, si mendimtar e filozof humanist e iluminist, si një nga mendimtarët e parë shqiptarë, që shprehu mendime të vlefshme shkencore për natyrën, shoqërinë e për njeriun, për kulturën, arsimin e edukatën, për pedagogjinë dhe psikologjinë dhe në mënyrë të veçantë, për historinë, jetën e përpërimin e popullit tonë.

Jemi të bindur se punimet që botohen në këtë vëllim, ashtu edhe të gjitha veprimtaritë e tjera që u zhvilluan me rastin e 300 vjetorit të vdekjes së Pjetër Bogdanit sjellin ndihmesa të reja për njohjen më të thelluar shkencore të jetës e të veprës së Pjetër Bogdanit. Ato mund t'u japin një shtysë të re studimeve të mëtejshme të kësaj vepre në disa rrafshet nga këndvështrime të ndryshme.

REDAKSIA

DEUX MOTS AU LECTEUR

Ce volume comprend la publication intégrale des rapports et communications tenus à la Conférence scientifique commémorative sur «Pjetër Bogdani et son œuvre», organisée le 6 décembre 1989 par l'Académie des Sciences de la République d'Albanie, à l'occasion du 300-ème anniversaire de la mort de ce patriote et personnalité illustre de la culture albanaise.

A travers le riche contenu de ce volume, le lecteur, prendra connaissance de la figure et de l'œuvre poliédrique de Pjetër Bogdani qui a élaboré et traité la langue littéraire albanaise, qui a été le plus illustre représentant de l'ancienne littérature albanaise, qui a été participant et brave dirigeant du mouvement pour la libération et l'indépendance au XVII^e siècle, comme l'un des premiers penseurs albanais ayant exprimé des pensées valables sur la nature, la société et l'homme, la culture, l'enseignement et l'éducation, sur la pédagogie et la psychologie et particulièrement sur l'histoire, la vie et le progrès du peuple albanais.

Nous sommes convaincus que les travaux publiés dans ce volume, ainsi que toutes les autres activités organisées à l'occasion du 300-ème anniversaire de la mort de Pjetër Bogdani, apportent de nouvelles contributions pour une connaissance plus approfondie et scientifique de sa vie et de son œuvre. Cela peut donner une nouvelle impulsion aux études ultérieures de cette œuvre sur plusieurs plans et partant de divers points de vue.

La rédaction

KONFERENCA SHKENCORE PËRKUJTIMORE ME TEMEN «PJETER BOGDANI DHE VEPRA E TIJ»

Me rastin e 300-vjetorit të vdekjes së atdhetarit dhe personalitetit të shquar të kulturës shqiptare Pjetër Bogdani Akademia e Shkencave të Republikës të Shqipërisë organizoi më 6 dhjetor 1989 konferencën shkencore përkujtimore me temën «Pjetër Bogdani dhe vepra e tij». Në këtë konferencë merrnin pjesë punonjës të instituteve të shkencave shoqërore të Akademisë së Shkencave, të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, pedagogë të Universitetit të Tiranës, punonjës të institucioneve të tjera shkencore, kulturore e arsimore të vendit, të ftuar nga seksionet e arsimeve të rretheve etj.

Konferencën e hapi zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave, prof. **Hekuran Mara**.

Me rastin e 300-vjetorit të vdekjes së Pjetër Bogdanit, këtij atdhetari të flaktë dhe personaliteti të shquar të kulturës shqiptare, Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë organizon sot konferencën shkencore përkujtimore: «Pjetër Bogdani dhe vepra e tij».

Në ato vite të rënda të zgjedhës osmane, kur pushtuesi i huaj aziatik përpiquej të çbënte çdo gjë shqiptare e t'i jepte vendit tonë një fizionomi tjetër dhe njerëzve një mendësi tjetër, më të prapambetur se ajo që ekzistonte, bijtë më të mirë të këtij populli u vunë në krye të përpjekjeve për t'i bërë ballë këtij ndikimi mbytës, të kulturës osmane, për të ruajtur lidhjet e lashta të kulturës arbënore me kulturën e kontinentit mëmë evropian.

Një nga këta bij të shquar është dhe Pjetër Bogdani, i cili ka hyrë në historinë tonë kombëtare si autori i së parës vepër origjinale në prozën tonë dhe njëherazi edhe si autori i veprës më të rëndësishme të periudhës para Rilindjes.

Ky djalë nga fshati Gur i Prizrenit me idetë e tij të kulturimit të popullit në gjuhën e vet amtare, me idetë humaniste dhe me punën e madhe për pastrimin e pasurimit e gjuhës shqipe u bë një pararendës i rilindësve tanë, të cilët jo vetëm e kanë lexuar, por dhe e kanë përmendur me respekt në shkrimet e tyre për idetë dhe për vlerat bujimore që kishte vepra e tij.

Kultura e gjerë që mori në rininë e vet e ndihmoi Bogdanin që të shkruante jo një vepër ngushtësisht fetare, po një vepër me frymëmarrje të gjerë filozofike e shkencore.

Me veprën e tij gjuha shqipe fitoi aftësi të reja shprehjeje e stili. «Çeta e profetëve», me karakterin origjinal që ka, me zhvillimin që shënoi në fushën e gjuhës së shkruar shqipe dhe me gjithë materialin e shumanshëm që përmban, shënoi një kthesë me rëndësi në fushën e gjuhës e të letërsisë sonë. Ajo shënoi fillimin e një etape të re, të etapës së krijimtarisë origjinale shqipe.

Me jetën e tij plot aktivitet në shërbim të përpjekjeve për çlirimin kombëtar dhe me veprën e tij «Çeta e profetëve», e cila përmban vlera të shumta gjuhësore, letrare, filozofike, historike etj., Pjetër Bogdani radhitet midis veprimtarëve e mendimtarëve më të shquar të shek. XVII të krejt Ballkanit,

Konferencën shkencore e deklaroj të hapur.

Në konferencë u mbajtën dhe gjashtë referate: Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe, nga prof. **Androkli Kostallari**, drejtor i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë; Pjetër Bogdani dhe lëvizja çlirimtare në shekullin e 17-të, përgatitur nga b.vj.shk. **Kristo Frashëri**; Pjetër Bogdani — humanisti ynë i shquar, nga prof. **Zija Xholi** Pjetër Bogdani dhe letërsia e vjetër shqipe nga prof. **Mahir Domi**; Vepra e Pjetër Bogdanit si burim për historinë e gjuhës shqipe nga b.vj.shk. **Seit Mansaku**; Pjetër Bogdani dhe mendimi i tij pedagogjik nga b.vj.shk. **Shefik Osmani**.

Fjalën e mbylljes së Konferencës e mbajti prof. **Androkli Kostallari**.

FJALA E MBYLLJES E PROF. ANDROKLI KOSTALLARIT

Konferenca jonë me temën «Pjetër Bogdani dhe vepra e tij», organizuar me rastin e 300-vjetorit të vdekjes së këtij patrioti të flaktë dhe personaliteti të shquar të kulturës sonë kombëtare, po u jep fund punimeve.

Organizimi i kësaj konference është shprehje e kujdesit të vazhdueshëm të shoqërisë sonë për traditat historike e kulturore të popullit tonë dhe e nderimit për ata njerëz të shquar e me zemër të zjarrtë shqiptare, që u përpoqën dhe luftuan me të gjitha forcat, pa marrë parasysh asnjë rrezik, për lirinë e pavarësinë e Atdheut, për t'i dhënë popullit dije e kulturë, për zhvillim e përparim shoqëror. Ky kujdes e nderim për traditat përparimtare, për bijtë e shquar të kombit është, pa dyshim, tregues i qartë i një shoqërie të përparuar, që i vë të gjitha vlerat e së kaluarës e të sotmes në shërbim të së ardhmes.

Nëpërmjet referateve që u mbajtën në këtë Konferencë u trajtua për herë të parë në mënyrë të gjerë e komplekse personaliteti dhe vepra poliedrike e Pjetër Bogdanit si lërvues e përpunues i gjuhës letrare shqipe e i letërsisë shqiptare; si pjesëmarrës e udhëheqës i patrembur në lëvizjen çlirimtare për liri e pavarësi në shekullin XVII, si mendimtar e filozof humanist e iluminist, si një nga dijetarët e parë shqiptarë që shprehu mendime të vlefshme shkencore për natyrën, shoqërinë e për njeriun, për kulturën, arsimin e

edukatën, për pedagogjinë e psikologjinë, dhe, në mënyrë të veçantë, për historinë, jetën e përparimin e popullit tonë.

Për të gjitha këto fusha të veprimtarisë së shuman-shme të Pjetër Bogdanit, Konferenca jonë bëri një sintezë të re të studimeve të kryera sidomos në këta njëzet vjetët e fundit. Aspektet e shumta të kësaj veprimtarie u panë nga këndvështrime të reja. Në dritën e kërkimeve, të vëzhgimeve e të analizave të reja, u sollën mjaft të dhëna që i pasurojnë studimet për Bogdanin e për shekullin e tij dhe u bënë përqaithësime që e përcaktojnë më qartë, më mirë e më objektivisht vendin që zë ku dijetar enciklopedik në kulturën e në historinë e popullit tonë. Krahas kësaj, në Konferencën tonë u përvijuan edhe disa drejtime që çelin rrugë për studime të mëtejshme, edhe më të thelluara. Të gjitha këto probleme Konferenca jonë u përpoq t'i trajtonte në dritën e kërkesave të shoqërisë sonë për vlerësimin e traditave të së kaluarës.

Një vend i veçantë iu dha përpiqieve viaane të Pietër Bogdanit për ajuhën e kombit e në mënyrë të veçantë për ndërtimin e lëvrimin e ajuhës letrare shqipe mbi bazën e ajuhës së popullit, për përpunimin e saj me synime normëzimi në fushën e strukturës fonetike, gramatikore, leksikore e fjalëformuese dhe me qëllimin e vetëdijen që kjo ajuhë t'u përqaithet kërkesave më të larta të kohës së re. Në këtë rrafsh të ajerë u vu në dukje sidomos kontributi i jashtëzakonshëm i Pietër Bogdanit për pasurimin e ajuhës letrare me fjalë e miqte shprehëse nga visari i pashtershëm i currës popullore, doli në pah më mirë se në studimet e derisotme veprimtaria e tij krijuese ajuhësore, e cila nga vëllimi e vështjësia relative mund të barazohet me atë të rilindësve tanë. Lidhur ngushtë me të gjitha këto, u përcaktuan në mënyrë të thukët edhe konceptet teorike që e udhëhoqën këtë dijetar të madh në këtë veprimtari kaq të rëndësishme.

Për herë të parë u hodh dritë edhe mbi punën e madhe krijuese të Bogdanit si stilist, duke e vështruar këtë punë si në aspektin e stilistikës ajuhësore, ashtu edhe të asaj letrare, si në rrafshin e prozës së larmishme, ashtu edhe në atë të vjershërimit origjinal në gjuhën shqipe e të përkthimeve poetike. Përpiqje të reja u bënë në këtë Konferencë sidomos për zbulimin e vlerave letrare-artistike të veprës

së Pjetër Bogdanit, të kontributit të këtij autori në përpunimin e pasurimin e figuracionit poetik. Të gjitha këto e plotësuan dhe e thelluan kuadrin e vlerësimeve të bëra deri më sot në veprat përgjithësuere të historisë së letërsisë shqiptare.

Larmia tematike, pasuria e mjeteve shprehëse, saktësia e vërtetësia e lëndës gjuhësore dhe shkalla e përpunimit të kësaj lënde e bëjnë veprën e Pjetër Bogdanit një burim të rëndësishëm edhe për studimin e historisë së gjuhës shqipe, për të njohur më thellë jo vetëm historinë e brendshme të saj, por edhe lidhjet e marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera në rrafshet e krahasuara.

Krahas Bogdanit si lëvrues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë shqiptare, u pa edhe Bogdani si atdhetar i flaktë, si pjesëmarrës e drejtues i lëvizjeve çlirimtare antiosmane dhe personalitet i madh i jetës politike shqiptare të shekullit XVII. Me të dhëna të reja u ndriçua veçanërisht roli i Bogdanit si udhëheqës i kryengritjes çlirimtare të vitit 1689, që përbën një faqe të ndritur në përpjekjet e popullit tonë për liri e pavarësi dhe në veprimtarinë e vetë Pjetër Bogdanit. Duke e vendosur figurën e Bogdanit në sfondin historik të lëvizjes çlirimtare të shekullit XVII, në një nga periudhat më të rënda të sundimit osman, u vunë në dukje përpjekjet e tij për të organizuar qëndresën antiosmane, ashtu edhe për të penguar orvatjet për sllavizimin e shqiptarëve të Kosovës. Në këto përpjekje, të frymëzuara nga dashuria e nderimi për atdheun e për popullin e vet, Pjetër Bogdani nuk ngurroi t'i kundërvihej drejtpërdrejt edhe Vatikanit.

Në këtë Konferencë u panë për herë të parë në mënyrë të përqëndruar e komplekse edhe konceptet e Pjetër Bogdanit si dijetar e filozof i shquar humanist e iluminist, që solli në mendimin shqiptar mjaft ide përparimtare për kohën e vet. Mendimi teologjik dhe filozofik i tij iu nënshtrua një analize të thelluar dialektike, duke nxjerrë në pah çdo element pozitiv që ka sjellë ai në fushën e filozofisë e të shkencave të natyrës, ashtu edhe në rrafshin pedagogjik e psikologjik.

Të gjitha këto këndvështrime, analiza e sinteza e bëjnë figurën e Pjetër Bogdanit më të qartë, më të njohur e më të dashur si për studiuesit, ashtu edhe për rrethet e gjëra të njerëzve të kulturës e për masat punonjëse, e afrojnë edhe

më shumë këtë dijetar poliedrik me kohën tonë, si një vlerë të shquar të traditave që integrohet e zë një vend të nderuar në gjithë kulturën përparimtare të popullit tonë.

Duke vënë në dukje kontributin e shumanshëm të Pjetër Bogdanit Konferenca tregoi gjithashtu se në ç'drejtime duhet studiuar më tej vepra e tij, si në fazën e tanishme, ashtu edhe në të ardhmen.

Është e qartë se në fushën e gjuhësisë del nevoja të bëhen objekt studimesh monografike disa aspekte të veprës «Çeta e profetëve», siç janë, p.sh.: evolucioni i gjuhës shqipe (sidomos i gjuhës letrare) e i kategorive të saj të veçanta nga Buzuku deri te Bogdani dhe nga ky i fundit deri në Rilindjen Kombëtare e më vonë në ditët tona; baza dialektore e gjuhës së «Çetës të profetëve», e parë qoftë në rrafshin e dialektologjisë historike, qoftë në ballafaqim me shkallët e përgjithësimeve a të normëzimeve mbidialektore në nënsistemet e ndryshme; përpjekjet e Bogdanit për të ruajtur pastërtinë e gjuhës shqipe e vlerat e saj të trashëguara prej shekujsh; drejtimet e rrafshet kryesore të pasurimit leksikor e frazeologjik të gjuhës letrare shqipe në «Çetën e profetëve»; fushat kryesore të terminologjisë së përpunuar nga Bogdani dhe veçoritë e kësaj terminologjie të parë njëkohësisht edhe si vijim i një tradite, edhe si zhvillim krijues cilësor i saj drejt terminologjisë së shekujve XIX-XX; diferencimet stilistike të mishëruara në «Çetën e profetëve» si përpjekje të vetëdijshme të autorit për ta përpunuar gjuhën letrare sipas kërkesave të përmbajtjes së ligjërit, sipas funksioneve të caktuara; vepra «Çeta e profetëve» si bilanc e sintezë madhore e arritjeve në shkrimin e shqipes përpara Rilindjes Kombëtare etj. Më tej e më thellë është për t'u studiuar Bogdani si krijues i vlerave estetike, si prozator e si poet.

Një trajtim më vete e më të thelluar kërkojnë edhe konceptet e Pjetër Bogdanit për gjuhën amtare, sidomos për gjuhën letrare, në tërësinë e koncepteve të përgjithshme të tij filozofike e sociologjike. Këto koncepte duhen ballafaquar me mendimin teorik të kohës para dhe pas Bogdanit.

Krahas kësaj, është e nevojshme të thellohen më tej edhe studimet tekstologjike e filologjike për «Çetën e profetëve», për saktësimin e mjaft interpretimeve të rrafsheve të ndryshme — të fonetikës e të grafikës (domethënë të sistemit të shenjave shkrimore që përdor Bogdani dhe të

raporteve të këtij sistemi me sistemin fonetike të shqipes së shek. XVII), të morfologjisë, të sintaksës, të leksikut dhe të etimologjisë.

Edhe në rrafshin filozofik e sociologjik vepra e P. Bogdanit ka shumë aspekte që kërkojnë studime më të thelluara analitike. Të tilla do të ishin p.sh.: «P. Bogdani dhe mendimi i filozofëve të Greqisë e të Romës së lashtë», «Idetë humaniste dhe iluministe në veprën e Bogdanit», «Bogdani si teolog», «Bogdani dhe e drejta zakonore», «Bogdani dhe psikologjia popullore», «Çështje të etnografisë shqiptare në veprën e Bogdanit», «Bogdani si sociolog» etj.

S'ka dyshim se shkenca jonë, e frymëzuar dhe e udhëhequr nga interesat e mëdha të kombit, do t'i përballojë me nder edhe këto detyra që i shtrohen për njohjen e traditave kulturore të popullit tonë dhe të njerëzve të shquar që kanë dalë nga gjiri i tij.

Duke shprehur bindjen e thellë se punonjësit tanë të shkencës e të kulturës do të takohen me arritje të reja në veprimtari të tilla, Konferencën shkencore përkujtimore për Pjetër Bogdanin e deklaroj të mbyllur.

ANDROKLI KOSTALLARI

PJETËR BOGDANI DHE GJUHA LETRARE SHQIPE*

Njerëzit e mëdhenj punojnë jo vetëm për kohën e vet, por edhe për të ardhmen. Pikërisht këtu qëndron madhështia e jetësia e veprës së tyre. I tillë ka qenë e mbetet edhe Pjetër Bogdani — si atdhetar, si shkrimtar e mendimtar, si *lëvruesi më i shquar i gjuhës shqipe përpara Rilindjes Kombëtare*.

Duke jetuar e vepruar në kushtet kur Dheu i Arbërit lëngonte nën zgjedhën osmane, që ai e barazon me një «përmbytje» me «ujëra të tërbuara»¹, në një kohë kur idetë e humanizmit kishin çarë errësirën mesjetare, Pjetër Bogdani u ndodh në mes dy forcave, në mes dy epokave. Në një-rën anë, dogma fetare e tërhiqte atë drejt mesjetës e skollastikës, drejt qiellit. Si prift, ai i pagoi haraçin përkatës, — një haraç mjaft të rëndë, — kësaj dogme. Dhe këtu, siç thotë ai vetë, nuk mëtonte të sillte ndonjë gjë të re, megjithëse, siç dihet, ai u bëri një shtjellim mjaft të lirë le-

*) Ky punim ka shërbyer si bazë për referatin me të njëjtin titull, mbajtur nga autori në Konferencën shkencore përkujtimore me temën «Pjetër Bogdani dhe vepra e tij».

1) Shih letrën kushtimore drejtuar kardinalit Gregor Barbarigo më 18 tetor 1685,

52505

gjendave biblike. Në anën tjetër, dashuria për vendlindjen, për popullin e vet e lufta për çlirimin e tyre, dashuria e nderimi për kulturën botërore e për dijet e vërteta, synimi që këto të përhapeshin në gjuhën amtare, — siç thotë ai, — «për të marrë vesht dienë nieri mbë gjuhë të vet», kultura e tij e gjerë, e shumanshme, që ishte thithur nëpërmjet shumë gjuhëve e që përfshinte njohuri të thella për botën mendore antike e moderne², i dhanë atij objektivisht një shtysë të fuqishme për të mos mbetur vetëm në krahët e mesjetës, për ta çarë rrethin e ngushtë e të mbyllur fetar e për të kërkuar shtigje të reja, duke zbritur nga qielli në tokë, në mes njerëzve të trojeve arbërore, në mes shqetësimeve, vuajtjeve, dëshirave e synimeve të tyre. Pikërisht këtu e gjeti frymëzimin themelor pena e mprehtë e Pjetër Bogdanit për të na dhënë atë që mund të quhej traktati i parë, goftë edhe i copëzuar, fragmentar, por origjinal i shkencave humanitare e natyrore dhe i kulturës shqiptare, *veprën më të madhe të gjuhës letrare shqipe që i parapriu Rilindjes Kombëtare*. Nën një veshje teologjike, me veprën «*Cuneus prophetarum*» («Çeta e profetëve») «hynin në Shqipëri plot elemente të kulturës së Rilindjes Evropiane»³. Nën ndikimin e kësaj kulture të ndritur, që kishte në qendër dashurinë e kujdesin për njeriun, dhe i frymëzuar nga traditat e virtytet e larta të popullit shqiptar, nga shpirti i tij i papërkulur në luftërat çlirimtare, Bogdani-filozof dhe atdhetar liridashës e kryengritës mjaft herë ndeshet *objektivisht* me Bogdanin-teolog. Në një mënyrë a anë një tjetër, ai u kundërvë në thelb skemave dogmatike të apologjetëve

2) Siç del nga një vjershë që i kushton Pjetër Bogdanit kushëriri i tij Lukë Bogdani, Pjetër Bogdani zotëronte, përveç gjuhës së vet amtare — shqipes, edhe latinishten, italishten, greqishten, dalmatishten, hebraishten, arabishten, armenishten e sirishten (shih vjershën kushtimore «Shumë ndriçimit e shumë ndershimit zotit, tim zot për nder, zotit Pjetër Bogdani, kushërinit tim dashunit... Këndoi Luca Bogdani», përpara fillimit të pjesës I të «*Cuneus prophetarum*»). Është për t'u përmendur që P. Bogdani në këtë vepër boton edhe tekste të veçanta (pjesë nga jeta e profetëve — e Moisiut, Davidit, Salomonit, Isaisë, Jeremisë, Ezekielit, Danielit, Joelit, Amosit etj.) në gjuhët e ndryshme që njihete me alfabetet përkatëse.

3) Shih Zija Xholi, *Pjetër Bogdani — koha dhe vepra e tij*, në rev. «Studime filologjike», Tiranë, 1986, nr. 1, f. 57.

të krishtëritimit, — të Tertulianit, Shën Agostinit etj., — ide e koncepte pozitive e përparimtare, që burojnë nga njohja e gjerë e mendimtarëve e shkrimtarëve më në zë të antikitetit e të kohës së Rilindjes, nga historia, përvoja e mençuria e popullit tonë dhe nga aftësitë e rralla intelektuale krijuese të vetë autorit. Të gjitha këto e lejojnë atë të depërtojë thellë në të vërtetat historike e të nxjerrë mësimë e përfundime të drejta nga jeta e gjallë e popullit. Këto koncepte pozitive që dalin te Bogdani-filozof arrijnë nganjëherë deri në materializmin e Aristotelit a të sensualistëve. E parë nga kjo anë dhe sidomos në një rrafsh të gjerë kulturor e gjuhësor, vepra «Çeta e profetëve», me shtrirje shumë të hapët tematike e problemore, me tehun e vet përparimtar i kalon kufijtë e botës shqiptare. Bogdani, vërtet, u bën thirrje bashkëkombësve «të mos lanë dijenë e gjuhënë e Dheut me dvarunë», por këto përpjekje nuk i sheh të veçuara. Ai i vendos ato në një kuadër të gjerë evropian e universal, duke theksuar që populli ynë të përpiket për gjuhën amtare e për kulturën e vet ashtu siç veprojnë të gjithë popujt e tjerë («posi lëfton gjithë dheu e shekulli për të vet»⁴). Dhe këtu ai kishte parasysh luftën titanike që bënin gjithë popujt e Evropës në kohën e Rilindjes. Ai e lidhi, kështu, *objektivisht* emrin e vet edhe me përpjekjet e përgjithshme për lirinë e popujve e të njeriut, për formimin e botëkuptimit laik dhe i dha veprës së vet një tingëllim të ri në krahasim me të gjithë autorët e tjerë të shekujve XVI-XVII.

Për herë të parë në historinë e letërsisë sonë në këtë veper *arti i fjalës* gjeti një shtrat të ngrohtë njerëzor me përmasa të gjera dhe bëri një hap të ri *cilësor* përpara drejt horizonteve evropiane. Risia e përmbajtjes dhe e formës ndërthuren në veprën e Pjetër Bogdanit në mënyrë organike e në marrëdhënie dialektike. Për prozën e vet tregimtare e shkencore, për trajtimet historiografike e filozofike dhe për lirikën poetike ai zbulon me guxim mjete të reja kumtuese e shprehëse dhe i zgjeron shumë kufijtë e gjuhës letrare, duke shkrirë në një sistem të harmonishëm mjetet e lashta të shqipes, arsenalin e saj bashkëkohor dhe mundësitë e vlerat potenciale të strukturës së saj leksiko-gramatikore

4) Shih Pjetër Bogdani, *Cuneus prophetarum* Patavii MDCLXXXV, «Të primitë përpara lettërarit».

e fjalëformuese. Një sistem i tillë në një vepër krijuese origjinale që u ballafaqua me nder edhe me italishten, — me gjuhën letrare kombëtare më të përpunuar të Evropës së atëhershme, jo vetëm e ngriti shqipen e shkruar në një shkallë të re, por tregoi edhe ç'mundësi të pashtershme kishte kjo gjuhë po të lëvrohej ashtu si simotrat e saj indoevropiane letrarisht më të zhvilluara.

Edhe dashuria e Bogdanit për Arbënin e për «gjuhën arbëneshe» ka diçka të re në krahasim me autorët e mëparshëm. Ajo lidhet jo vetëm me konceptin e *vetëqenies* së kombit shqiptar e me krenarinë për virtytet e tij, me idenë e *qëndresës* etnogjuhësore e kulturore e të *qirimit* nga pushtuesit e huaj, por edhe me idenë e madhe të *përparimit*: Bogdani, që nga parathënia («Të primitiv...») e «Çetës së profetëve» e deri në faqet e fundit të saj, kërkon që «t'Arbëneshtë» jo vetëm të jenë thjesht një popull i lirë e i pavarur, por të jenë një popull *i lirë e i shkolluar në gjuhën e vet amtare*, me kulturë e me gjuhë të zhvilluar, me fytyrën të kthyer nga Evropa e përparuar. Prandaj ai i shoalli luftë të papajtueshme prapambetjes kulturore, paditurisë, duke e bërë antitezën e antoniminë *dije — padije, të dijtëshëm — të padijtëshëm a të padijtunë* bosht qendror të gjithë veprës së tij e duke i dhënë funksione e përmasa historike kombëtare dhe shtrirje universale njerëzore kësaj antiteze. Termin «i dijtëshëm» ai e zbërthen italisht në dy kuptime — edhe «savio» (Pj. I, f. 90), edhe «letterato» (Pj. I, f. 101) dhe flet për «*gjind të dijtëshime*», domethënë për *popull të shkolluar, të kulturuar e jo vetëm për individë të veçantë. Dija dhe urtia*, të para si brendi e qenësishme e së mirës, e përparimit kombëtar e shoqëror, janë elemente thelbësore në horizontin ideor, etnokulturor e politiko-shoqëror të Bogdanit, në botën e tij krijuese dhe njëkohësisht në konceptin e tij për funksionet historiko-shoqërore të gjuhës amtare e për lëvrimin e saj.

Pa pasur pasasysh thelbin *objektiv* të kësaj *përmbajtjeje të re* të Veprës së Bogdanit e të *shprehjes së re* që kërkonte kjo përmbajtje nuk mund të kuptohet e *reja* që solli autori i saj në procesin e ndërtimit të gjuhës letrare shqipe. Një vështrim i tillë na lejon, gjithashtu, të kuptojmë përse Pjetër Bogdani ka tërhequr e vijon të tërheqë vëmendjen e studiuesve jo vetëm në rrafshin e historisë së gjuhës shqipe e të ballkanistikës krahasimtare, por edhe në mjaft rrafshe të tjera.

Siç dihet, sidomos në këta tre-katër dhjetëvjeçarët e fundit Vepra e Bogdanit është studiuar nga një varg autorësh e nga disa anë. Krahas studimeve me karakter tekstologjik, janë vëzhguar edhe aspekte të veçanta në rrafshin e fonetikës e të gramatikës historike, në dritën e mendimit filozofik, pedagogjik e psikologjik shqiptar, si edhe nga këndvështrimi i teorisë së krijimit intelektual e sidomos letrar⁵. Përgjithësimi më i gjerë i veprimtarisë shoqërore e letrare të Pjetër Bogdanit është dhënë në «Historinë e letërsisë shqiptare» (botimet e viteve 1959 e 1983). Të gjitha këto studime i kanë zgjeruar e thelluar mjaft njohuritë tona për vlerat e P. Bogdanit. Njëkohësisht ato na japin mundësi të shohim edhe zbrazëtitë jo të vogla në studimet bogdaniene.

Një nga këto zbrazëti mendojmë se është edhe trajtimi i pamjaftueshëm i koncepteve e i përpjekjeve të Bogdanit për gjuhën amtare dhe sidomos *i rolit të Veprës së tij në procesin e ndërtimit të gjuhës letrare shqipe*. Kjo Vepër, që mund të quhet laborator i më i madh i përpunimit të vetëdijshëm e mjeshtëror «të gjuhës së t'Arbëneshëve» në shekujt XVI-XVIII, është një gur themeli në këtë ndërtim dhe studimi i saj nga këndvështrimi i formimit të gjuhës sonë letrare ka rëndësi të dorës së parë. Sqarimi i problemeve që lidhen me këtë këndvështrim kërkon, pa dyshim, analiza të hollësishme monografike e sinteza të reja. Kjo punë ndodhet ende në hapat e parë. Në kuadrin e saj, në këtë punim

5) Shih Idriz Ajeti, *Pjetër Bogdani (1630-1639)*, në rev. «Jeta e re», Prishtinë, 1951, nr. 1; I. Zamputi, *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në «Buletin për shkencat shoqërore», Tiranë, 1954, nr. 3; I. Zamputi, *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*, në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», 1963, nr. 2; S. Riza, *Dy versionet e Veprës së Pjetër Bogdanit*, në vëll. «Konferenca e parë të studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 278-287; I. Zamputi, *Diskutim rreth kumtesës së Selman Rizës*, po aty, f. 399-401; V. Kamsi, «*Cuneus prophetarum*» i Pjetër Bogdanit, në përmbledhësin «Shkodra», 1962, nr. 1 (2); Sh. Hoxha, *Në gjurmët e trojeve të Bogdanit*, në «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik», Shkodër, 1964, numër i posaçëm, kushtuar 20-vjetorit të Çlirimit; A. Xhiku, *Ideja e qëndresës kundër armikut në një vepër të hershme*, në «Drita», 8 dhjetor 1974; K. Ashta, *Disa shënime mbi gjuhën e Pjetër Bogdanit*, në «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik», Shkodër, 19, nr. 2. K. Ashta, *Leksiku i*

do të përpiqemi vetëm të përvijojmë disa drejtime e çështje që mund të përcaktohen sot në hullinë e vlerësimit shkencor të «Çetës së profetëve» si vepër madhore e gjuhës letrare shqipe në takimin e dy epokave të mëdha historike.

Për këtë vlerësim është e nevojshme të shihet vepra e P. Bogdanit në përqasje me të kaluarën e me të ardhmen, në dy rrafshet kryesore: në tiparet themelore të strukturës së gjuhës së saj dhe në funksionet stilistikore. Dhe në të dy rrafshet, objekti themelor e i drejtpërdrejtë i analizës e i sintezës gjuhësore dhe pikënisje për to duhet të jetë *teksti shqip* dhe jo përkthimi i tij.

Cilat janë veçoritë e kësaj gjuhe në këto dy rrafshet?

I. RRAFSHI STRUKTUROR

1. Thelbësore për strukturën e gjuhës së Veprës së Bogdanit është *mbështetja* e saj ballësore *te gjuha e folur e popullit*. Kjo bazë popullore të «Çeta e profetëve» vijon traditën e Buzukut, të Matrëngës, të Budit e të Bardhit, por në krahasim me veprat e këtyre autorëve ajo bëhet shumë më

plotë i shqipes nxjerrë nga «Cuneus prophetarum» i Pjetër Bogdanit, në «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik», Shkodër, 1982, 1983, 1984 e vij.; M. Sciambra, *Bogdanica. Studi su Pietro Bogdani e l'opera sua* (vol. II — *Saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*), Bologna, 1965; E. Paço, *Pjesorja në Veprën e P. Bogdanit* në rev. «Studime filologjike», 1981, nr. 3; I. Rugova, *Vepra e Bogdanit*, Prishtinë, 1982; Z. Xholi, *Pjetër Bogdani — koha dhe vepra e tij*, në rev. «Studime filologjike», Tiranë, 1986, nr. 1; J. Redžepagić, *Zivot, rad i pedagoški pogledi Andrea e Pjetra Bogdanija*, në «Gjurmime albanologjike», 1966, nr. 3; N. Abdiu, *Shënime për Pjetër Bogdanin dhe kontributin e tij në mendimin psikologjik shqiptar në shek. XVII*, në «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik», Shkodër, 1973, nr. 1; Sh. Osmani, *Atdhedashuria dhe krenaria kombëtare në Veprën e P. Bogdanit*, në «Drita» 6 dhjetor 1981; *Cuneus prophetarum a Pietro Bogdano*, München, 1977 (ribotim i Veprës së Bogdanit me shënime e sqarime hyrëse, në sërinë «Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients» nën kujdesin e Rudolf Trofenikut); Luigi Marlekaj, *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio Editrice S.n.c., Paolo del Colle (BA); kjo vepër përmban edhe njëqind e tri dhjetë dokumente për jetën dhe veprën e Bogdanit etj.

e gjerë e më e thellë: *te Bogdani thellohet e bëhet bindje shkencore vetëdija se është pikërisht gjuha e folur e popullit ajo që duhet t'i japë shkrimtarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare shqipe nuk duhet vetëm të shfrytëzojë ato mjete që duken në sipërfaqe, por duhet të depërtojë edhe në shtresat e thella të saj, «me qitunë mbë dritë, — siç thotë ai, — shumë fjalë plaka e të harrueme» («Të primitë përpara letërarit»), të njohë mirë edhe aftësitë potenciale krijuese, ripërtëritëse të saj. Dhe në vijat themelore vetë Bogdani i vuri në jetë kërkesat e kësaj vetëdijeje shkencore më mirë se të gjithë autorët e tjerë para Rilindjes. Këtë ai e arriti edhe sepse u frymëzua gjatë gjithë jetës nga dashuria e zjarhtë për gjuhën amtare e nga besimi i madh te vlerat që fshihen në gjirin e saj. Dhe dihet se gjuha ua zbulon këto vlera pikërisht atyre që e duan dhe e nderojnë.*

2. Mbështetja te gjuha e folur e popullit është burimi i parë e vendimtar objektiv që i jep gjuhës së «Çetës së profetëve» karakterin origjinal. Ky karakter, në përgjithësi, përforcohet dhe nuk prishet (siç ka pohuar ndonjë studiues) nga puna kërkimore e lëvruese e vetë Bogdanit, si faktor subjektiv. Vërtet, në këtë punë krijuese të autorit ka herë-herë ndikime të italishtes, sidomos në sintaksë e më pak në leksik, por këto ndikime, në thelb, nuk arrijnë ta shfityrojnë origjinalitetin e gjuhës së veprës së Bogdanit as në rrafshin e burimit popullor, as në rrafshin e kriimeve të reja me lëndën, me mjetet e me gjedhet e këtij burimi. Kjo duket qartë sidomos në fushën e sintaksës dhe të formimit të fjalëve.

a) Për të treguar mbizotërimin objektiv e subjektiv të sintaksës së shqipes po japim, së pari, një pjesë nga proza didaktike-predikuese e Bogdanit, ku duket se si ai, zakonisht, ka parasysh veçoritë e shqipes e i ruan në përgjithësi ato, megjithëse ndodhet gjithnjë nën trysninë e gjuhëve të huaja.

«Me u gjetunë një pëllas o shtëpi, ngrehunë ndë Maltë Regj (të) Pështrikut tinë, aqa i shkretë e i vetëmë, punuem me mjeshtëri të madhe, me dyer të bukura, çardaqe fort të nalta, tregullat e rgjanta e t'arta, kopështinje e kroena, i silli horjat e i marrë menç' kish me u gjetunë,

qi tue him ndë shtëpi kaqa të bukurë e të gjante tryesatë shtruem me gjithë duer gjellësh, ani të mos thoj (= thoshte) se këjo shtëpi nukë anshtë lem mbë këtë jetë vetëhej, po ka diku një zot fort të begatë e të lum?» (Pj. I, f. 2).

Duke përqasur këtë pjesë me përkthimin në gjuhën italiane, *bie në sy se në rrafshin e fjalisë e të togfjalëshit përdoren kryesisht ndërtime tipike për shqipen: përdoret pas-kajorja me funksion kushtor («me u gjetunë një pëllas...»), togfjalësha atributive me përcaktorë të drejtpërdrejtë mbi-emërorë (krhs. shqipen «tjegullat e rgjanta e t'arta» me ital. «li tetti d'argento e d'oro», ku përcaktimi jepet me emra në rasën gjinore), ndërtime me pjesore të panyjzuar që mund të lidhen me emra të çdo gjinie e të çdo numri (krhs. pëllas — m., shtëpi — f., — punuëm lidhet me të dy emrat pavarësisht nga gjinia; tryesatë — f.sh.; — shtruem lidhet si me trajtën e njëjësit, ashtu edhe me atë të shumësit), përdoret togfjalëshi karakteristik i shqipes i tipit *përemër i pakufishëm + emër në rrjedhore* («me gjithë duer gjellësh), të cilin italisht autori e jep me togfjalëshin e tipit *emër + emër në gjinore* («varietà di vivande») etj.*

Ky është tipari i përgjithshëm i tekstit që P. Bogdani ka shkruar së pari e mirëfilli shqip. Por në gjithë veprën e Bogdanit ka shumë dëshmi që tregojnë se edhe kur ai ka përkthyer pjesë të ndryshme, prozë ose poezi, nga italishtja a nga latinishtja, jo vetëm e ka bërë përkthimin të tingëllojë shqip, por në raste të veçanta ka arritur në përkthim edhe një shkallë të lartë origjinaliteti, të krahasueshme deri diku me atë që arritën pas dy shekujsh K. Kristoforidhi në «Psalmet e Davidit» dhe më vonë Fan Noli. Vargjet e mëposhtme, të dhëna në origjinalin italisht e në përkthimin shqip, flasin bindshëm për këtë:

shqip:

«Mbë qiell' nuk' ishte as ull, as dielli.
 Qi me dritë të vet zbardhën dritë të re,
 As hana delte me dy të rgjanta bri,
 As prej qiellshit vinte ndonji rreze përdhe,
 As dheu si shqype nalt' qendron e rri.
 As niegullë me shi, as breshën', as rrëfe,
 As deti me valë epte të madhe gjamë,
 As lymënatë me breg ishinë zanë».

(«Cuneus...», Pj. I, f. 20).

italisht:

«Non vi era chi portasse il novo giorno,
Con maggior lume in oriento acceso,
Ne rinnovava mai la luna il corno,
Ne l'altre stelle havean lor corso preso,
Ne pendeva la terra intorno intorno,
Librata in aere dal suo proprio peso:
Ne il mar havea col suo proprio grido,
Fatto intorno la terra il vario lido».

Shihet qartë se përkthimi shqip nuk na e shpalos me më pak forcë e madhëri se origjinali tablonë kozmogonike që jepet në këtë tetëvargësh. Këtë autori e ka arritur me mjete të veçanta të shqipes, që nuk i ka fare teksti italisht. Bogdani, njohës vëzhgimprehtë i gjuhës amtare dhe shpirt i thellë poetik, ka ditur t'i zbulojë këto mjete në mundësitë që jep struktura gramatikore e leksikore e shqipes dhe në krijimtarinë poetike gojore popullore. Të tilla mjete janë, p.sh., në këto vargje: sintagmat «as ylli, as dielli», «dritë të re», «bri i ngjantë», «dheu si shqype». «qëndron e rri», «as niegullë me shi», «as breshën, as rrëfe», «deti me valë», «gjamë e madhe», «lumënatë ishin zanë me breg» si edhe ngjeshja e mendimit nëpërmjet strukturës «një varg — një fjali» për ta hedhur lexuesin në përsiatje që ngërthejnë edhe një farë dramtizmi.

Në pëlhurën e gjerë të «Çetës së profetëve» herë pas here bien në sy edhe ndikime të italishtes e shumë më rrallë të latinishtes. Ndër to takohet më shpesh paravendosja e mbiemrit, në vend të prapavendosjes së tij, që është karakteristike për shqipen. Të tilla janë, p.sh. ndërtimet *mbiemër + emër* ose *dy mbiemra + emër* si: «të mira të bame» (Pj. I, III, III), «i njimendi emënë» (Pj. I, III, III), «të kullueminë gjak», (Pj. II, I, III), «të mbraminë vëlla», (Pj. I, I, III); «me të madh durim» (ital. *con gran pazienza* — Pj. II f. 102), «ma të afëritë nierëz» (Pj. I, I, IV) «e gjithëherëshme virgjëna» (Pj. I, III, VIII) *kësaj së rrëzue e së mjerë jetë»* (Pj. I, III, VI), «me një të qelbëtë e të shierrë pëlhurë» (Pj. II, III, I) etj. Por peshat specifike e këtyre ndërtimeve është e vogël në krahasim me peshën dërrmuese të ndërtimeve tipike për shqipen (krhs. p.sh. «mbiell farën' e kullueme» — Pj. II,

II, IV, «Vepëratë e përjashtime» — P. I, I, IV; «me atë petëk të dhunueshim» — Pj. II, III, II; «zogu i egrë» — Pj. II, f. 12; «shpirt i dënuem» — pj. I. f. 53; «madhështi e paudhë» — Pj. I, f. 8; «petëku i ndym» — Pj. I, f. 258; «çeli gojënë e vet të përmyjalçimenë» — që italisht e ka dhënë «apri la sua dolce bocca» — Pj. II, f. 59; «purtekënë e artë» — Pj. II, f. 2; «me një bar të paçmuem» — Pj. II, f. 86; «gra të devotshme» — Pj. II, f. 134; «nji erë e mënishme» Pj. I, III, IV; «me fjalë të njerëzishme» — Pj. II, f. 125 etj.) Për këtë flasin edhe mjaft fjalë e togfjalësha që janë ndërtuar sipas natyrës së shqipes dhe që Bogdani i ka përkthyer italisht ndryshe (krhs., p.sh.: «Dielli thotë nuk jam Hyj, përse më zihetë drita» — ital. «perché patisco eclissi», Pj. I, f. 1; «E parë se mbytej shekulli me ujë...» — ital. «e avanti il Diluvio», Pj. I; «As më thue, o Judë tradhëtori, ku anshtë i pafaji biri em?» — ital. «Dimmi, ah Giuda traditore, dove è l'innocente mio figliulo?», Pj. II, f. 105, pika 28; «e thonë se tue votë përpara e mbrapa Diellit ndëpër atë udhë e rreth banhenë të lemitë e të çprishmitë kafshëvet ndënë Hanë e të shekullit — ital. «e si dice, che secondo l'andar avanti e dietro il Sole per tal circolo o via si fanno le generationi e corruttioni nelle cose sublunari», Pj. I, f. 27, p. 37 etj.). Të gjitha këto dëshmojnë qartë se baza e Veprës së Bogdanit është sintaksa e shqipes dhe se ndikimet e italishtes në strukturën sintaksore të tekstit shqip nuk mund të kenë qenë, në përgjithësi, pasojë e ripunimit që i bëri këtij teksti Bogdani, kur e përktheu atë italisht, duke synuar gjoja ta shndërronte atë në një kalepin (megjithëse gjatë përkthimit autori ka bërë herë-herë edhe ndryshime në tekstin shqip nën ndikimin e italishtes për një përputhje sa më të plotë të origjinalit me përkthimin)⁶, por burojnë kryesisht nga vetë formimi kulturor e gjuhësor i tij. Herë-herë ato lidhen edhe me qëllimin e vetëdijshëm të autorit për t'i dhënë shprehjes gjuhësore nota emfatike. Prandaj, në përgjithësi, «Çeta e profetëve» mbetet një vepër themelore edhe për njohjen e strukturës sintaksore të shqipes e të evolucionit të saj historik.

6) Vetë Bogdani në «Të primitë...» nuk thotë se kishte për qëllim të hartonte një kalepin, domethënë një fjalor dy-a-më shumë gjuhësh, por sqaron se iu dha ky udhëzim nga Kongregacioni i Propagandës së Fesë që kjo vepër shqip e italisht të mund të shërbente «posi t'ish një kalepi». Kjo është diçka tjetër.

b) Frymëmarrjen më të gjerë Pjetër Bogdani ia jep shqipes së shkruar sidomos në fushën e leksikut e të formimit të fjalëve. Siç dihet, në veprën «Çeta e profetëve», krahas legjendave biblike dhe problemeve filozofike universale e të shkencave të natyrës, gjejmë edhe mjaft aspekte të jetës shqiptare, — të historisë, të gjeografisë, të etnografisë, të kulturës e të gjuhës së popullit shqiptar, që ia theksojnë veprës karakterin origjinal e ia pasurojnë vlerat e saj. Për t'iu përgjigjur kërkesave të një përmbajtjeje kaq të larmishme e shumërrafshore të kësaj Vepre «Iort të naltë e të hollë», siç e quan vetë Bogdani, ai jo vetëm shpëtoi për brezat e ardhshëm shumë fjalë e shprehje «plaka e të harrueme», por shfrytëzoi në përmasa të papara deri atëherë burimet leksikore e frazeologjike të gjalla të shqipes së kohës së vet dhe njëkohësisht, me një nuhatje gjuhësore të rrallë e të thellë, krijoi shumë fjalë të reja, sidomos *emra abstraktë*, *mbiemra* e *folje* për terminologjinë shkencore e filozofike e për tregimet historike e artistike. Gjuha e «Çetës së profetëve» dëshmon qartë se gjatë këtyre përpjekjeve shumë të mundimshme, «me djersë të mëdha», ai arriti të kuptonte drejt se në ç'hulli duhej të zgjerohej e të rridhte lirshëm leksiku i shqipes letrare e popullore. Në këtë valë krijuese ai pasuroi e ripërtëriu edhe semantikën e shumë fjalëve të njohura, duke u dhënë atyre ngarkesa e ngjyrimë kuptimore të reja e duke zgjeruar valencat e tyre.

Për të analizuar këtë punë titanike, duke e përqsaur atë me të kaluarën e me të ardhmen, duhen monografi të tëra e studime të vëllimshme përgjithësuese. Por edhe një vështrim i rrasët i gamës së gjerë të fjalëve që përdoren a krijohen në Veprën e Bogdanit mund të na japë një ide të përgjithshme për atë hap të ri cilësor që bëri leksiku i shqipes letrare në këtë Vepër dhe për gjallërimin e aktivizimin e mënyrave, të modeleve e të mjeteve më prodhimtare fjalëformuese, siç janë, në radhë të parë, *prapashtesimi* e *kompozimi*.

1. Ashtu si edhe tek autorët e tjerë të letërsisë së vjetër shqipe nga Bogdani përdoren gjerësisht si *emra veprimi* me një semantikë të pasur emrat asnjënjës që krijohen nga emërzimi i pjesoreve, siç janë: *t'ardhunitë* (ital. «venuta» — Pj. I, f. 107), *të kjanëtë* e *të moskjanëtë*, *të bluemitë*, *të dalëitë* («prej së dalit», Pj. I, f. 107), *të dhimbtunitë*, *të ecunitë*, *të*

fluturuemitë, të folëtë, të hipunitë, të mbrumitë, të ngjallunitë e *të ngjallimitë, të pamitë* («në një të lum të *pam*» — ital. «nella visione beatifica», Pj. I, f. 107, pika 13), *të pjekuritë, të shoshunitë, të përvuie* (ital. «humilità», Pj. II, f. 110) etj. Ai i zgjeron mjaft funksionet e tyre në krahasim me Buzukun, Matrëngën, Budin, Bardhin, duke i përdorur më shumë këta emra si terma edhe në kuptimin e rezultatit të veprimit a të cilësisë që përftohet nga një veprim a pësim, si p.sh. *të mishënuemitë* (ital. «l'incarnazione», Pj. I, f. 107), *të mbështjella*, që e përkthen italisht «intrighi» (pj. II, f. 64) etj. Njëkohësisht, ai zgjeron edhe përdorimin e emrave abstraktë asnjëherë të formuar nga emërimi i mbiemrave të nyjshëm, si *të ftohtitë, të nxehsitë, të njometë, të thatitë, të gjatëtë, të gjanëtë, të naltëtë* (lat. përkatësisht «longitudo», «latitudo», «altitudo»), *të mposët* (= «diçka e veçantë a e posaçme, të veçantët, veçori»; krhs. edhe ndajfoljen e parafjalën *pos* = veç: «... ban si një kuvend ndër të tre vetët e një të *mposë*» — ital. «usa una certa consulta tra le tre persone e modo particolare». Pj. I, f. 40, pika 1), *të kthellëtitë* (= «thellësi»: «pa mos mujtunë me iu matunë fundi e të kthellëtitë» — ital. «senza poterlisi misurar l'abisso», Pj. I, f. 108, pika 14) etj. Por, krahas kësaj, ai e kupton se terminologjisë dhe gjuhës letrare shqipe të kohës së re i duhen më shumë formime kompakte, sintetike-prapashtesore, qoftë si *emra veprimi*, qoftë si *emra abstraktë cilësie*. Kështu, ai ua hap mjaft gjerë udhën emrave prejfoljorë e prejemërorë më *-im* dhe *-imë*, si edhe emrave abstraktë e përmbledhës me prapashtesat *-i*, *-ni* (*-ri*), si *bekim, durim, gatim, gulshim, kallëzim* (= «tregim»; «kallëzoi kallëzimnë t'begatit shtrenjtë» — ital. «raccontò l'istoria del ricco avaro», Pj. II, f. 82), *lëngim, mallëkim, mbarim, mbukurim, mundim, martirizim, mundështim, mpsim* e *pësim* (shih *pësimetë* — ital. «passione» Pj. I, f. 107), *ngënjim, ngushëllim, pagëzim, pushim, shkëlqim, trajtim*, (Pj. I, f. 75; pika 13), *shtrëngim, urdhënim, vajtëm* etj.; *rruzullim, kërshitenimi* etj., *rapëtimë-a* (ital. «rumore», Pj. II, f. 99) etj.; *fisniki-a* (ital. «nobilità»), *hyjëni, lakëmi, mjerëni, mjeri-a* («dita e mjerisë» — lat. «dies miseriae», Pj. II, f. 148), *mjekci, mjeshtëri, lavdëri, bashkari-a* (ital. «convenienza», Pj. I, f. 27, p. 37), *zonjëni* («me një të madhe *zonjëni* e nder» — ital. «con gran signoria e onestà», Pj. II, f. 7, pika 9), *shoqëni-a* (ital. «pluralità delle persone», Pj. I, f. 12. p. 1), *gumëzi* («nukë kish rem ende për *gumëzi*» — ital. «non haveria

mentito ancor per burla», Pj. I, f. 116, pika 1), *shtrigëni-a* («Me një mijë të çpifuna e *shtrigëni*», — ital. «con mille invenzioni e *stregarie*» — Pj. I, f. 3, pika 8), *rezmi-a* («trashëgimi» nga *rezin-i* = trashëgim; lat. «haereditas» — Pj. I, f. 126, pika 9), *vetëmi-a* («përse *vetëmiet* bin të n'kotëtë» — ital. «*la solitudine genera l'ozio*» — Pj. I, f. 7, pika 2), *madhështi-a* (ital. «superbia», Pj. II, f. 155, f. 1), *dëshminjëni-a* (në kuptimin «*dëshmi-a*»: «e dëshminjënisë dottomëvet» — ital. «e testimonio de Dottori»; këtu përdoret trajta e vjetruar «testimonio» për të sotmen «testimonianza» — (Pj. I, f. 6, pika 24), *këmbenjëni-a* (krhs.: *i këmbyem* = i marrë, i çmendur; «Platoni tue vum roe *këmbenjënin'* e njerëzet» tha... — ital. «Platone considerando *la pazzia degli huomini disse*» — Pj. I, f. 5, pika 19) etj.

2. Një gjallërim të madh merr në veprën e Bogdanit përdorimi e krijimi i *mbiemrave* të prejardhur, qoftë me funksion terminologjik e në togfjalësia të qëndrueshëm, qoftë me ngarkesa të ndryshme konotative — miratuese e keqësuese, shprehëse-emocionale e vlerësuese. Një zhvillim të veçantë kanë marrë sidomos këta tipa:

— *Mbiemrat prejppjesorë* (edhe me parashtesë mohuese-antonimike): *i mbetunë*, *i përzanë*, *i pjekunë*, *i praruem*, *i rrjedhun* («ujënat e rrjedhuna» për lat. «*aquae furtivae*»), *i situnë*, *i ardhunë*, *i çelë*, *i shemptuem*, *i çprishunë*, *i ngrinë*, *i ngjyem*, *i nzanë* (= *i mpiksurr*; gjak i nzanë» — ital. «*sangue agghiacciato*»), *i panjehun*, *i paçmuem*, *i palëkundun* etj.;

— *Mbiemrat foljorë* me -të: *i ndezëtë*, *i dandëtë* (= i dendur) etj.

— *Mbiemra të nyjshëm* me parashtesën pa- dhe me tema emërore a mbiemërore. Ndër ta një zgjerim pothuajse të pakufizuar kanë marrë mbiemrat pronësorë privativë, të cilët kanë ngarkesë semantike të ngjeshur, që mjaft herë jepet në përkthimin italisht me një fjali të tërë: *i pafe*, *i pamadhështi*, *i pamasë*, *i pabesë*, *i pametë*, *i pafryt*, *i papendesë*, *i pakorë*, *i pafaj*, *i paudhë*, *i paarsyc*, *i paarmë*, *i padroe*, *i pafaqe* (= «i pafytyrë, i pacipë» — A.K.), *i pagojë*, *i pahelm*, *i pamashtri*, *i pander*, *i panevojë* (ital. «che non abbia bisogno di qualche cosa», Pj. I, f. 43, pika 15), *i parrnesë* («lavd i parrnesë» — ital. «vana gloria»), *i paskanj*, *i patëkeq*, *i patinëzonë*, *i pandonjimpkat*, *i patëzanë-fill-e-të-sosunë*

(ital. «infinito» — Pj. I, f. 5), *i pamadhështi-e-cmir* (ital. «senza ambizione e invidia», pj. II, f. 74) etj. Për tiparizimin e një sendi a frymori sipas mundësisë së ushtrimit a të pësimimit të një veprimi te Bogdani fillojnë të përdoren në shkrim në mënyrë pak a shumë të gjerë e të qëndrueshme dhe me vetëdije, ashtu si në shqipen e sotme, mbiemrat më -shëm me tema foljore, si *i pakalbshëm*, *i padurueshim* (ital. «fastidioso», Pj. I, f. 29), *i pakthyeshim*, *i pandërrueshim* etj. Krahas tyre, përdoren shumë më gjerë mbiemrat më -shëm me temë foljore e emërore, që shënojnë thjesht një tipar cilësor, si *i amshueshim*, *i anëkueshim* («fjalë të ankueshime» — ital. «parole dolorose», Pj. II, f. 105), *i dëjtëshim*, *i dëshirueshim* (it. «desideroso»), *i dukshim* (ital. «apparente»), *i durueshim* (ital. «paziente»), *i gëzueshim*, *i hyjnueshim* (ital. «divino», Pj. I, f. 6), *i lëngueshim*, *i ndriçim* (ital. «luminoso»), *i pashim* («ndë shekulli të pashim — lat. «in mundo sensibilis», Pj. I, f. 21, pika 5), *i pëlqyeshim*, *i pritueshim* (ital. «trascurato», Pj. II, f. 90), *i pushtueshim* (ital. «onnipotente», Pj. I, f. 19, pika 3), *i trembshim* (= «i tmerrshëm»), *i rrëmbyeshim*, *i shkëlqyeshim etj.*; *i arësyeshim*, *i feshim*, *i hieshim*, *i mënishim*, *i mbarshim*, *i pambarshim*, *i njerëzishim*, *i ujësishim* (ital. «humido»), *i unëshim*, *i vërtytshim etj.*; *i përmallshim* (ital. «malinconico», Pj. II, f. 115, pika 21), *i përflakshim*, *i përzzjarrshim* (ital. përkatësisht «infiammato», «infocato», Pj. II, f. 8) etj.

— Mbiemrat më -shëm me tema ndajfoljore, si *i ndër-mjetshim*, *i përbrendshim*, *i përsipërçim*, *i sodshim*, *i gjithë-hershim etj.*

— Mbiemrat dhe emrat e vepruesit më -(ë)s nga tema foljore dhe emërore, si *lës* (= «lerës, lindës»: «ndër Hyjt lees» — ital. «tra Dio generante», Pj. I, f. 8, pika 7; krahas kësaj Bogdani përdor edhe ndërtime analitike: «ndo atë kahë leen, ndo atë qi len» — ital. «o quanto alla persona generante, o quanto alla persona generata», Pj. I, f. 8, pika 8), *pagëzues*, *pajtues* (ital. «pacifico»), *paës* (= parës, shikues: «i një mendi emënë paas» — ital. «l'istesso nome vidente», Pj. I, f. 107), *vrās* (= vrasës), *shelbues*, *mbjellës* («mbjellësi i pajisë» — ital. (fondatore della pace», Pj. I, f. 175), *pri-tues*, *përpris* (lat. «devorans»), *lakëmuës*, *lypës*, *ngushëllues*, *shpërbles-i*, *shitues* (lat. «Arcitenes», Pj. I, f. 27, pika 37), *tretës etj.* ose *grykës*, *gjakës*, *mëshërierës*, *misirës* (= egjiptian, ital. «egizio»), *zgjedhës* (= lexues) etj.

— *Mbiemrat dhe emrat me prapashtesat -or, -(ë)tor, -(ë)sor, -ar, -tar*, si *cmiror*, («gjind' zmirorë» — ital. «invidiosa gente», Pj. II, f. 107), *zemëror* («zemëruer i fortë» — ital. «di grande animo», Pj. I, f. 116), *gjakësor*, *ngushëllor*, *rrotullor* (ital. «rotondo»), *madhështor* (ital. «superbo», Pj. II, f. 61), *tradhëtor-i* (ital. «traditore»), *zotënor* (nga folja *zotënoj*; «zoti i zotënorëvet» — lat. «Dominus dominantium», Pj. I, f. 109, pika 16), *kalor-i* (= «kalorës»; «kaline e kaluerë e shtiu ndë det» — lat. «equus et ascensorem decit in mare», Pj. I, f. 92, pika 23) etj.; *dvekëtar* (= *vdekëtar*), *kankëtar*, *kshilltar*, *lodërtar*, *mortar*, *ndihmëtar*, *rezmëtar* (= «trashëgimtar» nga «rezm-i» = trashëgim, lat. «conae-redes», Pj. I, f. 126, pika 9), *gjuhëtar-i* (kjo fjalë takohet për herë të parë te Bogdani në kuptimin «gojëtar» lat. «eloquens»: «... tha së riu Moisesi: të lutem, Zot, nukë jam *ghiuhëtar*, qysh dje e parëdjej e ç'kur fole shërbëtorit tit, jam *ghiuhë ma së mbajturë e së fështirë...*» — lat. «... replicò Moisé: «Obsecro, Domine, non sum eloquens ab heri et nudius tertius et ex quo locutus es ad servum tuum *impeditoris et tardioris linguae sum...*», Pj. I, f. 88, p. 10), *fjalëtar* («nji fjalëtar i fortë» — ital. «un loquace indicibile», Pj. II, f. 155, pika 3) etj.

— *Mbiemrat dhe emrat me prapashtesa zvogëluese-përkëdhelëse: i vogëlith dhe e vogëlzë, birth e bijëzit, fëmijzët* (ital. «fanciulletti»), *helmth*, *gëzofth* etj.

3. Pasurohet dukshëm gjithashtu edhe grupi i *foljeve me temë më -o*, domethënë klasa më e pasur e më aktive e foljeve të shqipes: *akullohem*, *brinoj*, *gazëmohem* («gazëmoni ndë Hyjt gjithë dhe» — lat. «Jubilate Deo omnis Terra», Pj. I, f. 107), *fatoj*, *frujtoj*, *humboj*, *hyjënoj*, *lulëzoj*, *mishënoj*, *nguroj*, *pushkoj*. («qëlloj me pushkë»: «do me pushkuem e me vram» — ital. «vuol colpire e uccidere» ose «për të pushkuem e për të përvum mishtë tanë» — ital. «per colpire e mortificare la carne nostra», Pj. II, f. 25, pika 8), *virgjenohem* etj. Ndër foljet më -o gjejmë te Bogdani edhe ndonjë folje me interes të veçantë që ai e ka gjurmuar në visarin e shqipes popullore ose e ka krijuar sipas modeleve të saj. E tillë është, p.sh., folja *ndoroj* me kuptimin «e marr në dorë dhe e rregulloj. administroj. qeveris»: «Pak, as gja ushtëri, / Po Regj e nji Qefali, / *Ndoron* dhenë me godi» — lat. «Multos esse duces, aut quidquam, proderit: esto/Rex unus, Princeps unus, qui publica tractet»; pra *ndo-*

roj i përgjigjet latinishtes *tractare, administrare* (shih Pj. I, f. 5, pika 19); nga kjo folje mund të formoheshin fare mirë edhe *ndorues-i* si *nomen agentis* (edhe si mbiemër — *ndorues-e*) për «administrator» e «administrues-e» dhe *ndorim-i* si *nomen actionis* për «administrim».

Krahas foljeve më -o, te Bogdani gjallërohet edhe përdorimi i foljeve të formuara me konversion ose me anë të parashtesimit e të prapashtesimit njëkohësisht, siç janë p.sh. foljet *pikem, (m)pakem, përhanem, përhiem, përmjaltem, përrundyrem, vërtetet* («kjenë vërtetunë» — ital. furono verificati», Pj. I, f. 7, pika 1) etj. Dendur takohen edhe foljet me parashtesën për me kuptim përforcues, intensiv, si p.sh. *përthaj, përftoj* («të dërgon Lazërinë me përftofunë» — ital. «che mandasse Lazaro a rinfrescarlo», Pj. II, f. 82, pika 34), *përflak, përgëzoj* («kush më përgëzon» — ital. «chi mi carezzerà». Pj. II, f. 125, pika 3), *përkujdesem* (= «bie në kujdese e kokëçarje të mëdha, shqetësohem shumë»: «kje aqa përkujdesunë prej së shoqejet» — ital. «talmente fu afflitto dalla sua moglie», Pj. II f. 49, pika 17; edhe në Pj. II, f. 109, pika 7 përktëhet italisht «afflitto e abbattuto»), *përderdhem* («Çoftu Hyji e u përderdhsinë anëmijt e tijnaj» — lat. «Exurgat Deus et dissipentur inimici eius», Pj. I, f. 107) etj.

4. Përveç këtyre kategorive kryesore leksiko-gramatikore të formuara si fjalë të prejardhura, Pjetër Bogdani e ka zgjeruar mjaft edhe përdorimin e ndajfoljeve më -isht, që në kohën tonë janë bërë tipi më prodhimtar në gjuhën letrare. Tek ai gjejmë: *miqësisht, gjakësisht, moralisht, letërisht* etj. Këto ndajfolje nuk pengojnë përdorimin e rëndomtë të ndajfoljeve popullore më -shëm si: *gëzueshëm, hieshim, mënishim* etj.

5. Te «Çeta e profetëve» shtohet, në krahasim me autorët e mëparshëm, edhe numri i *kompozitave përcaktuese*, sidomos i atyre pronësore të tipit bahuvrihi dhe, krahas tyre, takohen edhe *kompozita këpujore*:

a) përcaktuese: *cmirkeq-e, fatamirë, barkkëqijtë, plakë barktharë, barkthatë, dijekeq-e, dijekeqia* em.f., *gojëartë, hërplotë, jetëgjatë, vepërëkqij* etj., *dyfijesh, tetëditsh; të parëlemët* etj.; po ashtu *bamkeq, bajbukës* (=bukëmbajtës, ital. «paniere»), *shkalëbaltë* («shkalëbalta e polemiti» — lat.

«abiectio plebis», Pj. II, f. 109, pika 6; kjo është kompozitë e vjetër e tipit *djegagur, thirravajë*) etj.

b) këpujore: *ngoja ngoja* (lat. «os ad os» — pj. I, f. 3, krhs. edhe ndërtimin frazeologjik që mund të shkojë edhe në përngjitje: *faqe n'faqe* — lat. «facie ad faciem», Pj. I, f. 95, pika 41) etj.; *mballamballa, mballafaqe* e *mballëfaqe* («të përzanëtë e Qefalivet anshte mballëfaqe» — ital. «la persecutione de prencipi è manifesta», Pj. , f. 108, pika 14); pjetëposhtë («veshëshit *pjetëposhtë*» — ital. «dalle orechie in giù», Pj. II, f. 36, pika 15) etj. Takohen, krahas këtyre, edhe kompozita iterative, si *palë-palë* (shih. Pj. I, f. 158) etj. Edhe për kompozitat burimi kryesor është vetë gjuha e gjallë e popullit.

Në fondin e fjalëve të prejardhura e të përbëra që përdoren te «Çeta e profetëve» ka edhe shumë *neologjizma* të goditur të Bogdanit, siç janë, p.sh. *landëtar* («marangoz, zdrukthëtar»), *ligjëtar* (lat. legislator), *gjuhëtar* (= «gojëtar», lat. *eloquens*), *fjalëtar* (ital. «loquace»), *fqinjëtar, kallëzor* (= «tregues i lëndës»); *madhi-a* (ital. «maestà»), *bi-jëni* (ital. *figliolanza*), *fëmijëni, shtrigëni-a, dhuni, fisniki, grykësi, bashkari* («miqësi, lidhje e përbashkët»); *manesë* (= «vonesë»); *feshim, ndajf.* (ital. «fedelmante») etj. Ndonjëra prej këtyre fjalëve mund të jetë nxjerrë nga ligjërimi i gjallë popullor, por është pikërisht, Bogdani ai që i ka vënë këto fjalë në një qarkullim të gjerë letrar.

Një çështje që ia vlen të studiohet më vete është përdorimi i *huazimeve* te Bogdani. Në përgjithësi, mund të themi që këto në Veprën e tij janë relativisht të pakta. E kemi fjale n kryesisht për turqizmat⁷, serbizmat, e në një farë mase edhe për italianizmat. Kjo nuk është diçka e rastit. Një dukuri e tillë e ka burimin sidomos te shqetësimi i thellë i Bogdanit për huazimet e tepërta që kishte marrë shqipja nga gjuhët fqinje («gjuhëshit konfinjëtare») dhe te bindja e tij se në gjirin e gjuhës amtare kishte fjalë që mund t'i bënin të panevojshme këto huazime. Ndryshe qëndron

7) Pjesa më e madhe e turqizmave që përdoren në «Çetën e profetëve» janë kryesisht terma administrative ose të fesë islame, si *bajrak, sanxhak, nazar, sejmen, xhelat, myfti*, etj., ndërsa fjalët që shënojnë sende e dukuri të rëndomta, orendi etj. janë më të pakta (shih, p.sh., *sexhade*, Pj. II, f. 111, pika 11 etj.).

çështja me *ndërkombëtarizmat* si terma të shkencës e të kulturës evropiane. Këto te Bogdani, për vetë karakterin e Veprës së tij, takohen mjaft shpesh. Tek ai gjejmë fjalë ndërkombëtare si *alegori, bibliotekë, centurion, ceremoni, element, embrion, etiologji, eglogë, gramatikë, hereti, here-tik, hipostatik-e, legjon, matematikë-a, mausole-a, meteor-i, metaforë, mister-i, mistik-e, monark-u, monarki-a, para-frazë* etj. Siç dihet, këto fjalë e të tjera si këto i ka edhe shqipja e sotme letrare.

Me të gjitha këto mjete leksiko-gramatikore në veprën «Çeta e profetëve» arrihet një risi e një ripërtëritje e gjuhës së shkruar shqipe pas dy shekujsh robërie. Nga kjo pikëpamje, kanë rëndësi të veçantë dy aspekte. Së pari, mënyrat, modelet e mjetet fjalëformuese që aktivizohen nga Bogdani, janë në pjesën më të madhe po ato që do të përbëjnë *prirjet kryesore* të zhvillimit të fjalëformimit të shqipes letrare në shekujt XIX e XX. Së dyti, në këtë rrugë të gjuhës letrare nuk ka rëndësi vetëm zgjerimi *sasior* dhe larmia më e madhe e mjeteve leksiko-gramatikore në krahasim me të kaluarën. Thelbësore është që Bogdani ka bërë përpjekje dorëmbara për t'i integruar këto mjete në *një sistem tërësor e në lëvizje*. Ndryshe nga pasqyra që del në Fjalorin e Frang Bardhit, në të cilin jepet një *kod leksiko-grafik dygjuhësh*, i mbështetur te leksiku *i latinishtes*, që merret si pikënisje e si mbështetje (dhe kjo është, pa dyshim, një vepër me rëndësi historike për gjuhën letrare shqipe e për gjuhësinë shqiptare), te Bogdani gjejmë *një sistem të mjeteve leksikore-fjalëformuese e gramatikore të shqipes në veprim*, sistem që qëndron në *rrafsh të parë* e funksionon si i tillë pavarësisht nga gjuha e huaj, në të cilën është përkthyer vepra. Autori i vë këto mjete në marrëdhënie të ndryshme, mjaft herë edhe të reja, nëpërmjet diferencimit, modifikimit e pasurimit të vlerave të tyre semantiko-strukturore e funksionale, duke qëndruar në truallin e realitetit historik e shoqëror dhe gjatë përpunimit të tyre hedh vështrimin në të ardhmen, duke e parë të lidhur ngushtë fatin e gjuhës me fatin e popullit.

II. RRAFSHI FUNKSIONAL

1. Mund të themi se në veprën e gjerë, shumërrafshore e shumëtemëshe të Bogdanit mishërohet një punë e jashtëzakonshme kërkimore-shkencore dhe krijuese-artistike që e fut shqipen me vetëdije e me guxim të pashoq, por plotësisht të përligjur, në rrugën e një gjuhe letrare polivalente, siç ishin mjaft gjuhë të tjera letrare të Evropës në atë kohë. Vepra «Çeta e profetëve» është përpjekja e parë e mirëfilltë për diferencimin e *stileve funksionale* në shqipen letrare. Baza e këtij diferencimi është vetë larmia e tematikës dhe qëllimi i autorit për të krijuar një vepër që jo vetëm t'u jepte lexuesve njohuri të ndryshme, të ndriçonte mendjet e tyre, siç shprehet ai, me «nji qiri ndezunë në dorë», por edhe të ndikonte tek ata në kahe të caktuara. Për Bogdanin nuk mjaftonte që shqipja vetëm të shkruhej. Me një ndjenjë besimi e krenarie ai kërkonte me këmbëngulje që ajo të shkruhej bukur, bile të tingëllonte po aq bukur sa edhe *italishtja*. Kështu, ai i shtronte gjuhës letrare kërkesa të larta estetike për kohën e vet, që të kujtojnë kërkesat e Anaksimenit, të Aristotelit e të Varronit. Në «Të Primtë përpara letërarit» ai e përsërit disa herë këtë: «me të shkruem bukurë», për «bukurin'e gjuhësë», «dëshërova mirëfilli qish po flasmë italianisht, bukurë të kumbon e të kallëzon arbënisht». Dhe, megjithëse ai vetë pohon se në Veprën e vet bukurinë e gjuhës nuk e ka arritur në atë shkallë që dëshironte («nuk e ka ndjerë ndanet»), mund të themi që ka mundur të përvijojë pak a shumë *katër tipa stilesh sipas funksioneve të ligjërimit letrar*.

Në të kemi:

a) Pjesë tregtimtare që karakterizohen nga një para-shtrim i lirshëm i legjendave biblike. Të tilla janë, p.sh., «Jeta e Jobit», «Jeta e Isaisë», «Jeta e Jeremisë» etj.

b) Pjesë shpjeguese didaktike të tipit mësimor: a shkencor-popullor, Në to bashkohet qartësia e thukëtia e gjuhës së një teksti mësimor me thjeshtësinë e qartësinë e shtjellimit të ligjërimit popullor, çka është karakteristike për punime që synojnë t'i përhapin dijet në masa të gjëra. Të tilla janë, p.sh., pjesët ku flitet për pikëpamjet e astrologëve në lidhje me shkallët e moshave të njeriut (shih Pj. I, Sc. I, Ligj IV, pikat 42-48), pjesët për Sibilat etj.

Si pjesët tregtimitare, ashtu edhe ato didaktiko-mësimore janë mbështetur shumë gjerë në të folurën popullore, prandaj mund të thuhet se i takojnë stilit bisedor-letrar.

c) Pjesë që i takojnë kryesisht stilit shkencor, e, në përgjithësi, *ligjërimit libror*, me një ngarkesë të madhe intelektuale, me një terminologji të posaçme e më të dendur, me përpjekje për një strukturë sa më të përmbajtur, me periudha të gjata me shumë lidhëza nënrenditëse, sidomos me periudha që ngërthejnë fjali të varura lidhore me përemrin «i cili» («i silli», «të sijtë»), çka, siç dihet, nuk ndodh në gjuhën e folur popullore etj. Të tilla janë p.sh. pjesët për eklipsin e diellit dhe të hënës (Pj. 1, sc. 1, Ligj. IV, pikat 49-51), përasiatjet filozofike, polemikat shkencore etj. Zakonisht në këto pjesë që i takojnë ligjërimit libror ndihet më shumë se në pjesët e tjera ndikimi i formimit kulturor-gjuhësor të Bogdanit (nëpërmjet italishtes e latinishtes) mbi sintaksën e tekstit të tij në gjuhën shqipe⁸.

Në trajtimet shkencore duket më mirë se në pjesët e tjera të Veprës puna shumë e thelluar dhe e imët e Bogdanit për të ndërtuar në mënyrë sistemore një *terminologji* sa më të përshtatshme e të kuptueshme, të bazuar tërësisht a gjerësisht në lëndën e shqipes. Ai përdor *rruzullim-i* për «univers» (it. universo Pj. I, f. 1), të *marrët e diellit e të marrët e hanësë* për «eklips i diellit» dhe «eklips i hënës» (ital. *l'eclisse del sole, l'eclisse della luna*; në Pj. I, përkatësisht në f. 29 e 30), ose të *zanët e dritësë* për «eklips» në përgjithësi (Pj. I, f. 30), të *kjanë të ngulë e të vërtetë* për «substancë» (it. *sostanza*, Pj. I, f. 9), të *neveritunitë* për «herazi» (duke dhënë edhe përkufizimin përkatës: «të neveritunitë nuk anshtë tjetër, veçse një të daam e të larguem së shkrue mit shenj, e njanit, e tjetërit testament», Pj. I, f. 3, pika 6); *kallëzor-i* për «indeks» (it. «indice», në fund të pjesës II: *kallëzor i shkallëvet e i ligjëratëvet...*), të *rrethpremitë* në vend të turqishtes «*smet*» (it. «*la circoncisione*», Pj. II,

8) Shih p.sh.: «... nukë anshtë vend, ku nuk anshtë Hyj, *prashtu* as ka ke hipën, as ke zdripën. Mbi Qielli të Qiellit, *i silli* anshtë Qiellja e Empirit, *ndë të sijt* qëndrojnë gjithë të tjerëtë, e anshtë ma i nalti» (krhs, latinisht e italisht: «... *non est locus, ubi non est Deus; però non ha dove ascendere, ne ove descendere. Super coelum Coeli, quale è il Cielo Empireo, nel quale si contengono tutti gli altri ed è l più alto*» (Pj. I, f. 107, pika 13).

f. 24), Me një sistem të plotë termash shqip i jep P. Bogdani edhe fazat e ndryshme të jetës së njeriut: moshën që nga lindja deri në 4 vjet ai e quan *kërthinjësia*, nga 4 deri në 14 vjet — *fëmijësia*, nga 14 deri në 22 vjet — *djelmësia*, nga 22 deri në 41 vjet — *trimësia*, nga 41 deri 56 vjet — *burrësia*, nga 56 deri në 63 vjet — *pleqësia* dhe nga 68-98 vjet — *pleqësia e mbetunë* (shih Pj. I, f. 28 e 29). Kështu vepron ai edhe për terminologjinë e mjaft fushave të tjera, duke përfshirë edhe vetë terminologjinë fetare. Ai përdor, p.sh., termin e përbërë «*punë të fshefuna*» për «misteret» («misteri», Pj. I, 71, pika 5), «*punë fort të mbëlueme*» për «sakrament» (Pj. I, f. 72, pika 7), «të shtërguem të nfshefunë», për «mistik», ital. *mistico* (Pj. I, f. 74, pika 11) etj. për t'ua bërë sa më të kapshme këto nocione njerëzve të thjeshtë, por, njëkohësisht, edhe për ta ruajtur gjuhën letrare nga huazimet e tepërta. Edhe mjaft thënie latine ai i jep shqip në gjuhën popullore (shih p.sh.: lat. «*Et misit serpens ex ore suo aquam, tanquam flumen*» — shqip: «*E dërdhi gjarpëni gojet e gryket së vet ujë posi lum*», Pj. I, f. 60, pika 20 etj.).

Mund të themi pa e tepëruar se Pjetër Bogdani bëri me vetëdijen shkencore të një gjuhëtari të vërtetë hapat e parë për të shfrytëzuar gjuhën e folur të popullit tonë jo vetëm për terma të veçuar, po për *sisteme* të caktuara terminologjike. Ai i çeli sidomos rrugë të gjerë në terminologjinë e gjuhës letrare procesit të fjalëformimit prapashtesor, që pati marrë një shtysë të dukshme e mjaft sistemore që në «Fjalorin latinisht-shqip» të Frang Bardhit (1635).

Më vete është për t'u theksuar këtu se për herë të parë në historinë e shkrimeve të shqipes Pjetër Bogdani na jep në Veprën e vet edhe një shëmbull të shkëlqyer të *stilit publicistik epistolar*, që i takon, në thelb, ligjërimit libror. Këtë ai e bën në përkthimin e një letre, me të cilën Jan Huniadi i përgjigjet despotit të Serbisë, Gjergj Brankoviçit⁹⁾.

9) Shih në fund të «Cunues prophetarum»: «Letëra dërguem prej zotit Giurë Despot zotit Jan'k Vojvodës së Dunavit» dhe sidomos «Përgjegji zoti Jank zotit Despot». Kjo letër, siç thotë vetë Bogdani, qe shkruar rreth vitit 1450. Rrethanat historike ishin këto: «Në kohën kur po nënshkruhej paqja shqiptaro-venedikase, Huniadi, sipas marrëveshjes që kishte përfunduar me Skënderbeun, kishte

Nga vetë teksti duket qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me një përkthim të thjeshtë e të fjalëpërfjalshëm, por kemi një përkthim origjinal në rrafshin e shprehjes. Në të Bogdani përdor me mjeshtëri të rrallë mjetet shumë të larmishme të shqipes (njësi frazeologjike, epitete të goditura, antiteza, ndërtime të veçanta sintaksore, sidomos ligjëratën e drejtë me fjali pyetëse e urdhërore etj.). me përmbajtje kuptimore të pasur e të ngjeshur dhe me konotacione të theksuara keqësuese, plot sarkazëm dërrmues, plot ironi therëse e të hidhur, që e bëjnë lexuesin ta urrejë e ta përbuzë pa mëdyshje fytyrën e shëmtuar të tradhtarit dhe të mos i besojë kurrë të pabesit, sado lajkatare qofshin fjalët e qëndrimet e tij të shtira e mashtruese.

Po japim këtu një pjesë të përkthimit të kësaj letre me vlera të dalluara krijuese, që nuk është vënë re nga stu-

filluar marshimin drejt Jugut, këtë radhë duke kaluar jo më nëpër viset lindore të Gadishullit, si në dy rastet e para, por nëpër Kosovë, Skënderbeu, qëllimi i të cilit ishte të bashkohej me forcat hungareze, nuk u nis dot me kohë për shkak të zgjatjes së bisedimeve me venedikasit dhe të pengesës që gjeti rrugës nga despoti i Serbisë, Gjergj Brankoviçi, i cili nuk donte t'i prishte marrëdhëniet me sultanin dhe mbajti një qëndrim armiqësor kundrejt hungarezëve dhe shqiptarëve. Ky vuri në dijeni sultanin për lëvizjet e Huniadit dhe e ndaloi Skënderbeun të kalonte me ushtritë shqiptare nëpër tokat e veta. Kështu, forcat shqiptare ishin akoma në rrugë, kur më 18 tetor 1448, në fushën e Kosovës, afër Prishtinës, ushtria hungareze pësoi një disfatë të rëndë dhe u detyrua të tërhiqej e shpartalluar nëpër Serbi, drejt Danubit dhe pjesërisht nëpër Shqipëri, drejt bregdetit. Në tërheqje e sipër Huniadi u zu rob nga Brankoviçi. Si përgjigje për qëndrimin e pabesë të Brankoviçit, forcat shqiptare sulmuan e shkretuan një pjesë të tokave të tij» (shih «Historia e Shqipërisë», vëll. I, Tiranë, 1959, f. 284). Nga vetë përkthimi e botimi i përgjigjes që i dha Huniadi letrës lajkatare të Gjergj Brankoviçit, i cili kërkoi ndihmë më vonë, kur u ndodh ngushtë, del qarë se Pjetër Bogdani e njëjtte mirë historinë e Shqipërisë, sidomos epokën e Skënderbeut dhe mbante një qëndrim të prerë e luftarak kundër atyre që kishin synime antishqiptare. Botimi i kësaj letre ishte një thirrje për gjithë shqiptarët që të dallonin mirë miqtë nga armiqtë dhe, duke i gjykuar këta jo sipas fjalëve, po sipas veprave, të ruheshin nga lajkat e armiqve të pabesë e të mos lejonin që këta t'u futnin thikën pas shpine.

diuesit e derisotëm dhe që meriton të botohet e plotë në çdo antologji të letërsisë shqipe, si dëshmi e shkallës së lartë të përpunimit artistik të gjuhës sonë amtare.

«Përgjegji zoti Jank zotit Despot»

Mbasi prej teje e tradhëtijet soteje, po gjindemi fort ungunë e ligunë, e vetë Turku zemëruem e madhuem, më duhetë me lot m'sy kështu me të përgjegjunë:

Tue kujtuem se për të padërejtat vepëratë tua Mengjilleja jote (ital. «la tua vigilia») ban me dijtunë mue me gjithë Serbi e Ungëri të pësuemënë festë («thonë se kje Zonjet ndë Gusht» — sqarim i vetë Bogdanit), jam mbaj-tunë pra kështu me të thanë:

O i pafe, hajni i Tinëzot gjithëpushtueshmit, s'je i fesë Krishtit, i gjakut tit, ende i mue t'vobekut Vojv(o)dë! As të bje ndë mend motit, kur u mbëlodhmë gjithë bashkë? E besëjet e permetesëjet (= «premtimi» — A.K.), qi dham ndër vetëhe na të kërshterë me bam gjithë forcënë e vërtytnë tanë e me votë me gjetunë Zotnë Turk mballa mballa, përpara se aj të vin mbë shtëpit tona? Ndë të sijët besë e fe të kërshtenë bam na be përmbi shintënit ungjij të Tinëzot, me mbaj-tunë benë me bes'e fe, me u gjetunë mbë vend qi kishim vum ndër vetëhe për rok (= «afat, kohë» — A.K.). Nd'atë bashkëri kje trimi Vlatkë Mladenoviçi me vllah të vet, kje fatosi Skanderbeg me t'Arbëneshët, kje ende tradhëtija jote me të vobekit serbijas, kjeshtë edhe unë i vobeku vojvodë me besnikët e trimat ungërë, mbasi kje dhanë besa, e shenjuem dita, me u gjetunë mbë vend qi i thonë KOSOVE (COSSOVE). Unë për të mos mënguem besësë e posi i zellshim e i dashunë me mbaj-tunë e ruejtunë nderë të t'mjerit kërsh-tenim, u vunshë («u vëshë» — A.K.) mb'udhë e ndër kohët mbërrina mbë vend qi kishim thanë. Ku, ndëpër të shtremënat punëtë tua, disa asish përpara thanë zotënish së kërshtenësh nuk u duknë, mb'atë vend; veç të panjehunatë cerga, shatorre me ushtëri të zotit turk e njëheri përduerë (përdorën < përduernë — A.K.) boritë, lodërtitë e curletë, tue dhanë shenj për luftë, e njëheri hipnë kualet, tue u shtym prej gjindjet simejë së vobekët, aqan' sa ndevonë pakmos («pothuajse» — A.K.) gjithë mbetnë mb'atë vend dekunë e shprishunë. Mue t'vobekut vojvo-

dë m'u desh me të madhe dhunë me ikunë ndër malet që u thonë Çiçavica, ku për fat tem të mirët u pojshtë («u poqa» — A.K.) mbë BOGDANË, të sillënë bana vëlla m'Tenëzonë, tue lutunë të më shpij ndë gjytet tande të Sëmendrësë (= Smederovo — A.K.), tue kujtuem se keshë me kjanë prej teje mirë pam e se kish me t'ardhunë keq për të këqiatë mia, mbë një mëndyrë kund tue u lam tradhëtijet soteje, ku rashë mbë gjunjë, ndër kambëtë tua tue kjam e tue kallëzue të këqiatë mia. E ti mbë vend me më ngushëlluem, mbisi («mbasi» — A.K.) më shtive ndër t'erratë burgjetë tua, gjukove («gjykove» = urdhërove — A.K.) me më lidhunë gurë n'fyt e me më mbytyjnë ndë Dunaut, ku, ndëpër të lutunatë të tregëtarëve Dubronikut, më dhe (në tekst «më dhae» — A.K.) mot ndër-mjet (= «më dhe kohë» — A.K.), me mos më dhanë kë-shtu mort të çpejtë, e jo prashtu le (në tekst: «lae» — A.K.) me mos më mbajtunë shtrenjt mbështelë e me so-gje ndër burgjetë tua. Atë punë [e] ndjenë zot ungërit e mij, të sijtë kuvenduenë ma para me bjerrë Regjënin'e Ungërisë se ma me më lanë ndëpër' mizoret duertë tua, e kështu dërguenë ushtërinë prej Dheut sit, tue djegunë, tue prëm e tue çartunë dhenë, posi viset' e anëmikut kre-së, tue mbajtunë prej Sëmendre e me zemërë fort të keqe, të silënë punë tue pam të parëtë banat e tu («ban = hist. qeveritar i një krahine — A.K.) duelë përpara ty, tue të bam me dijtunë e tue thanë o me më lëshuem, ndose (= «ose, përndryshe» — A.K.) kishnje me bjerrë dhenë me jetët tande. Atëhere, tu kujtuem vërtynë të Zot ungëret, tue mos munjtunë me bam ndryshej, më lëshove. Aqa («aqë» — A.K.) sa mue nukë më përket, për aqa të madhe tradhëti tande e mizori, me thijem pajnë («paqën» — A.K.) me ushtëri me zotënë turk; përse, një tjetër herë me mbetunë tradhëtue më shtremunash punësh së tuash, zot ungërit e mij me gjithë të tjerë të kërshtenë kishinë me pasunë arrësye me më kthuem shpinënë ndëpër gjithë të këqiatë mia e me të madhe dhunë e mbarre keshë me të dhanë atë ndihmë. Ashtu, pra ti sa të mundesh qandro («qëndro» — A.K.) e u ndihmo, e prej meje mos shpëre ndonjë ndihmë!..

Kjo letër ka vlerat estetike të një pamfleti të vërtetë, që zbulon e fshikullon haptas, me ashpërsi e pa më-

shirë, tradhtinë, pabesinë dhe egërsinë e despotit serb. Përballë tij, në letër ngrihen lart virtytet e shquara të popujve e të prijësve të tyre që luftojnë për çështje të drejta: — dashuria për liri, nderi, besa, trimëria e fisnikëria shpirtërore, qëndresa e përpjekur, uniteti popullor, bashkimi i të gjitha forcave në luftërat çlirimtare kundër pushtuesve të huaj e veglave të tyre. Këto virtyte dalin të përqendruara e të vijëzuara me mjete të fuqishme gjuhësore si te figura e Jan Humiadit, «heroit lirik» të vetë letrës, e tek ushtria çlirimtare hungareze, ashtu edhe te dallimi i veçantë e lartësimi i besnikërisë e i trimërisë së «fatosit Skanderbeg» dhe të «t' Arbëneshëve». Bie në sy këtu që edhe emrin e trevës ku u bë beteja Bogdani e shkruan në trajtën shqipe — **KOSOVË** dhe jo «Kosovo» («... mbasi kje dhanë besa, e shenjuem dita me u gjetunë mbë vend qi i thonë Kosovë»). Kjo dëshmi e Bogdani ka rëndësi jo vetëm për gjuhën e gjuhësinë, por edhe për historinë etniko-demografike, politiko-shoqërore e kulturore. Ky është i pari pamflet i gjinisë epistolare në gjuhën letrare shqipe.

c) Pjesë që kanë vlera të vecanta *estetike* dhe që i takojnë *stilit të letërsisë artistike*. Këtu hyjnë pjesë që mund të quhen prozë poetike dhe *krijime të mirëfillta poetike*. Si model i një proze të tillë mund të quhet pjesa letrare, në të cilën Bogdani bën portretin fizik e moral të vashës Mari:

«As e madhe, as e vogëlë, po e naltë sa duhej; e zeshkë, (po) fort e bukura. Faqieja e sajnaj mbaj si më të gjatë, sytë të mëdhenj si më të verdhë, vetullatë e zeza si ark, hundët e ajata, [po] fort të bukura. Shtati i njimendunë e prej sinëzot mbukuruem me gjithëduer bukurie. Goja e vogëlë, buzëtë të kuqe, kambëtë të vogëla e të bardha si dvora (në tekst: «të vogëlë e të bardhë»). Flokët e ndricim e nosi ar. Duertë e gishtatë e gjatë. Thonë se kie pa kuer e bukurë...»

Kemi këtu portretin e gjallë të një vashë shoqërore me tiparet që vlerësohen nga populli ynë. Dhe kjo duket kur menjëherë Bogdani e lidh këtë vashë «pa kuer të bukurë» — fizikisht e moralisht, me bukuritë e rralla natyrore të virgjëra të maleve të Kosovës.

«...Bora anshtë aqa e ftofëtë, sa tue e soditunë nieri, ende ndë majë të Lubotenit, ndë mjedis të verësë, i duket se po ngrin. Kështu goditetë (= «ndodh» — A.K.) mbë shumë femëna të ndershime, ndonëse janë fort të pashime: janë aqa të mbarëshme e të ndershme sa, tue i soditunë, fikinë thëngjijtë e ndezunë. E janë të tjera aqa të pafaqe e të pambarshime, sa ndezinë unëtë e shqimëta» (Pj. II, f. 27).

Veçori të tilla gjuhësore e stilistike të një proze artistike ka edhe portreti i Krishtit, që nuk jepet si një figurë e zbehtë, e pagjak dhe e pajetë, e papërcaktuar, por përshkruhet me ngjyra të gjalla e me tiparet fizike e morale të një djaloshi nga viset malore të Shqipërisë Veriore; këto tipare të kujtojnë përshkrimin që u bën Plutarku luftëtarëve ilirë:

«Anshtë një nieri gjithësej i ungjinë (ital. «del tutto intero») e i pëlqyeshim. Anshtë i naltë, ma jo pa kuer, fort i hieshim e i bukurë atij qi e soditën. Ka një faqe (= «fytyrë» — A.K.) të tmershme (= «të rreptë», ital. «severa») e të ndershme e të dashunë. Ka flokë të verdhë si mbë të kuq posi ar. Ndjerë (= «gjer, deri» — A.K.) mbë veshë rrjedhënë lëmuem; veshëshit e pjetëposhtë janë rudë, si ma mbë të verdhë e ja mbërrinjë ndjerë ndër krahë. Ka një ballë të pëlqyem e fort të bukurë, pa ndonji lye, mbukuruem me një faqe të bukurë e të ndezëtë. Goja e hundëtë s'kanë si banhenë ma të mira. Ka mjekër të mbrytëtë (= «të dendur»; ital. folta)... Ka një të soditunë («vështrim, — ital. «ha un guardar») mbë të madh (= «madhështor»; ital. «maestoso») e fort të ndershim. Ka syt e kulluem e të ndriçim posi dy yj... Ka gjithë gjymtyrëtë të njimenduna (= «në përputhje, në harmoni»; ital. «proporzionali») për shtat; duertë e gjata e të dërejta, krahët fort të bukurë. Flet pak e me një të madhe njerëzi...»

(Pj. II, f. 36, pika 15)

Të dy këto portrete — të vashës e të djalit me tipare shoqiptare — në të cilat e bukura dhe e madhërishmja në thjeshtësi shtrohen si një kërkesë e jashtme dhe e brend-

shme për njeriun, na kujtojnë pikturat e Onufrit, mjeshtrit tonë të madh të shekullit XVI, i cili me penelin e vet depërtton në botën e brendshme të figurave që pikturore e u jep atyre tipare individuale e plot gjallëri, i frymëzuar nga njerëzit që e rrethojnë, nga jeta reale e popullit të vet.

Vlera të theksuara artistike arrin proza poetike e Bogdanit sidomos në dy vajtime — të nënës përpara të birit që ia vranë mizorisht dhe të nxënësit për mësuesin, mjeshtrin e vet të vdekur:

a) «Ah, biri em, sa ndryshej njerëzitë mue ty po të kthejnë, asi qi unë atyne u dhashë ty. Unë ty atyne të dhashë të bukurë e ata mue tye po të kthejnë gjithë të shemptuem; unë ty atyne të dhashë të gjallë e ata ty mue po të më kthejnë dekunë. Atyne unë ty u dhashë për ngushëllim e ata mue po të kthenjënë për një të madh çngushëllim. Oh, biri em, si të dhimptunitë kur të leva ma hoqe, tash mortnë tande dy herë po e ndienj. Oh, Simeonë... sa të vërteta duellë fjalëtë qi më the (në tekst: «thae» — A.K.) se një kurtjelje (= «thikë», në tekst: curtieglie — it. coltello) së dhimptuni kish me më depërtuem shpirtinë: jo një, po një mijë të dhimptuna më kanë depërtuem. Oh, biri em, se ma sut' e mij ma m'u shterrë e s'kanë lot me shtim jashtë. Gjuha eme mbetunë e ma fjalë po i mungojnë për të anëkuem»:...

(Pj. II, f. 125, f. 2 e 3)

b) «Oh, Mjeshtri em, qish të banj unë pa ty? Kush më përgëzon ma posi ti më përgëzove? Si të jes unë gjall' tue pam ty dekunë? Sa ndryshej kje këjo ditë asoje së shkue-met? Dje tue fjetunë më mbanje kryetë mbë prehenë, sod po të mba unë të dekunë përpara syvet? Dje më bane shumë të mirë e sod po më shtie kaqa t'idhunë ndë zemëret teme».

(Pj. I, f. 125-126)

Të dy vajtimet ndërtohen nga Bogdani në ligjëratë të

drejtë, me apostrofime të drejtpërdrejta e të thekshme, ashtu siç ndërtohen vajet popullore të shqiptarëve. Kjo e bën më të fuqishme shprehjen e ndjenjave, duke theksuar se ai, të cilit i drejtohet vajtuesi, është për të njeri shumë i dashur i zemrës.

Nëpërmjet dendësimit të epiteteve Bogdani arrin në këto pjesë e në pjesë të tjera të ngjashme me to (të tilla janë, p.sh. përshkrimi i botës së re, të lirë e të ripërtëritur, pas gjyqit universal, si një ëndërr e njerëzve — Pj. II, f. 159, pika 19; përshkrimi i ferrit me nota danteske — Pj. II, f. 160, pika 21 etj.) një lakonizëm të rrallë të shprehjes dhe na jep një tablo të gjallë të bukurisë së njeriut e të tokës. Ai e lidh hijeshinë e krenarinë e vashave shqiptare e të djelmoshave shqiptarë me bardhësinë e me madhështinë marramendëse të majave të Lubotenit, me bukurinë e kësaj *terra magica* që të mahnit në çdo stinë e që ai e do si qënien më të shtrenjtë të zemrës. Kjo shkrirje, mund të themi edhe ky njëjtësim i njeriut me vendlindjen, i gjuhës amtare me At-dheun, si një ide e madhe poetike, gjallon te një varg mendimtarësh krijues, bij të shquar të botës shqiptare. Me këtë ndjenjë Bogdani iu drejtua majave të Lubotenit e të Pashtrikut, Naimi — maleve e fushave me lule të gjithë Shqipërisë, De Rada — valëve të detit që i sillnin zërin e mëmëdheut nga brigjet e Jonit e të Adriatikut. Po në të gjitha këto apostrofime ndihet një frymëzim i njëjtë. Dhe gjuhës letrare shqipe nga këto krijime i janë shtuar shumë vlerat estetike.

2. Duke pasur në zemër mesazhin historik e filozofik të epokës së vet. Pjetër Bogdani arriti ta *përpunonte e ta normëzonte* shqipen letrare në një shkallë të tillë që i bën nder atij dhe vetë gjuhës së tij amtare. Puna e tij normëzuese përfshiu të gjitha nivelet e strukturat e gjuhës. Ai u kujdes në mënyrë të shprehur e të përcaktuar edhe për ortoepinë e drejtshkrimin. Edhe vetë kjo përpjekje vigane dhe e zjarrtë për ta bërë gjuhën e popullit të vet një gjuhë letrare që të pasqyronte kulturën kombëtare e botërore është një dëshmi e qartë për lidhjet e thella të Bogdanit me frymën dhe me idetë e Rilindjes Evropiane. Kjo lëvizje e madhe mendore e shoqërore iu kundërvu mesjetës edhe në fushën e gjuhës: ajo goditi monopolin e latinishtes dhe kërkoi me këmbëngulje që të krijohejshin e të zhvilloheshin gjuhët letrare kombëtare si gjuhë të gjalla të kulturës e të shkencës. Mbroj-

tjen e shtjellimin e kësaj kërkese e gjejmë që në fillimin e shekullit XIV në veprën e njohur të Dante Alighierit «*De vulgari eloquentia*» (1304-1307). Në të ai jo vetëm hedh për herë të parë idenë që gjuhët letrare kombëtare të kohës së re të krijohen në bazë të gjuhëve të gjalla të këtij ose të atij populli, por kalon edhe më tej, duke i quajtur gjuhët e gjalla popullore më fisnike se latinishtja, sepse gjuhët popullore janë «të natyrshme», ndërsa latinishtja është «artificiale». Pikërisht këtë rrugë, të përqafuar nga mendimtarët e shkrimtarët më të shquar të Evropës, ndoqi me dorë shumë të mbarë edhe Pjetër Bogdani në shekullin XVII. Në Veprën e tij u brumos *e para koine e mirëfilltë letrare e gegërishtes* që ishte një sintezë e drejtpërdrejtë dhe mjaft e thelluar e vlerave të trojeve të hapëta gjuhësore — që nga të folmet Verilindore e deri tek ato Veriperëndimore. Mikrokoinëja «ndë dhe të Shkodrësë», domethënë përpunimi letrar që i ishte bërë shqipes në këtë qendër të lashtë të kulturës shqiptare, i shërbeu autorit të «Çetës së profetëve», siç pohon vetë, «me ndërequnë shumë fjalë», për një normëzim që të çonte përpara edhe traditën më të përparuar, por *baza e koinesë së tij ishte shumë më e gjerë*. Mund të themi se koineja që ndërtoi Bogdani si përgjithësim të evolucionit e të lëvrimit të gjuhës shqipe deri në pragun e shek. XVIII ishte, në thelb, edhe *e para koine e gjerë e gjuhës letrare shqipe*, me norma mjaft të ngulëta. Zbatimi i rreptë i disa parimeve themelore — (të parapëlqehet ajo që është më e përhapur e më e njohur përpara asaj që njihet më pak, të jepen format e fjalëve sa më të plota, duke ruajtur çartësinë e strukturës morfologjike e fjalëformuese, të parapëlqehet shqipja e popullorja, kur këto njihen, përpara së huajës e jo-popullore) e bëri gjuhën e Bogdanit mjaft të kuptueshme për të gjitha trojet shqiptare, e afroi atë jo vetëm me Rilindjen, por edhe me shekullin tonë. Siç dihet, përpjekje për një gjuhë shkrimi mbidialektore ishin bërë edhe nga shkrimtarët të tjerë të veriut para Bogdanit, — nga Gj. Buzuku, P. Budi. F. Bardhi. Këto ishin përpjekje shumë të frytshme e me vlerë historike, por ato ishin më të kufizuara si nga pikëpamja e *truallit gjuhësor*, ashtu edhe nga *shkalla e normëzimit*. Në anën tjetër, koineja e ndërtuar nga Lekë Matrënga në fund të shek. XVI, — koine mjaft e përpunuar dhe e normëzuar, — ishte, në thelb, një koine e toskërishtes jugore me rreze veprimi kryesisht në diasporën arbëreshe. Pjetër Bogdani bëri, si të thuash, bilancin e të gjitha këtyre për-

pjekjeve edhe në fushën e normëzimit të shqipes letrare dhe me guxim të rrallë e çoi traditën e përparuar në nivelin e gjysmës së parë të shek. XIX, kur atë e mori fort në duart e veta Rilindja Kombëtare.

*
* *
*

Vlerën e mirëfilltë të çdo personaliteti të shquar e tregon më së miri qëndrimi i brezave të mëvonshëm ndaj veprës së tij. Vepra e Pjetër Bogdanit pati një jehonë shumë të gjerë që në kohën e vet edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Autorin e saj e quajtën që në shek. XVII një Skënderbe të dytë për forcën e mendimit e për pasurinë shpirtërore¹⁰. Në botën mendore shqiptare figura e tij filloi të zinte një vend të dukshëm sidomos që nga gjysma e dytë e shek. XIX. Edhe veprës *gjuhësore* të Pjetër Bogdanit iu vu një vulë e qartë miratimi e vlerësimi të lartë që në epokën e Rilindjes Shqiptare, e cila e bëri traditën shkrimore të shekujve të mëparshëm një komponente themelore për ndërtimin e gjuhës letrare kombëtare. Ky vlerësim gjeti shprehjen më të përqendruar sidomos në «Fjalorin e gjuhës shqipe» të Kostantin Kristoforidhit, që është i pari fjalor gjithëkombëtar e mbidialektor i gjuhës shqipe. Në të, krahas fjalëve të nxjerra nga vepra e vëllimshme e Budit, janë përfshirë edhe mbi 450 fjalë të marra drejtpërdrejt nga Bogdani. Nga ky autor K. Kristoforidhi ka përfshirë në «Fjalorin» e vet sidomos një numër të madh emrash, mbiemrash e foljesh dhe një varg ndajfoljesh:

a) *emra: alëmisë-të, amëshim-i, anëkim-i, arushë-a, bërrak-u, bijëni-a, brrylli i parë (= «vjeshta e parë. shtatori»), burrëni-a, cmir-i, çëmim-i, dritëzë-a (= «kandile»), dromçë-a, fëlqinjë-a, fill-i, fisnik-u e fisniko-ja, gaforre-ja, gdhe-ni, gjase-ja, gjatar-i (= «gjahtar»), gjini-a (= «farefisi. të afërmit me lidhje gjaku») gju-ni (= «fara. origjina, bijtë, stërnipërit»), gjykatës-i, gjytetas-i (= «qytetas»), hu-*

10) Shih vjershën që i kushton Pjetër Bogdanit princi Petër Riçardi, i cili e përshëndet dhe e përgëzon autorin me vlerësimet më të larta. Kjo vjershë, e shkruar në Vjenë më 5 gusht 1685, është botuar në pjesën hyrëse të «Çetës së profetëve».

ni-a (= «uni, uria»), *hyjni-a*, *kacadre-ni*, *kallës-zi* (= «kalli»), *kërthi-ni*, *kreatyrë-a*, *krip-i*, *landëtar-i*, *lëqe-ni*, *luftëtar-i*, *të mbrumitë*, *mëzat-i* *mjalçezë-a* (= «bletë»), *mrimgë-a* (= «merimgë»), *ndihmë-a*, *ngadhënjyes-i*, *të ngjehunitë*, *njinesë-a* (= «agjinesë» *agjërim*), *pashnik-u* (= *mbulesë*, *kapak*), *patërshanë-a*, *patështinë-a*, *perëndeshë-a*, *perënduer-ori*, *petk-u*, *përbalcas-i* (= «mundës-i»), *të përkorëtë*, *polem-i*, *pronë-a*, *prutekë-a* (= «purtekë»), *të qanëtë*, *qandërë-a*, *rend-i*, *rezm-i* (= «trashëgim-i, trashëgimi-a»), *rremba-të*, *rrjetë-a*, *rrotullar-i*, *rrufë-ja*, *sandërgji-a*, *seli-a*, *skanj-i*, *sogori-a* (= «zogori-a, lukuni-a»), *sogje-ja*, *sogjetar-i*, *shestë-a*, *shelbues-i*, *shpellë-a*, *shterrëni-a*, *tmer-ja*, *tregjëti-a*, *thëniegullë-a* (= «thnegël-a»), *valtim* (= «vajtim»), *vijëzë-a*, *visar-i*, *zotënuer-ori* e *zotënore-ja* etj.;

b) mbicmra: *barkthatë*, *i dhimbëçim*, *i fështirë*, *dyfish-e*, *shumëfish-e*, *i marrë*, *i mbëshelë*, *i mbrotë*, *i çëmuem*, *mizor-e*, *i ndërdyshim*, *i ndërkamunë*, *i ngjyem*, *i përflakshim*, *i përhanunë*, *i përkorë*, *i përmallshim*, *i përpim*, *i plogë*, *i prapështë*, *i sëmundë*, *i shkjepëtë*, *i shtëmanjtë*, *i shtim* etj.;

c) folje: *ambëltoj*, *bukuronj*, *cof*, *çëmonj* e *çëmohem*, *çtiell*, *dëbonj*, *druej*, *dvesh*, *dvier*, *fërfulloj*, *fshij*, *gatoj*, *gjaj*, *humboj*, *lypinj*, *manoj*, *mashtroj*, *mbështie*, *mëshonj*, *msynj*, *nçef* (= «fsheh») e *nçifem*, *ndëshktoj*, *ndërkamb*, *ngadhënej*, *nguronj*, *nkryej*, *njimendem*, *njinoj*, *njoh*, *përbuzi* e *përbuzem*, *përpall*, *përtërij*, *plackis*, *shkjepoj*, *shkrepi*, *shpërej*, *tregjëtoj*, *tremj*, *thith*, *valtoj* (= «vajtoj»), etj.;

ç) ndajfolje: *gjithësej*, *huaza*, *idhunë*, *këha*, *këndy*, *kund* e *kundi*, *kundruell*, *mballë*, *mbaskëndajnaj*, *mëjaft*, *moti* (= «që prej kohësh»), *nçefazë* (= «fshehurazi»), *ngjetaj* (= «gjetiu, gjetkë»), *njimend*, *përgjymëzë*, *përsëriu* e *përsëriut*, *pjetëposhtë* etj.

Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve e shumë fjalë të tjera të përdorura në veprën «Çeta e profetëve» (të cilat K. Kristoforidhi për këtë ose atë arsye nuk i ka përfshirë në «Fjalorin» e vet, por që, pa dyshim, do ta kishin bërë më të pasur këtë «Fjalor») kanë hyrë tashmë në fondin e përgjithshëm të gjuhës letrare kombëtare, ashtu siç kanë hyrë edhe vlerat e tjera të veprës së Bogdanit në fondin e artë të kulturës e të shkencës shqiptare.

Gjatë këtyre treqind vjetëve që kanë kaluar që nga vdekja e tij vlera e kësaj Vepre ka ardhur duke u rritur. Këtë bir të Kosovës kreshnike e të gjithë Arbërisë epoka jonë e ka bërë të njohur, të nderuar e të dashur për të gjithë brezat dhe e ka vendosur në radhën e atyre njerëzve të mëdhenj të së kaluarës, me të cilët krenohet e do të krenohet gjithmonë mbarë populli ynë. Edhe përpjekjet që bën sot shkenca jonë për ta njohur më thellë e në mënyrë të shumanshme. Veprën e Bogdanit burojnë pikërisht nga ky vlerësim e nderim. Si një Vepër madhore, me shumë rrafshe, me shumë anë pozitive e me shumë probleme, «Çeta e profetëve» jep, pa dyshim, shumë mundësi edhe për analiza e sinteza të reja nga këndvështrimi gjuhësor e letrar. Në një nga veprat përgjithësuese të kohëve të fundit është thënë, p.sh., se Pjetër Bogdani u takon atyre përfaqësuesve të letërsisë së vjetër shqipe që krijuan «që së hershmi një urë për të kaluar te Rilindja Kombëtare. . .», e cila (Rilindja), sipas ndonjë studiuesi, «ishte një mohim dialektik» i letërsisë së shekujve XVI-XVII¹¹. Ne mendojmë se për veprën gjuhësore të Pjetër Bogdanit ky vlerësim nuk do të ishte as i plotë, as i përpiktë. Bogdani nuk ishte vetëm një urë kalimi nga një epokë në një tjetër, por ishte edhe një kulm, edhe një bilanc e sintetizim i veprës së disa shekujve, ishte kurorëzimi i një epoke të tërë të lëvrimin të shqipes në kushtet kur Dheu ynë, — siç theksohet te «Çeta e profetëve», — dergjej «ndë robi t'errëtë» nën «dy palë niegulla të zeza» («Të primitë. . .»). Për kohën e vet ai hodhi një hap të pashoq përpara për intelektualizimin e shqipes letrare, për ta bërë atë shprehëse të një kulture të ngritur bashkëkohore. duke e zgjeruar e thelluar njëkohësisht edhe bazën e saj demokratike. Me veprën e tij gjuhësore ai e kapërceu edhe shekullin XVIII dhe trokiti drejtërdrejt në dyert e Rilindjes. Kjo epokë e re historike, siç dihet, bëri edhe rivlerësimin e vlerave në drejtime e përmasa të ndryshme. Pa dyshim në këtë rivlerësim u pasqyrua objektivisht edhe veprimi i ligjit të mohimit të mohimit. Ndër të tjera, Rilindja e pastroi në mënyrë të ndjeshme gjuhën letrare shqipe nga fjalët e ndërtimit e huaja të panevojshme, por njëkohësisht edhe e pasuroi atë me ritme të pashembullta. Për këtë, siç dihet, rilindësit

11) Shih Historia e letërsisë shqiptare. Tiranë, 1983, pjesa «Pjetër Bogdani, 1625-1689», f. 41-47, sidomos f. 45.

male e në Shkodër, i shkruante Kongregacionit se këtë radhë jeta e tij ishte me të vërtetë në rrezik (*ma io che sto in un posto pericolosissimo della mia vita ho paura che questa volta actum sit de me*)²⁶.

*
*
*

Në kuadrin e luftës për mbrojtjen e kombësisë së tij nga rreziku i asimilimit turk, serb dhe grek, hyjnë edhe përpjekjet e Pjetër Bogdanit për lëvrimin e gjuhës shqipe. Njohëtimet më të hershme për këto përpjekje i ndeshim në vitin 1665, kur Pj. Bogdani u largua fshehurazi nga Shqipëria dhe shkoi në Itali së bashku me të plotfuqishmir e kryepeshkopatës katolike të Shkupit, Llukë Kabashin. Në relacionin që i drejtoi nga Roma po atë vit Kongregacionit, ai shkruante, ndër të tjera, se me qëllim që të ndihmonte mësuesorët të dilnin nga prapambetja, ai kishte përgatitur një tekst në gjuhën shqipe (përmbajtjen nuk e thotë), dorëshkrimin e të cilit e kishte marrë me vete²⁷. Thotë pastaj se kleri katolik i vendit të vet, meqenëse nuk dinte latinishten, gjuhën e liturgjisë së kishës perëndimore, kishte nevojë për libra *fetare* dhe *kishtare* në gjuhën shqipe sepse shumica e tyre, nënvizonte ai, nuk kuptonin as ato që thonin gjatë pagëzimit (*non intendono moltissimo di loro ne pur quel che dicono quando battezano*)²⁸. Librat që ishin shkruar shqip deri atëhere, theksonte më tej Pj. Bogdani, jo vetëm se ishin tepër të rrallë, por kishin edhe mjaft shtrembërime. Prandaj ai kishte përgatitur *drejtshkrimin e gjuhës shqipe*, të cilën mund ta shfrytëzonin me lehtësi edhe misionarët e huaj. Pjetër Bogdani thotë më tej se ishte gati të pranonte detyrën e korrektorit të këtyre veprave, në se Kongregacioni do ta zgjaste qendrimin e tij në Romë, sepse, siç vinte ai në dukje, në Romë kishte shumë pak njerës që dinin shqip²⁹. Propozimi i Pj. Bogdanit u shtrua për diskutim

26. J. Radonić, *po aty*, 389.

27. J. Radonić, *po aty*, 288.

28. J. Radonić, *po aty*, 293-294.

29. M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1932, f. 34. Librat *fetare* dhe *kishtare* në gjuhën shqipe dhe në

në mbledhjen e Kongregacionit, por kardinalët e lanë për ta shqyrtuar më vonë që do të thoshte se refuzonin botimin e tyre³⁰. Arsyeën e refuzimit duhet ta kërkojmë gjithënjë të mungesa e simpatisë së kardinalëve ndaj çështjes shqiptare, e cila diktohej nga politika sllavofile e Kongregacionit.

Qëndrimin e ftohtë ndaj çështjes shqiptare, Roma e tregoi edhe më vonë. Më 1675, Pjetër Bogdani i paraqiti Kongregacionit veprën e tij madhore të shkruar në gjuhën shqipe por me titull latinisht: *Flauisse prophetarum ad aduentu Messiae, epirotice congestae*, etj (*Shpella e profetëve rreth ardhjes së Mesisë*, etj),³¹ titull të cilin më vonë, kur e botoi veprën, e ndryshoi në *Cuneus prophetarum*, etj (*Çeta e profetëve*, etj).³² Në letrën që i drejtoi Kongregacionit më 25 qershor 1675, pasi kërkonte miratimin për botimin e veprës, ai ankohej për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë për rrezikun që i kanosej gjuhës shqipe nga presioni i turqishtes, greqishtes dhe serbishtes³³. Edhe këtë

mënyrë të veçantë punimi i tij mbi drejtshkrimin në gjuhën shqipe, të cilat, sikurse del nga letra e përmendur e Pj. Bogdanit, ishin të gatshme për botim në vitin 1665, nuk dihet ku përfunduan. Njëra prej tyre mund të jetë *Doktrina e krishterë (Dottrina christiana)* përgatitur ose përkthyer nga franceskani Bernardus a Quintiano, të cilën Pjetër Bogdani e botoi me shpenzimet e veta më 1675 në Venedik (pra jo në Romë). Shih: Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë 1965, f. 54.

30. J. Radonić, *po aty*, 293, 294, 296.

31. Titulli i plotë: *Flauissae Prophetarum de Aduentu Messiae epirotice congestae ubi de vita et ejus legitima potestate soli Petri tradita abunde consulitur*.

32. Titulli i plotë: *Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi, et eius evangelica veritate*, italice et epirotice contexta, et in duas partes diuisa. A Petro Bogdano, macedone, Sacrae Cong. De Prop. Fide Alumno. Philosophiae & Sacrae Theologiae Doctore, olim Episcopo Scodrensi & Administratore Antibarensi; nunc vero Archiepiscopo Scuporum, ac totius Regni Serviae administratore, Patavii 1685.

33. M. Roques, *po aty*, 35. Në letrën e vet, Pj. Bogdani shkruan ndër të tjera: «avertendo che l'Albania ha grandissima scarsezza, e quasi affatto priva di libri in propria lingua... ma anche trovandosi la nazione tra Turchi, Greci e Serviani di continuo la lingua va perdendosi, ha per tanto il vescovo (P. Bogdani — KF) stimato neces-

radhë, Kongregacioni nuk e refuzoi haptazi botimin e saj por i kërkoi Pjetër Bogdanit që veprën ta përkthente italisht dhe pastaj ta merrte në shqyrtim si cenzor kardinali De Albizzi duke ia lënë këtij në dorë lejen (*nulla osta-n*) për ta dërguar në shtyp.³⁴ Si rrjedhim, botimi i veprës shtyej vetvetiu për më tutje.

Pjetër Bogdani u kthye po atë vit në Shqipëri, ku e prisnin detyra të reja por edhe peripeti të tjera. Me këmbënguljen e ungjit të vet, Ndre Bogdanit, i cili ishte tepër i sëmurë, Pjetër Bogdani u largua nga Shkodra më 1677 dhe shkoi në Shkup si zëvendës i kryepeshkopit kurse dy vjet më vonë, më 1679 u emërua titullar i plotë i kryepeshkopatës, dhe në të njëjtën kohë administrator i kishës katolike të mbretërisë së Serbisë.³⁵ Por në të njëjtën kohë, Pjetër Bogdanin e ndoqën persekutimet e zakonshme të administratës perandorake osmane, të cilat e detyruan të kalonte herë pas here në arrati, brenda dhe jashtë Kosovës. Gjendja u keqësua më tepër pasi sulltani i shpalli luftë, më 1683, Austrisë, sidomos pasi ushtritë osmane, të cilat atë vit arritën në dyert e Vjenës, filluan nën goditjen e ushtrive austriake, të tërhiqeshin drejt Jugut. Edhe pse në kushte të vështira, Pjetër Bogdani gjeti kohë të merrej, sipas porosisë së Kongregacionit, me përkthimin italisht, të veprës së tij historike-filozofike. Më 1684, ai u largua përsëri nga Shqipëria dhe shkoi në Itali duke marrë me vete dorëshkrimin dygjuhësh të veprës me titullin e saj të ri *Cuneus prophetarum*. Por këtë radhë ai nuk shkoi në Romë, as trokiti në zyrat e Kongregacionit, ndoshta nga se parashihte që cenzori i tij, kardinali De Albizzi, nuk do ta priste me simpati veprën. Ai u vendos në Padovë, në territorin e Republikës së Venedit, te kardinali Gregor Barbadigu, i cili për arsye që nuk e dimë, u tregua tepër dashamirës ndaj Pjetër Bogdanit. Barbadigu, jo vetëm pranoi që vepra dygjuhëshe, shqip e italisht, të shtypej në shtypëshkronjën që ai administronte në Padovë, jashtë autoritetit të Kongregacionit, por përballoi financiarisht, në formë paradhënie, edhe shpenzimet e

sario anzi obbligo della sua carica di rimediare a si grandi inconvenienti con tentare al possibile... a scrivere nella lingua Albanese sua naturale», etj.

34. M. Roques, *po aty*, 35.

35. Pjetër Bogdani, edhe pse ishte shqiptar, në shkrimet e veta italisht e latinisht, përdorte, siç kërkohet nga një prelat erudit, emër-

botimit.³⁵ Kështu më në fund, pa dritën e botimit. vepra madhore e Pjetër Bogdanit, *Cuneus prophetarum*, e cila është në të njëjtën kohë, vepra madhore e letërsisë së vjetër shqipe.³⁷

*
* *

Rrethanat tepër të ndërlikuara që përjetoi për më tepër se tri dekada, të shkaktura nga arroganca e administratës perandorake osmane, nga agresiviteti i kishës ortodokse serbe dhe nga dogmatizmi burokratik i aparatit të Kongrega-

timet gjeografike që kishte përvetësuar administrata kishtare katolike, e cila, për sa u përket trojeve shqiptare respektonte ende emërtimet e trashëguara nga periudha paraosmane, konkretisht emërtimet e zyrtarizuara gjatë sundimit anzhuin (shek. XIII). Kështu për shembull, ai quante Arbëri (Albania) ashtu si dhe qarqet zyrtare përndimore, vetëm viset që kishin hyrë në *Mbretërinë e Arbërisë* (*Regnum Albaniae*), të krijuar nga Karli I Anzhu më 1272, kurse Kosovën, sado që banohej nga populli shqiptarë, vazhdonin ta përfshinin, ashtu si në shek. XIII, nën emërtimin Serbi (Servia), ndonse shteti serb, ashtu si dhe mbretëria e Arbërisë, kishin tre shekuj që ishin përmbysur. Ndërkohë, gjatë shek. XVII, disa qarqe politike evropiane filluan ta përfshinin Kosovën nën emërtimin Shqipëri. Kështu, në disa raste, argjipeshkvia katolike e Shkupit emërtohej *argjipeshkvia katolike e Serbisë* (Kosovës), kurse në raste të tjera cilësohej me emërtimin *argjipeshkvia katolike e Shqipërisë*. Ashtu si prelatët katolikë shqiptarë, edhe Pjetër Bogdani, nuk i jepte emërtimit gjeografik Serbi një përmbajtje etnike. Ai e dallonte Kosovën nga Serbia, sepse të parën e quante, sipas emërtimit historik *Serbi* kurse të dytën, Serbinë e mirëfilltë, e quante, si dhe qarqet zyrtare përndimore, Rashë. Madje, me emërtimin Serbi, Pjetër Bogdani nënkuptonte Kosovën shqiptare dhe jo sllave. Dëshmi është fakti se në parathënien e veprës *Cuneus prophetarum* shkruar në gjuhën amtare, gjuhën shqipe ai e quante *arbënisht*, por në variantin italisht ai e quante serbisht (*Cuneus prophetarum*, Të primitë përpara literarit). Veç kësaj, në botimin e parë të *Cuneus-it* (1685), Pjetër Bogdani shkruan në kopertinë se vepra është hartuar italisht dhe epirotisht (*italice et epirotice contexta*) në një kohë kur veten e quan «ma-

cionit, nuk e ligështuan Pjetër Bogdanin. Përkundrazi, ato e kalitën prirjen e tij të hershme për t'i shërbyer si një militant, madje si një udhëheqës, lëvizjes çlirimtare shqiptare. Vokacioni i tij patriotik nuk priste veçse një rast që të merrie vrull revolucionar. Fillimisht rastin e dha lufta që sulltani i shpalli më 1633 Perandorisë Austriake, pastaj disfata që pësuan po atë vit ushtritë osmane në dyert e Vjenës, më tej hyrja e Republikës së Venedikut, më 1684, në luftë kundër Turqisë, kurse beteja e vërtetë filloi në fund të viteve 80, gjatë përparimit të ushtrive austriake nëpër Ballkan, i cili arriti kulmin në kohën kur Pjetër Bogdani mbyllte sytë përgjithmonë.

qedon» (*macedone*) kurse ofiqin e vet emërton latinisht *Nunc vero archiepiscopo Scuporum ac totius Regni Serviae administratore*, pra argjipeshkv i Shkupit dhe administrator i gjithë *Mōretërisë së Serbisë*, mbretëri e cila prej kohësh nuk ekzistonte më. Në botimin e dytë të veprës (1691), kur Pj. Bogdani kishte vdekur, editori e ndryshoi terminologjinë: gjuhën shqipe nuk e quan as *lingua albanese*, as *lingua epirotica*, por *gjuhë sllave (in due copiose lingue, Italiana et Schiava)* kurse gjuhën e mirëfilltë serbo-kroate e quan, sikurse qarqet crudite perëndimore: *gjuhë ilirike*.

Afërsisht këtë emërtim përdorte edhe bashkatdhetari i tij, Gjergj Bardhi, peshkopi i Sapës dhe i Sardës. Në relacionin e vet të vitit 1642, ai e ndante Serbinë në dy pjesë: në Serbinë e Epërme (*Servia Superiore*), ku të gjithë banorët flisnin sllavisht, pra në Rashën mesjetare dhe në Serbinë e Poshtme (*Servia Inferiore*) ku flitej gjuha shqipe. Në Serbinë e Poshtme, ai fuste, midis të tjerave, Prizrenin, Prishtinën, Pejën, Trepçën, Novobërdën, Janjevën, Gjakovën, Kaçanikun, Kratovën, Shkupin, pra përfshinte krejt Kosovën dhe pjesën veriore të Maqedonisë (Arch. S. Congr., CV (1641-1642), vol. 21, fol. 53).

36. Shpenzimet e botimit prej më tepër se 600 dukatësh. Pjetër Bogdani ia shleu kardinalit G. Barbadigo, po atë vit, me të ardhurat që siguroi, nëpërmjet një tregtari venedikas, i cili i bleu të gjitha ksombëlat e veprës (Arch. S. Congregazione, SRCG, vol. 494, nr. 16; letër e Pj. Bogdanit dërguar nga Padova më 16 nëntor 1685 sekretarit të Kongregacionit).

37. Gjurmët e librave fetare dhe kishtare në gjuhën shqipe, për të cilat flet Pjetër Bogdani, në relacionin e vitit 1665 dhe në mënyrë të veçantë ato të tekstit të tij mbi *dreitskrimin e gjuhës shqipe*, të cilat ishin të gatshme për botim po atë vit, nuk janë ndeshur gjë-

Më 1683, kur filloi lufta, Pjetër Bogdani, kryepeshkopi i Shkupit, ishte në pragun e moshës 60 vjeçare. Gjatë dekadave që kishte lënë prapa shpine, ai kishte akumuluar një pasuri të madhe kulturore. Ashtu siç e kërkonte koha, njihite jo vetëm kulturën klasike latine por edhe letërsinë historiografike mesjetare, të cilat nuk i kishte përvetësuar si stoli, por i kishte përpunuar në shërbim të problemeve jetike që shtroheshin para atdheut të vet.³⁸ Nga ana tjetër, ndryshe nga kolegët e tij evropianë, ai kishte bërë një jetë prej patrioti vazhdimisht të persekutuar. Persekutimet, sidomos arratisjet e shpeshta e kishin afruar edhe më tepër me masat e thjeshta, gjithashtu të persekutuar.³⁹

kundi. Njëra prej tyre mund të jetë vepra me titull: *Dottrina christiana* përgatitur ose përkthyer nga franceskani Bernardus a Quintiano, të cilën Pj. Bogdani e botoi me shpenzimet e veta në Venedik (pra jo në Romë), më 1675 (M. Roques, *po aty*, 34. Dh. Shuteriqi, *po aty*, 54). Ka mundësi që ato të kenë humbur gjatë arrative të shpeshta të Pj. Bogdanit. Nga një frazë që përmban parathënia e *Cuneus-it*, del se gjatë arrative, ai merrte me vete bibliotekën personale, ose, të paktën, dorëshkrimet e vyera, sepse, sikurse e thotë me keqardhje, gjatë këtyre shtegtimeve të detyrueshme nga persekutimi i administratës osmane, atij i humbi (*hupi si krypa nd'ujët*, shkruan ai) dorëshkrimi i një gramatike latinisht-shqip, që kishte përgatitur ungji i tij, Ndre Bogdani.

38. Këtë e dëshmojnë haptas citatet nga veprat klasike (nga historitë e Tit Livit, shkrimet e Plinit, ekloget e Virgjilit, Metamorfozët e Ovidit), por edhe nga letërsia mesjetare (nga kronikat e Gjergj Kedrenit, Laonik Kalkokondilit, Mauro Orbinit, Pietro Luccarit), të cilat ai i shfrytëzon në interes të çështjes shqiptare. Këtë prirje, Pj. Bogdani, e thotë shkoqur në letrën që i drejtoi sekretarit të Propaganda Fide-s, më 16 nëntor 1685. Aty ai shkruan se në veprën e vet *Cuneus Prophetarum* ai dëshironte që sibilet profetike, t'i paraqiste të veshura me roba shqiptare (arbërore) dhe serbe (kosovare), me qëllim që t'ua ngrinte humorin njerëzve të thjeshtë dhe t'i ngushëllonte me tërë mundësitë që kishte (*par dare in humore povera gente e consolare al meglio che ho potuto*). Arch. S. Congr. SRCG, vol. 494, n. 96).

39. Në relacionin që i drejtoi më 24 mars 1684 duke folur për veten e vet, në veten e tretë, Pjetër Bogdani shkruante, ndër të tjera, se gjatë 30 vjetëve që kishte shërbyer si peshkop, kishte «krezmuar, predikuar dhe celebruar me solemnitet, me shumë djersë, dhe frikë,

Disfata që pësuan ushtritë osmane në dyert e Vjenës shkaktoi, ashtu siç ishte e natyrshme, entuziazëm në popullsitë liridashëse shqiptare. Pjetër Bogdani, mbloodhi në prillin e ardhshëm sinodin provincial për të kërkuar nga Roma beatifikimin e Ndre Bogdanit, i cili kishte paralajmëruar sapo filloi lufta, disfatën osmane në dyert e Vjenës, por që nuk arriti ta përjetonte mbasi kishte vdekur disa muaj para saj.⁴⁰ Megjithatë shpresat për një kthesë në historinë fatkeqe të Shqipërisë, u shtuan vitin e ardhshëm, kur Republika e Venedikut hyri në luftë krahas Austrisë dhe Polonisë, kundër Perandorisë Osmane. Po atë vit, më 1684, Pjetër Bogdani u largua nga Shkupi dhe pasi kaloi nëpër Shkodër, ndoshta edhe nëpër Kelmend, shkoi në Itali, duke marrë me vete, siç u tha, edhe dorëshkrimin e veprës së vet (*Cuneus prophetarum*). Në të vërtetë, qëllimi kryesor i udhëtimit nuk ishte botimi i veprës, por të shqyrtonte me qarqet drejtuese të Republikës së Venedikut dhe të Shtetit Papal, projektin për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha osmane. Programin e tij e njohim, në vija të përgjithshme nga relacioni që ai i drejtoi Kongregacionit më 24 mars 1684, në të cilin përshkruan gjendjen politike dhe ushtarake të «mbretërisë së Arbërisë» dhe të «mbretërisë së Serbisë» (Kosovës), duke treguar, siç nënvizon ai, mënyrën se si ato të çliroheshin nga skllavëria e sulltanit.⁴¹ Por duket se në këtë pikë, Pj. Bogdani nuk arriti ndonjë rezultat.

Më 1686, kur Pj. Bogdani u kthye në atdhe, në Malësinë e Madhe, sidomos në kështjellën e saj, Kelmendin, kishte shpërthyer, ashtu siç kishte paralajmëruar në relacio-

duke shpenzuar nga kamja e vet e varfër, përherë duke u veshur varfërisht, tri herë i martirizuar për vdekje, shumë herë i plaçkitur nga çdo gjë që kishte. Vizitat, më të shumta — thotë më tej, ai (Pjetër Bogdani — KF) i ka bërë duke ecur në këmbë, sepse turqit, nga cmira, nuk i lejonin as kalin dhe gjatë kohës që u tha të 30 vjetëve, i kanë marrë nëntë kuaj» (A. Theiner, II, 218). Vizitatori apostolik, Stefan Gaspari, tregon në relacionin e vet të vitit 1671, se Pjetër Bogdanin e kishin futur në burgun e sarajeve të pashajt të Shkodrës, por një natë, dy vëllezër shkodranë, Pepë Kastori dhe Nikollë Kastori e nxorrën fshehurazi nga burgu duke e shpëtuar nga rreziku që i rrinte mbi kokë (*Hylli i Dritës*, 1931, f. 160).

40. J. Radonić, 388.

41. A. Theiner, II, 221.

nin e vitit 1684, kryengritja e armatosur kundër zgjedhës osmane. Toka e Kosovës, duket se ziente nga vllaga e lëvizjes çlirimtare, sepse, sipas zërave që qarkullonin, autoritetet osmane, kishin vendosur të kryenin një gjenocid kundër banorëve katolikë. Këto zëra i mësojmë nga letra që Pjetër Bogdani i dërgoi Romës që nga Shkupi më 1 tetor 1686, në të cilën ai nënvizon, ndër të tjera, se jeta e tij, në atë situatë, ishte në rrezik të madh⁴². Më 1686, rreziku kaloi, por dy vjet më vonë, më 1688, situata u keqësua në mënyrë dramatike nga terrori i jashtëzakonshëm që shpërtheu në Rumeli e gjatë, Jegen Pasha bejlerbeu i saj dhe dhëndri i sulltanit të rrezuar, Mehmedi IV. Në letrën që i drejtoi Romës më 28 maj 1688, Pjetër Bogdani njofton se ai u detyrua të struket nëpër male, së bashku me popullsinë katolike të diocezes, duke lëvizur nga njëri vend në tjetrin, sepse ndiqeshin kudo nga repartet e tërbuara të Jegen Pashës.⁴³ Por edhe pasi u shtyp rebelimi i bejlerbeut, gjendja nuk u përmirësua. Madje në pranverën e vitit 1689, kur filloi përparimi i ushtrive austriake nëpër Ballkan, Pjetër Bogdani u arrestua në Prizren nga njerëzit e Mahmud Pashë Begollit të Pejës, dhe do të ishte vrarë prej tij si hakmarrje për asgjësimin e garnizonit turk të Novigradit nga ushtritë e krishtera, po të mos kishte paguar një mitë në flori.⁴⁴

Në këtë periudhë ndërlikimesh që shkaktuan vonesën e kryengritjes, Pjetër Bogdani përpunoi idenë e guximshme për të krijuar një institucion të lartë kishtar shqiptar, më të lartë se ai i kryepeshkopatës, që të ballafaqohej nga pozita të njëjta me Patrikanën e Pejës. Natyrisht nuk kërkonte një kishë shqiptare katolike autoqefale, por një Patriarkat të varur si dhe Patriarkati i Venedikut, nga Papati, veç me të drejtën e ligjëruar që të përfshinte në vartësinë e vet, tri kryepeshkopatat katolike shqiptare të asaj periudhe — kryepeshkopatat e Tivarit, Durrësit dhe Shkupit. Qendra e patriarkatit do të ishte në Kelmend.

42. Arch. S. Congr. SRC, Servia, vol. I, f. 109. Vuajtjet e Pj. Bogdanit i përmend edhe kryepeshkopi katolik i Tivarit, Andrea Zmajević, në letrën dërguar Kongregacionit më 15 shkurt 1687 (Arch. S. Congr. SRC, Servia, vol. I, f. 114. Shih J. Radonić, 401-402).

43. Arch. S. Congr SRC, Servia, vol. I, fol. 113.

44. Pj. Bogdani, letër drejtuar Romës më 15 maj 1689 (Arch. S. Congr. SRCG, vol. 504, n. 27).

Pjetër Bogdani nuk e zgjodhi rastësisht Kelmendin. Ai i njihnte kelmendasit sepse kishte jetuar në gjirin e tyre, kur ishte peshkop i Shkodrës sidomos gjatë kohës kur strehohej tek ata për t'u shpëtuar persekutimeve të administratës perandorake osmane. Kelmendi ishte një kështjellë natyrore me një popullsi monopolite nga tri pikëpamje: banorët e tij qenë të gjithë shqiptarë, të gjithë katolikë dhe të gjithë luftëtarë. «Janë popullit më trima të Shqipërisë» nënvizonte ai në relacionin e përmendur të vitit 1684. Gjatë gjysmës së parë të shek. XVII, në saje të kryengritjeve të tyre të furishme, këta luftëtarë trima e kishin kthyer Kelmendin në kështjellë të rezistencës shqiptare dhe ishin bërë të njohur në opinionin evropian, madje më të njohur se banorët e çdo krahine tjetër të Shqipërisë. Në kushtet e krijuara, gjatë gjysmës së dytë të shek. XVII kur shqiptarët ndodheshin nën presionin e dyfishtë, të islamizmit osman dhe të ortodoksisë serbe apo greke, Pjetër Bogdani mendonte që këtë kështjellë luftarake të rezistencës së armatosur antiturke, ta kthente edhe në kështjellë të rezistencës ideologjike anti-serbe dhe antiosmane.

Siç mund të kuptohet lehtë, Kongregacioni nuk e pranoi idenë e Pjetër Bogdanit për Patriarkatin Shqiptar të Kelmendit. Projekti u la mënjanë, por ideja mbeti, madje filloi të fitonte dalëngadalë të drejtën e qytetërisë. atë sa Pjetër Bogdani filloi të mbiquhej: *Patriku i Kelmendit* dhe *kryepeshkopi i Shkupit* ose anasjelltas.⁴⁵ Por me gjithë kujdesin e posaçëm që i kushtoi krijimit të kishës katolike të bashkuar shqiptare, Pjetër Bogdani nuk hoqi dorë nga

45. Kështu për shembull, autori austriak anonim i ditarit të përmendur të vitit 1689 me titull «Annotationes und reflexiones» e quan Pjetër Bogdanin herë *patriarku i Kelmendit* (*Patriarch von Clement* (f. 36. a), herë *kryepeshkop i Shqipërisë* (f. 40, a); historiani çek F. Wagner në veprën e vet «Historia Leopoldi Magni Caesaris augusti» II, Lib. XI, f. 124 e quan *Patriarcha Clementinorum* (J. Radonić, 402); historiani anglez R. Knolles, *The Turkish History*, vol. II, London 1701, f. 353, e cilëson *Kryepeshkopi i Shqipërisë dhe Patriarku i Kelmendit* (*the Archbishop of Albania and the Patriarch of Clementa*); historiani italian C. Contarini po ashtu e cilëson *patriark* (Istoria della guerra di Leopoldo, Primo Imperatore e de' Principii collegati contro il Turco dall'anno 1683, fino alla pace, Venezia 1710, f. 171), etj.

bindja që kishte formuar prej kohësh se tashmë, asnjë kryengritje çlirimtare nuk mund të zhvillohej në Shqipëri dhe ca më pak në Kosovë pa pjesëmarrjen e shqiptarëve myslimanë. Por krijimi i frontit të përbashkët të shqiptarëve të besimeve të ndryshme, nuk ishte punë e lehtë. Atë e vësh-tirësonte fakti se të dyja palët ndërluftuese, si Perandoria Osmane ashtu dhe armiqtë e saj (Austria, Polonia, Venediku), i kishin dhënë që në fillim luftës së tyre veshje fetare, si një luftë midis islamizmit dhe katolicizmit. Si kisha pë-rëndimore ashtu dhe kisha lindore, i shikonin shqiptarët myslimanë si armiq, madje ato as e pranonin mundësinë e tërheqjes së tyre në kryengritjen antiosmane. Vetëm në qarqet politike austriake filloi të dukej një e çarë në këtë çështje. Krahas aristokracisë feudale austriake, e përfaqë-suar në qarqet e larta ushtarake nga princi Karl i Hanoverit, duka Kristian i Holshtajnit, koloneli Shtrasser, të cilët e shikonin luftën si një rast për konsolidimin e katolicizmit në Ballkan dhe si rrjedhim, tregonin një mospërfillje të hapët ndaj popullsisë jo katolike të gadishullit, ishte kri-juar një rrymë e re me frymëzim pragmatik, e cila për interesat e luftës, e merrte në konsideratë faktorin popullor ballkanik (jo vetëm ortodoks por edhe mysliman). Përfaqë-suesit kryesorë ushtarakë të kësaj rryme ishin konti Lud-vig Baden, gjeneral J. Veterani dhe në mënyrë të veçantë, gjenerali Silvio Enea Pikolomini (Piccolomini).

Si njohës i mirë i vendit, Pjetër Bogdani e vazhdoi me këmbëngulje punën për tërheqjen e shqiptarëve myslimanë krahe për krahe me shqiptarët katolikë, në kryengritjen çlirimtare antiosmane që kishte projektuar vite më parë.⁴⁶ Në të njëjtën kohë ai e vazhdoi me po aq këmbëngulje punën për të krijuar një front të përbashkët kundër zgjedhës os-mane, edhe me qarqet kishtare serbe. të cilat, edhe pse e dëshironin çlirimin nga zgjedha e gjysmëhënës, nuk prano-nin kurrësesi të luftonin në një llogore me renegatët, siç i quanin ata banorët myslimanë të Ballkanit. Veç kësaj, qar-qet klerikale ortodokse serbe ashtu si dhe qarqet kishtare greke fanariote, nuk dëshironin që çlirimi t'u vinte me ndihmën e ushtrive katolike, të cilat sillnin me vete politi-

46. Simpatinë që gëzonte Pjetër Bogdani ndër shqiptarët myslimanë e dëshmon suksesti që ai pati më 1680, kur pajtoi brënda tri orëve fiset e Krasniqit dhe të Gashit të cilët ishin në konflikt për 24 vrasje (Arch. S. Congr. SRC; vol. I, fol. 58).

kën e Unia-s që ndiqte perandori austriak, Leopold. Për këtë arsye qarqet klerikale serbe, dëshironin që shpëtimi t'u vinte nga Rusia ortodokse.⁴⁷ Megjithatë, afrimin e dy kishave të krishtera, në Kosovë, e ndihmoi në mënyrë të pavyllnetshme vetë Porta e Lartë, e cila për të përballuar shpenzimet e mëdha të luftës shumëvjeçare, i ngarkoi me taksa të jashtëzakonshme, edhe shtetasit ortodoksë serbë. Meqënë se Patriku i Pejës, Arseni III Çernjeviç nuk i lehtësoi dot besnikët e vet nga barra e taksave të reja, zemërimi i fshatarëve serbë kundër sundimit të huaj, u rrit. U krijua kështu trualli për një veprim të përbashkët kundër Perandorisë Osmane të dy kishave të krishtera në Kosovë. Zhvillimin e kryengritjes çlirimtare në Kosovë, e shpejtoi edhe politika që ndoqi perandori Leopold, i cili emëroi si komandant kryesor të frontit në Ballkan kontin Ludwig Baden, kurse komandant të forcave që do të vepronin në Kosovë, gjeneralin Silvio Enea Pikolomini, që të dy përkrahës të lëvizjeve çlirimtare Ballkanike.

Historiani çek F. Wagner na njofton se patriarku i Kelmendit. Pjetër Bogdani kishte lidhur marrëveshje me gjeneral Pikolominin, në lidhje me pjesëmarrjen e shqiptarëve kryengritës krahas ushtrive austriake në luftë kundër Perandorisë Osmane.⁴⁵ Puna e do që kjo marrëveshje duhet të jetë lidhur, të paktën në formë preliminare, përpara se ushtritë austriake të shpërthenin ofensivën në drejtim të Kosovës dhe jo siç pohohet aty-këtu, në 6 nëntor 1689, kur Kosova tashmë ishte çliruar.⁴⁹ Sipas marrëveshjes, e cila mbase është stipuluar me shkrim në javën e parë të nëntorit, shqiptarët katolikë e myslimanë do të rrëmbenin armët kundër pushtetit osman, sapo ushtritë austriake do të hynin në Kosovë, pastaj do të inkuadroheshin në një for-

47. Gjatë vizitës që Pjetër Bogdani bëri më 1680 në kryepeshkopatën e Pejës, zëvendësi i patriarkut Maksim, i tha kryepeshkopit shqiptar se edhe katolikët duhej të tregonin respektin e duhur ndaj perandorit të Moskës. Pj. Bogdani iu përgjegj me një dozë ironie se mbreti i Moskovit (për prelatin shqiptar nuk ishte ende perandor) «nuk ishte ende shpëtimtari ynë për të cilin ia vllente të derdhej gjak» (*che il re di Moscovia non era nostro salvatore për il quale si doveva spanger sangue*), J. Radonić, 375.

48. J. Radonić, 402.

49. H. Gerbs, *Die Kaiserlichen in Albanien 1689*, në «Mitteilungen des K. K. Kriegs-Archiv», Wien, 1888, f. 148.

macion ushtarak të rregulltë që do të quhej «Milicia Shqiptare» (*Albanese Miliz*) me oficerë dhe nënoficerë gjithashtu shqiptarë. Gjenerali austriak u premtonte shqiptarëve, në emër të perandorit Leopold, çlirimin nga zgjedha osmane, uljen e taksave për popullsinë dhe ushtrimin e lirë të të gjitha feve⁵⁰. Sipas historianit F. Wagner, marrëveshjen Pj. Bogdani e nënshkroi me titullin Patriarku i Kelmendit dhe Kryepeshkopi i Shkupit.⁵¹

Frutet e punës politike të Pjetër Bogdanit për afrimin e shqiptarëve katolikë dhe myslimanë në luftë kundër zgjedhës shekullore osmane, u dukën sapo në tetor 1689 ushtritë e gjeneral Pikolominit hynë në Kosovë, të cilën kronisti anonim austriak e quan pa asnjë ngurrim *Shqipëri*.⁵² Kur aty nga mesi i tetorit, Pikolomini arriti në Prishtinë (*Prishtina* qytet në Shqipëri),⁵³ me të u bashkuan rreth 5.000 luftëtarë, të cilët kronisti austriak që shoqëronte ushtritë e perandorit, i cilëson «arnautë» domethënë shqiptarë myslimanë dhe jo «shqiptarë e serbë» siç pohojnë disa historianë jugosllavë.⁵⁴ Duke vazhduar marshimin drejt Jugut, kaloi nëpër Kacanik më 25 tetor dhe pa ndonjë vështirësi arriti në Shkup, të cilin e dogji më 27 tetor 1689, për shkak se qytetin e kishte molepsur murtaja. Në Shkup, Pikolomini e ndërpreu marshimin e mëtejshëm drejt Jugut, dhe u kthye përsëri në Kosovë, mbasi synimi i tij kryesor ishte të dilte nëpërmjet Prizrenit, Kukësit dhe Shkodrës në Adriatik për ta shkëputur Bosnjën dhe Hercegovinën nga trupi i Perandorisë Osmane.

Pasi arriti përsëri në Prishtinë, Pikolomini mori rrugën nga perëndimi, në drejtim të Shqipërisë. Në kohën kur 3.000 kryengritës të tjerë shqiptarë morën Pejë, ⁵⁵ folcat

50. J. Radonić, 402.

51. J. Radonić, 402.

52. Annotationes und reflexiones, etj., f. 36. a. Vetë perandori Leopold theksonte, kur ushtritë e tij hynë në Kosovë, se ato luftonin në Shqipëri (H. Gerba, *po aty*, 136.)

53. Annotationes und reflexiones, etj. f. 32. a.

54. A. Ivic, *Istoriya Srba u Vojvodini*, f. 271, sipas Sk. Rizaj *Kosova gjatë shek. XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë 1932, f. 509.

55. Sk. Rizaj, 511, i cili mbështetet te kronisti turk Silahdar Findikli Mehmed Aga (Silahdar Tarihi, 2 Cilt, f. 425-430), i cili ka marrë pjesë në këto luftime.

austriake arritën më 6 nëntor 1689, në Prizren, në «kryeqytetin e Shqipërisë», thotë kronisti anonim.⁵⁶ Pikërisht këtu në kryeqytetin e Shqipërisë ndodhi takimi i Pjetër Bogdanit me gjeneral Pikolominin. Sipas njoftimit që përmban letra e Gjon Bogdanit, nipi i Pjetrit, drejtuar Kongregacionit, u ngji i tij, kryepeshkopi i Shkupit dhe Patriarku i Kelmendit. e priti gjeneralin diku jashtë Prizrenit dhe hyri bashkë me të në qytet.⁵⁷ Takimin e tyre në Prizren e përmendin pothuajse të gjitha burimet e cituara deri tani, por njoftimet më të hollësishme na i jep kronisti austriak anonim. Sipas tij, Pjetër Bogdani e priti gjeneralin Pikolomini, duke patur me vete rreth 6.000 luftëtarë, të cilësuar prej tij «albansen» dhe «arnauten» domethënë shqiptarë katolikë dhe myslimanë. Në lidhje me këtë moment, kronisti shënon tekstualisht: «Më 6 nëntor (Pikolomini — KF) arriti, sikundër kam njoftuar tashmë në Prizren, në kryeqytetin e Shqipërisë ku u mirëprit prej kryepeshkopit të atij vendi dhe patriarkut të Kelmendit». Dhe më tej «Jashtë Prizrenit ndodheshin më tepër se 6.000 shqiptarë (*albanesen*), por edhe të tjerë që quheshin *arnautë*. Këta, gjatë parakalimit të gjermanëve zhrazën tri batara pushkësh, pastaj, sipas zakonit të tyre, duke u betuar i dhanë perandorit besën».⁵⁸

Në këtë klimë entuziazmi, u stipulua në letër, marrëveshja e përmendur midis Pjetër Bogdanit dhe gjeneral Pikolominit, tekstin e të cilit nuk e njohim por që nënshkrimi i tij vërtetohet nga një shënim që ndodhet në njërin prej protokoleve të Këshillit të Luftës të asaj kohe dhe që ruhet në Vjenë, në Arkivin Ushtarak (Kriegsarchiv, Wien, Hofkriegsrath. Indico Protocol, nr. 373. 1689. 622. 665).

Fakti është se numri i luftëtarëve shqiptarë katolikë e myslimanë, që rrëmbyen armët si aleatë të austriakëve kundër zgjedhës osmane, ishte shumë më i madh nga sa parashihej në Vjenë. Sipas njoftimeve zyrtare të Vjenës, krahas 3.000 ushtarëve austriakë që kishte nën urdhër gjeneral Pikolomini, tani qenë grumbulluar rreth 20.000 luftëtarë shqiptarë dhe serbë, por shumicën e përbënin pa dyshim shqiptarët e të dy besimeve.⁵⁹ Duket se prania e një

56. Annotationes und reflexiones, etj., f. 36. a.

57. Arch. S. Congr. SRCG, vol. 506, n. 13.

58. Annotationes und reflexiones, etj. f. 36. a.

59. J. Radonić, 402.

numri kaq të madh shqiptarësh, në radhët e forcave të armatosura, e shqetësoi gjeneral Pikolominin, ndoshta nga nami që ishte përhapur se ata nuk e duronin disiplinën e hekurt dhe nuk ia përtonin të ngrinin krye kur shikonin se shkelej dinjiteti i tyre. Për këtë arsye, shkruan kronisti i mirëinformuar austriak, gjenerali u këshillua me Pjetër Bogdanin, në se bënte mirë që u besonte luftëtarëve të një populli të «lëkundshëm», të cilët ishin nga pikëpamja numerike, tri herë më tepër se forcat gjermane të njëjsteve të tij. Por Patriarku i Kelmendit, thotë kronisti, jo vetëm se e siguroi për qëndrimin korrekt të shqiptarëve, por edhe e inkurajoi që ta vazhdoje luftën së bashku me ta për të korrur fitore të tjera.⁶⁰

Por pikërisht kur pas Kosovës do të fillonte çlirimi i Shqipërisë Veriore, gjeneral Pikolomini vdiq nga murtaja në Prizren, më 12 nëntor 1689, në duart e Pjetër Bogdanit, i cili si prelat i dha sakramentet e fundit. Me vdekjen e tij punët morën një drejtim tjetër. Në vendin e Pikolominit, perandori emëroi gjeneral Veteranin, por deri sa ky të vinte në Kosovë, drejtimin e veprimeve në front e mori Albert Kristian (Christian), duka i Holshteinit, një nga kundërshtarët më të rreptë të bashkëpunimit me forcat e armatosura shqiptare. Duka i Holshteinit nuk e respektoi marrëveshjen midis Pikolominit dhe Bogdanit. Në kundërshtim me të, ai e rëndoi popullsinë shqiptare të Kosovës me taksën dhe detyrimet të rënda. Dha urdhër që shqiptarët të dorëzonin armët dhe i ngarkoi me taksën e kontribucionit të luftës gjë që ishte, sipas shprehjes së kronistit anonim austriak, një akt i padurueshëm për shqiptarët. Puna arriti deri atje sa duka i Holshteinit dhe oficerët e tij, filluanin t'i fyenin, t'i përbuznin, madje edhe t'i rrihnin ushtarakët e «Miliçisë Shqiptare»⁶¹

Filloi kështu ftohja midis shqiptarëve dhe austriakëve, e cila shkaktoi tronditjen e aleancës, të cilën e përgatiti me aq pasion Pjetër Bogdani. Marrëdhëniet shqiptare-austriake u keqësuan, sidomos aty nga fillimi i muajit dhjetor. Duka i Holshteinit u nis nga Prizreni në Lumë më 2 dhjetor 1689, sipas planit që kishte hartuar Pikolomini, me qëllim që pasi të shpartallonte forcat e Mahmud Pashë Begollit, të

60. Annotations et reflexiones, etj., f. 36. a.

61. Annotations und reflexiones, etj, 37. a.

vazhdonte marshimin për të dalë në Shkodër dhe për t'u takuar me ushtritë venedikase. Forcat shqiptare të Mahmud Pashë Begollit, të përqendruara në Lumë, refuzuan të luftonin kundër austriakëve. Refuzimi i forcave të tij, e detyroi Mahmud Pashë Begollin, të tërhiqej së bashku me popullsinë e Lumës. Kështu, duka i Holshtejnit e gjeti Lumën pa lumjanë, prandaj dogji disa fshatra. Pikërisht në këto momente, kur popullsia shqiptare nuk po kuptonte përse po trajtohej kaq keq nga ushtritë austriake, vdiq nga murtaja në Prishtinë, më 6 dhjetor 1689, Pjetër Bogdani, kryepeshkopi i Shqipërisë dhe patriarku i Kelmendit.⁶²

Vdekja e Pjetër Bogdanit shkaktoi një pikëllim të madh në Shqipëri. Humbja e tij shkaktoi trishtim edhe jashtë vendit, në qarqet që ndiqnin me interes rrjedhën e lëvizjes çlirimtare në Ballkan. Kronisti anonim austriak mund të thuhet se e vajton vdekjen e udhëheqësit të shquar shqiptar. Ja ç'thotë: «Në mënyrë që çështjet tona të pësonin një goditje të rëndë, perëndia deshi që të vdiste kryepeshkopi i Shqipërisë, i cili i kishte vënë nën urdhërat e tij dhe i mbante në devocion ndaj madhërisë së tij perandorake të gjithë popujt e vet (domethënë të krishterët katolikë — KF) dhe pjesën më të madhe (nënvizojmë pjesën më të madhe — KF) të arnautëve». Pastaj kronisti e mbyll shënimin e vet se me vdekjen e Pjetër Bogdanit «iku për një kohë edhe fati ynë në tokë».⁶³

Me këtë shënim lakonik se «me vdekjen e Pjetër Bogdanit iku edhe fati ynë në tokë», kronisti do të thotë se me prishjen e aleancës shqiptare-austriake, të cilën e kishte farkëtuar kryepeshkopi i Shqipërisë dhe patriarku i Kelmendit, ushtritë austriake filluan të pësonin disfata të përditëshme. Duka i Holshtejnit e kuptoi vonë se me arrogancën e tij ushtarake dhe me mospërfilljen e të drejtave të shqiptarëve, kishte rrënuar punën shumëvjeçare të Pjetër Bogdanit. Kështu, ai ndroi qëndrim ndaj shqiptarëve dhe u kthye te platforma e Pikolominit. Por tashmë, thotë kronisti anonim, ishte vonë sepse «zemra e shqiptarëve ishte pezmatuar jashtëzakonisht nga kapadaillëku i oficerëve austriakë, të cilët duke i përbuzur ata, sollën shkatërrimin e tyre».⁶⁴ Nga 20 mijë luftëtarë shqiptarë (fjalët janë të kro-

62. Shih, për vdekjen e Pj. Bogdanit, shënimin nr. 3.

63. Annotations und reflexiones, etj, f. 40. a.

64. Po aty, f. 40. b.

nistit austriak) që kishte me vete Pikolomini në fillim të dhjetorit 1689, një muaj më vonë, në fillim të janarit 1690, dukës Holshtejn i kishin mbetur vetëm 3 mijë vetë». ⁶⁵

Pjetër Bogdani vdiq në momentin kulmor të veprimtarisë së tij politike në shërbim të atdheut të vet. Pavarësisht se programi i tij për çlirimin e Shqipërisë, sidomos të Koçovës nga zgjedha osmane nuk u realizua, dhe kjo jo për faj të forcave shqiptare, por të disfatës së armatave austriake, ai e ruajti vlerën e vet historike për të ardhmen. Aty u vunë bazat e bashkëpunimit luftarak midis shqiptarëve të feve të ndryshme në luftë për liri, të cilat shërbyen si gur themeltar për historinë e ardhshme të Shqipërisë. Ky ishte një kapital i madh politik dhe ideologjik që Pjetër Bogdani u la brezave të ardhshëm, kapital të cilin e përvehtësoi që në hapat e para Rilindja Kombëtare Shqiptare, aq sa mund të thuhet se Pjetër Bogdani është nga kjo pikëpamje, me tërë madhështinë e tij, një pararendës i hershëm i lëvizjes rilindëse shqiptare.

65. Po aty, f. 42. b. Gjenerali Veterani, komandanti i ri i frontit, i cili arriti në Kosovë në muajin janar 1690, u rikthye te politika e Pikolomit dhe u orvat të përtëriste traktatin e aleancës mbi platformën e Pjetër Bogdanit. Diçka ai bëri me bashkëpunëtorin e ngushtë të Bogdanit, Toma Raspasarin dhe nipin e Bogdanit, Gjon Bogdanin, por tashmë besimi ishte tronditur. Veç kësaj, kursi i ngjarjeve luftarake ndryshoi në favor të ushtrive osmane. Sipas njoftimit që përmban letra e nipit tjetër të Pjetrit, Gjergj Boganit drejtuar Kongregacionit, ushtritë osmane sapo hynë në Prishtinë nxorrën nga varri trupin e ungjit të tij dhe pasi i vunë mitrën në kokë e hodhën në sheshin qendror të qytetit (*il mio zio Pietro Bogdano... cavato dalla sepoltura e dato a pasto e cibo de' cani in mezzo la piazza di Prishtina con la mitra in testa*). Arch. S. Congr. SRCG, vol. 54, n. 2.

PJETËR BOGDANI ET LE MOUVEMENT ALBANAIS DE
LIBÉRATION AU XVII^e SIÈCLE.

L'activité politique de près de quarante ans de P. Bogdani prêtre catholique, et son rôle de dirigeant de l'insurrection de libération de 1689, n'ont pas attiré autant que le mérite, l'attention des hommes de science. Né en 1625, curé à Prizren en 1650, évêque de Shkodër en 1655, vicaire de l'archevêque de Shkup en 1677 et enfin archevêque en 1679, Bogdani fut contraint de s'engager à une lutte politique sur trois fronts: contre le joug séculaire islamique ottoman, contre l'agressivité de l'église orthodoxe serbe et contre la bureaucratie de l'église catholique de Rome.

Jusqu'à la moitié du XVII^e siècle, les porteurs des insurrections albanaises de libération étaient les populations chrétiennes du pays. Mais, à mesure que le processus de l'islamisation avançait l'élan des insurrections de libération diminuait. A l'époque on pensait qu'il ne pouvait être question d'insurrection antiothomane en Albanie sans la participation des populations islamisées. Mais, pour la Congrégation de la Propaganda Fide à Rome, tout Albanais musulman était qualifié de renégat, et l'église ne devait nullement s'en occuper. Mais, Bogdani violant les ordres de la Congrégation, continua d'entretenir des relations avec ses compatriotes de religion islamique.

D'autre part, grâce aux privilèges que la Sublime Porte avait accordés en 1557 à l'église orthodoxe serbe, le Patriarcat de Pejë était devenu très agressif à l'égard des Albanais catholiques exposés en même temps aux persécutions et aux arbitrarités des féodaux ottomans. Dans ces circonstances, les Albanais catholiques ne trouvaient pas d'autres issues que soit de se convertir à l'islam soit de tomber dans le sein de l'église orthodoxe serbe. Mais la conversion à l'orthodoxie serbe leur faisait perdre leur identité nationale.

Enfin, le Saint-Siège, très occupé à l'époque par l'action d'Unia sur l'église orthodoxe serbe menait une politique slavophile dans les Balkans. Dans le cadre de cette politique Rome nommait à la tête des diocèses catholiques de l'Albanie, des prélats serbes et bulgares, qui étaient aussi slavomanes que les prélats serbes de l'église orthodoxe.

Cette lutte obligea Bogdani de passer une bonne partie de sa vie dans l'illégalité, d'abandonner plusieurs fois le siège de son dio-

cèse et de s'enfuir dans les montagnes albanaises. Malgré ces conditions très difficiles, Bogdani trouva la possibilité de s'occuper de la littérature albanaise dont le but était d'aider les montagnards à sortir de leur retard et de souvegarder la langue albanaise du danger de l'assimilation turque, serbe et grecque.

Dans les années '80, au cour de la guerre de l'Empire Ottoman contre l'Autriche, la Pologne et Venise, P. Bogdani mit au point son idée audacieuse de fonder à Kelmendi, en Albanie du Nord, une haute institution religieuse catholique albanaise, un patriarcat dépendant, comme le Patriarcat de Venise, du pape, pour qu'elle fut mise sur un pied d'égalité avec le Patriarcat orthodoxe de Pejë. La Congrégation refusa le projet de Bogdani, mais, l'idée gagna le droit de citoyenneté et son auteur commença à être nommé *archevêque de Shkup et Patriarche de Kelmendi*. En même temps il poursuivit avec fermeté sa lutte pour l'engagement des Albanais musulmans à côté de ceux catholiques, à l'insurrection antiottomane de libération.

L'insurrection des Albanais de Kossovë, fut favorisée à la fin des années '80, par l'avance des armées autrichiennes sur les Balkans, Selon l'accord conclu entre P. Bogdani, patriarche de Kelmendi, et le général autrichien, S. E. Piccolomini, quand les armées de l'empereur Léopold entrèrent en octobre 1689 à Kossovë (que le chroniqueur allemand de l'époque nomme sans aucune hésitation *Albanie*) les Albanais, à peu près 20 mille hommes, catholiques et musulmans, empoignèrent les armes et s'unirent aux armées autrichiennes. Bogdani reçut Piccolomini le 6 novembre 1689 à Prizreni à «la capitale de l'Albanie» dit le chroniqueur allemand. Mais, six jours plus tard, le 12 novembre quand l'armée autrichienne de 8 mille soldats et la «Milice Albanaise» de 20 mille combattants s'apprétaient à libérer l'Albanie du Nord, Piccolomoni mourut de la peste à Prizreni. Avec sa mort, les affaires, prirent une autre direction. Le duc de Holstein, le nouveau chef allemand, ne respecta pas l'accord conclu entre Bogdani et Piccolomini. Les relations alban-autrichiennes s'altérèrent. Justement dans ces moments décisifs, quand la population albanaise ne comprenait pas pourquoi elle était mal traitée par les armées autrichiennes, P. Bogdani mourut, lui aussi de la peste, à Prishtina, le 6 décembre 1689.

Indépendamment du fait que le programme de Bogdani pour la libération de l'Albanie du joug ottoman ne fut pas réalisé et cela non pas par la faute des forces albanaises, il garda sa propre valeur historique pour l'avenir. Y furent mis les fondements de la collabora-

tion militantes des Albanais chrétiens et musulmans dans la lutte pour la liberté, qui servirent comme une pierre fondamentale dans l'histoire future de l'Albanie. On peut dire que Bogdani est de ce point de vue, un ancien précurseur du mouvement de la Renaissance Nationale Albanaise.

PJETËR BOGDANI — HUMANISTI YNË I SHQUAR

Në këtë 300-vjetor të vdekjes të Pjetër Bogdanit, kujtojmë e nderojmë teologun patriot, i cili diti të mos përfillë porosinë e kishës: «jepi Cezarit atë që i takon Cezarit» dhe në vend të saj të bëjë rregull të jetës thirrjen luftarake «eja kush asht trim» për të shpëtuar këtë «të vobek dhe të Arbërit» nga skllavëria faraonike.

Së bashku me patriotin në këtë 300 vjetor të vdekjes ne kujtojmë e nderojmë edhe eruditin e rallë, i cili me veprën e tij me të vërtet monumentale «Çeta e profetëve» e nxori kulturën tonë në hapësira të panjohura më parë prej saj. Legjendat biblike bashkëjetojnë në veprën e mendimtarit tonë me emrat dhe doktrinën e filozofëve më të dëgjuar të botës greko-romake, me shkencat dhe dituritë natyrore, me elemente të historisë e të gjeografisë, të pedagogjisë e të psikologjisë, të dhënë që të gjithë në gjuhën amtare shqipe në një stil letrar, të kërkuar me kujdes dhe me talent të veçantë.

Vlerat polivalente të veprës së Bogdanit kanë tërhe-

qur vëmendjen e studjuesve nga fusha të ndryshme të diturisë, më shumë të specialistëve të gjuhës shqipe e të letërsisë, më pak të atyre të filozofisë e psikologjisë, moralit e edukatës. Megjithë se pak të studjuara, idetë laike, politike-filozofike janë aq shumë të pranishme në veprën e bënë Bogdanin një humanist të vërtetë, një propagandues të plot ideve të përparuara filozofike dhe moralopolitike, ide që do të jenë edhe objekti i kumtesës sonë.

* * *
* *

Viti 1685 është një datë e shënuar për jetën e Pjetër Bogdanit dhe për atë të kulturës e të patriotizmit shqiptar. Viti i shënuar për Bogdanin sepse, më në fund, pas shumë e shumë përpjekjesh, mundimesh e «djerse të mëdha» shihet dritën e botimit vepra e tij e jetës «Çeta e profetëve»; plotësohej një dëshirë e tij e thellë e kthyer në një mall të vërtetë në «mallin e shtampës» për ta parë veprën e tij të botuar.

Vit i shënuar për kulturën e popullit, sepse me veprën e Bogdanit, kultura jonë merrte një vepër, e cila, nga vlera e gjuhës, nga bukuria e stilit, nga pasuria e përmbajtjes do të jetë vepra shqipe më e përkryer e shekujve 17-të e 18-të.

Nuk mund të lexohen pa emocion dhe pa admirim fjalët e ngrohta të dashurisë për atdhe dhe të kujdesit për popullin e tij me të cilët Bogdani e përcjell veprën e tij. Në parathënien veprën e tij ai e quan «një qirij nderurë ndarë, për të ndërruar atë të vobek dhëe të Arbënit».1) Koha tregoi se me vlerat që solli në kulturën kombëtare dhe në edukimin patriotik të popullit, vepra nuk ishte thjesht një qiri i dobët, por një flagë e madhe zjarri, që do të qëndronte e nderur për vite e dhjetëvjeçarë. Kjo flagë merrte një ndriçim akoma më të madh në kushtet e rënda të erozioneve dhe rrënimëve që po pësonte kultura e popullit tonë në kushtet e pushtimit osman.

«Çeta e profetëve» është kryesisht një traktat teologjik, një paraqitje e jetës së profetëve izraelitë, sipas Dhiatës së vjetër dhe asaj të Jezu Krishtit, sipas Dhiatës së re.

1) P. Bogdani, «Cuneus prophetarum» bot. 1685, f. 4.

Por po të mos kufizohemi në legjendat biblike, po të studiohen më me kujdes digresionet që ai bën shpesh prej tyre si dhe po të shihet në mënyrë kritike se çfarë fshihet prapa vetë legjendave do të dalë qartë se vepra e Bogdanit është plot vlera laike e patriotike që e bëjnë atë një monument të vërtetë të kulturës sonë të kaluar.

Pa u hyrë në pjesë plot autorëve që kanë shkruar për Bogdanin dhe veprën e tij, duke rënë bile në ndonjë përsëritje duhet vënë në dukje se në vlerat e para të veprës qëndron gjuha e bukur shqipe në të cilën ajo është shkruar. Me gati 400 faqe të shkruara në gjuhën amtare, Bogdani provonte se gjuha shqipe, me gjithë kushtet e vështira, është e gjallë, se ajo jeton e zhvillohet, se me përpjekjet e njerëzve shqiptarë të kulturës ajo mund të bëhet fare mirë një gjuhë kulture, arti e shkence.

Në lartësinë e gjuhës është edhe stili i veprës, shtjellimi i saj artistik. «Çeta e profetëve», është edhe një vepër letërsie. Në vjershat që ve në gojën e Sibilave, në ato që përkthehen nga autorët e lashtë ai është treguar një njohës i mirë i vargut dhe i rimës. Kurse në përshkrimin dhe tregimin e shumë ngjarjeve jetësore ai është ngritur në lartësitë e një mjeshtri të prozës. Janë plot forcë e bukuri fjalët me të cilat Bogdani në rastin e lindjes së Krishtit përshkruan gëzimin që i jep nënës lindja e një fëmije, lumturinë që ajo ndjen nga krijesa e re që ka sjellë në jetë. «Mbet e lumja virgjinë, shkruan Bogdani, aqia e gëzuem tu e pan birthinë kërthij ngrykë, ma të bukurin se Djelli, sa kurraj të kallzuem nuk ka. Ani tue pam kërthijsinë, tue drithtunë prej të flohtë të pamasë, tue pasun vun ndër dy bagëti, kthej tue marr n'grykë, e shtërngon, e puthën, e adhuron»¹⁾ Në këto ndjenja të ëmbla e njeh veten çdo nënë fëmije. Ato janë të afërta për seicilëndo prej tyre, athere kur i shkruante këto fjalë Bogdani, edhe sot e përgjithënjë.

Është e pamatur dhimbja dhe brenja e Marisë, therin zemrën e çdo nëne, dhe jo vetëm të nënës, por çdo zemër njerëzore, fjalët me të cilat ajo qan Krishtin, të birin e saj të vdekur. «O mjeshtri im, o zoti im, qysh të baj unë pa ty? Kush më përgëzon ma, posi ti më përgëzonjë? Si të ies unë gjallë tue pamë ty të vdekun? Sa ndryshe kje ajo ditë asojë të shkuemet? Dje tue fjetunë më mbanje kryet mbë prehën, sot po të mbaj unë të dekunë përpara syvet? Dje

1) P. Bogdani, «Cuneus prophetarum» 1685, pj. II, f. 20.

më banje shumë të mira, e sod po më shtie kaq t'idhunë ndër zemërë teme?»¹⁾

Në planin estetiko-letrar me vlerë të veçantë janë dhe përshkrimet fizike e morale që Bogdani u bën Marisë dhe Krishtit, si njerëz, si femër e mashkull, si grua e burrë. Me përshkrimin e Krishtit, Bogdani jep idealin e burrit — idealin fizik dhe shpirtëror. «Asht një njeri gjithsej i ungjinë e i papëlqyeshëm. Asht i naltë, ma jo pasuer, fort i hijshëm e i bukur atij që e soditën. Ka një faqe të tmerrshme,²⁾ të ndershme e të dashur, ka flokë të verdhë si mbë të kuq, porsia ar. Ka një ball të pëlqyem e fort të bukur, pa ndonjë lye³⁾ i zbukuruem me një faqe të bukurë e të ndezëtë. Goja e hundët s'kanë si bahenë ma të mira... Ka një të soditun më të madh e fortë të ndershme. Ka sytë e kulluem e të ndriçim po si dy yj. Asht i tmerrshëm kur kiar-ton. E kur mëson fort i butë e ngullëllues. Ndër soditunit e gëzuem, me një të madh njerëzija, kurrë nuk asht dukun të qeshën ma shumë herët me kjan. Ka gjithë gjymtyrët të njimen duna për shtat, duert e gjata e të drejta. Krahët fort të bukurë, flet pak e me një të madhe njerëzija e me masë të fjalëve...»⁴⁾ Kjo është nga prozat më të bukura të veprës dhe më të drejtë historianët tanë të letërsisë e kanë vënë veprën e Bogdanit në radhën e veprave letrare më të mira të shekujve 17-të e 18-të.

Vlerat e veprës i kapërcejnë ato të gjuhës e të stilit. Ato duken e shfaqen edhe në fusha të tjera të dijes. Së bashku me teologjinë Bogdani në faqe të tëra bën filozofi e histori, moral e politikë, kozmogoni e shkencë natyrore aq sa vepra nuk mund të quhet vepër thjesht fetare, por vepër fetare-humaniste.

Bogdani me mënyrën si e ka konceptuar dhe paraqitur materialin e veprës është një teolog i bindur, por jo dogmatik, një njeri që ka besim në fjalën e shënjtë, por jo në mënyrë të verbët. Kjo e bën që, në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme, ai të largohet më senjëherë nga fjala e shënjtë. Kështu në përputhje me teologjinë e krishtere ai shkruan se bota me të gjitha çka brenda, «të

1) P. Bogdani, «Cuneus prophetarum» 1685, pj. II, f. 125-126.

2) Të tmerrshme — të «rreptë».

3) Lye — njollë.

4) P. Bogdani, po aty, f. 36.

pame e të papame», është krijesë e zotit, që është «i madh pa masë», në hapësirë dhe i përjetshëm, «për jetë të jetësë», në kohë. Zoti është mjeshtër i hollë nga duart e të cilit kanë dalë të gjitha gjërat që ekzistojnë. Por pa pritur, në rrugën e tij të arsyetimit rreth botës dhe thelbit të saj, ai largohet deri diku nga fjala e shenjtë dhe kalon në një koncept panteist të botës, e zbrit perëndinë nga qielli në tokë dhe pohon se «Rezullimi ansht një libër i çelë, ndë të cilit gjithë letëra e gjithë vjersha,¹⁾ e pikë, e krena²⁾ thonë se asht hyji»³⁾. Një konceptim i tillë panteist, i kuptuar dhe i zbatuar në mënyrë konsekuente, të largon nga bibla dhe të drejton në botën reale, e bën ruzullimin dhe jo biblën librin që duhet të studjohet dhe nga i cili duhet të mësohet dhe me këtë i jep një nxitje diturisë dhe shkencës.

Bogdani është një mendje e pakënaqur, ai është gjithënjë në kërkim të argumentave për ato që shkruan. Këto argumenta i kërkon në etërit e kishës dhe në skolastikën mesjetare, te Augustini dhe Thoma Akurini dhe më shpesh në filozofinë e lashtë greko-romake, te Platoni, Aristoteli e të tjerë.

Filozofia e krishtere doli në dritë dhe u përpunua në luftë me filozofinë pagane greko-romake. Por me gjithë armiqësinë parimore ndaj saj, ajo nuk i humbi asnjëherë krejtësisht lidhjet me të. Porosia e Tertulianit se tani që kemi në dorë librin e shenjtë s'ka nevojë për libra të tjerë, nuk u zbatua asnjëherë plotësisht nga teologët e krishterë. Sa herë kanë dashur të argumentojnë «të vërtetat» e biblës, ata janë detyruar të kërkojnë edhe ndihmën e filozofëve të lashtë greko-romakë. Shembullin më të qartë në këtë drejtim e ka dhënë skolasti i dëgjuar i shekullit të 13-të Thoma Akuini, i cili u orvat të argumentonte dogmat e fesë së krishtere me ndihmën e filozofisë së Aristotelit, sigurisht jo të Aristotelit të vërtetë, por të një Aristotelit të përpunuar dhe të interpretuar në frymën e kishës, të një Aristotelit me tonzurë, siç thoshte Lenini. Rilindja e ngriti më lart autoritetin e filozofisë së lashtë greko-romake. Ndryshe nga skolastika, fjalën e filozofisë të lashtë, autoritetin e saj ajo e përdori për të dalë në rrugën e gjerë të studimit të natyrës dhe të lartësimit të njeriut dhe me këtë të krijonte

1) Vjersha — vargu

2) Krena — kapituj

3) P. Bogdani, «Cuneus Prophetarum», Pj. I, f. 1.

një kulturë të re humaniste. Traditës së skolastikës për të argumentuar dogma të fesë së krishtere me anën e filozofëve të lashtë greko-romakë dhe më tej akoma orientimit të Rilindjes evropiane i përmbahet edhe Bogdani.

Prirja e Bogdanit drejt filozofisë së lashtë duket që në parathënien e veprës. Në 4-5 faqet e saj Bogdani i komunikon lexuesit qëllimin e veprës, vështirësitë e saj e deri dhe vlerat e dobësitë e saj. Kështu plot modesti, si për t'u shfaqësuar se nuk ka sjellë ndonjë gjë të re në veprën e tij, se nuk ka bërë veçse ka përsëritur atë që kanë thënë të tjerët, Bogdani i drejtohet autoritetit të filozofëve e shkrimtarëve paganë të botës greko-romake. Në disa radhë ai për-mend emrat e filozofëve e shkrimtarëve të lashtë si Sokrati, Platoni, Aristoteli, Averroesi, Horaci, Ciceroni, Salusti etj. dhe vë në dukje se të gjithë këta janë mbështetur te njeri tjetri dhe kanë mësuar prej njeri tjetrit. «... Sokrati ndoq Platonë, Platoni Aristotelinë, Aristoteli Averrocsin, Celili merr prej Supplicit, Leti prej Varronit, Henni prej Horacit, Seneka prej Gellit, Tesali prej Galenit, Hermagon prej Ciceronit e Ciceroni vetë merr prej Salustit». Folja «ndoq» në tekstin e Bogdanit ka kuptimin «lindi», «solli në jetë». Nuk është vendi këtu që të tregohet se ç'mori e ç'nuk mori njeri filozof prej tjetrit, ç'i detyrohet secili parazardhësit të tij. Por ajo që vlen të theksohet është se Bogdani, me gjithë se etërit e kishës dhe skolastët e Mesjetës i ka mbi krye sipër, për të vërtetuar pohimin e tij se «nuk premtoj me nxjerrë me këtë fëdighë kafshë të re...», parapëlqen autoritetin e mendimtarëve e shkrimtarëve paganë të botës greko-romakë.

Autoritetit të mendimtarëve të lashtë Bogdani i është drejtuar jo vetëm në parathënien, lidhur me disa momente të krijimit të tij, por edhe për të argumentuar plot nga dogmat e fesë e për t'i bërë më bindëse shumë nga legjendat e biblës. Kështu për të argumentuar se ka një perëndi ai kujton konceptin shoqëror antidemokratik të Platonit, sipas të cilit «shumë princër janë një pengesë e madhe për qeverisjen e shoqërisë», e përforcon më tej me disa vargje të Homerit, ku pohohet e mbrohet po kjo ide:

«Rex unus, princeps unus
Qui publica tractet»

E përkthyer nga Bogdani:

«Po reg e nji Chiefalij!¹⁾
Nderon dhenë me godij».

Teza e Platonit dhe ajo e Homerit është e diskutueshme dhe e pathemeltë, por më e diskutueshëm dhe më e pathemeltë është orvatja e Bogdanit për ta kaluar atë nga shoqëria në Univers dhe për të ardhur në mënyrë krejt arbitrare në idenë e një perëndie.

Këtë rrugë ndjek ai edhe për të bërë më bindëse dogmën tjetër të fesë së krishtere rreth trinitetit të shenjtë. Në të mirë të kësaj dogme ai kujton edhe teorinë idealiste të numurave të Pythagorës, edhe një pohim të Aristotelit se «perëndisë i pëlqejn numuri tek», edhe nja dy vargje të Virgjilit.

Edhe pavdekësinë e përjetësinë e shpirtit, këtë dogmë tjetër themelore të fesë së krishtere, Bogdani e mbron dhe e argumenton duke u mbështetur në të lashtët por në këtë rast në polemikë me ta. Në këtë problem Bogdani nuk pajtohet me metampsikozën e Pythagorës dhe shkruan se shpirti me të vërtetë është i përjetshëm, por ai nuk mbetet në këtë tokë, as kalon nga një trup në tjetrin. «Shpirti asht i pamort e mundet me pasë, pasi asht thanë ose ndjesë ose pendesë e kurraj e vërtetë nuk asht se mbas kësaj jete ecën prej korpi ndë tjetër korp, pasi tha Pittagora»²⁾.

Nëpërmes librit të tij Bogdani bën punën e teologut, por dhe të filozofit dhe nëpërmjet të dyve së bashku edhe punën e patriotit. Gjatë gjithë tregimit të tij biblik Bogdani gjen rastin ose më mirë krijon rastin që të lartësojë shqiptarët dhe të ulë e të denigrojë pushtuesit osmanë. Sa herë e sjell fjalën për shqiptarët ai nuk ka për ta veçse fjalë të mira dhe vlerësime të larta ashtu siç nuk do të ketë për pushtuesit osmanë veçse fjalë nënvlerësimi e denigrimi. Kështu edhe në rastin e pavdekësisë së shpirtit ai flet me ironi për pushtuesit osmanë, të cilët besojnë njëllë si Pythagora në transferimin e shpirtave nga një njeri te tjetri. «Ndër këto ditë përblenë priftënitë një bullë (një grua) prej uret të shtrenjtë (të ngushtë) te vendi i Drinit t'i përgjigje-

1) Chiefalij — princ, ministër.

2) P. Bogdani, po aty, f. 44.

shin djajtë për gojet të saj se asht shpirti i Ali Marincit, ma i keqi turk thonse qi ka pasë gjithë dheu i Arbënit brenda»¹⁾

Në frymën e filozofisë së krishtere Bogdani ngre lart varfërinë dhe ul e nënvlerëson pasurinë, mbron njerëzit e thjeshtë që kënaqen me atë që kanë dhe dënon të pangopurit. Edhe për këtë ai u drejtohet filozofëve të lashtë, përmend shembuj nga jeta e filozofëve të lashtë grekë Sokratit dhe Diogjenit, përsërit fjalët e filozofit stoik romak, Seneka, i cili thoshte se «jo aj qi ka pak, por ai qi dëshëron shumë, asht i vobektë»²⁾. Në këtë çështje Bogdani pajtohet me Senekën dhe polemizon me Epikurin dhe Makiavelin, se këta nuk pranojnë shpërblimin e shpirtit pas varrit, se gjithë thelbin e jetës së njeriut e shohin në të ngrënë e në të pirë. «Hamë e pimë se qish ashtë nesër nuk e dimë». Si duket, edhe Bogdani nuk mundi të kapërxente armiqësinë që gjithë mesjeta e krishtere kishte për Epikurin, për materializmin dhe ateizmin e tij; as nuk mundi t'i shpëtonte paragjykitimit mesjetar se gjoja e gjithë filozofia e Epikurit reduktohet në thirrjen për të ngrënë, për të pirë e për të bërë qejf. Kurse filozofin italian të shekullit të 16-të, Makiavelin, ai pa të drejtë e ve në një plan me Epikurin e lashtë. Në të vërtetë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre filozofike ndryshojnë krejt nga njeri te tjetri. Të përbashkët kanë vetëm urrejtjen me të cilën i ka ndjekur kisha dhe Vatikani. Ndërsa Epikurin Vatikani nuk e duronte dot për materializmin dhe ateizmin e tij, Makiavelin nuk e duronte për mbrojtjen që i bënte pushtetit laik në dëm të pushtetit fetar të kishës e të Vatikanit.

Krahas autoritetit të filozofëve greko-romakë, për të argumentuar dogmat e tij, Bogdani i drejtohet edhe realitetit të kohës. ku gjen rastin të lartësojë shqiptarët dhe të ulë pushtuesit osmanë. Për të bërë më bindëse të mirën e varfërisë dhe të keqen e pasurisë Bogdani flet me admirim për malësorët që dijnë të durojnë urinë dhe etjen e në rast nevojë «me ngranë lëkurën e qarrit», ndryshe nga të pasurit që duan vetëm «majën e miellit». Krahasimi te Bogdani është në të mirë të malësorëve, të cilëve ajo «gjellë ma.

1) P. Bogdani, po aty, f. 44.

2) P. Bogdani, po aty, f. 43.

shije u ka se pashallarëve e sanxhakëve mishi i qingjave dhe viçave të njomë, pa ndiem kurraj të nginjun»,¹

Një gërshetim interesant është ai i skolastikës me filozofinë e lashtë lidhur me arsyen dhe vendin e rolin e saj në njohjen e botës. Një nga dualizmat që ka karakterizuar gjithë Mesjetën është edhe ai i besimit dhe arsyes, i vendit dhe i rolit të seicilit prej tyre në procesin e njohjes. Në fillimet e vet filozofia e krishtere nëpërmjet Tertulianit, njërit prej themeluesve të saj, absolutizonte rolin e besimit dhe me arrogancë hidhte poshtë arsyen. Me tezën e tij «të famëshme» «credo quia absurdum» («besoj, edhe pse është absurde») Tertuliani i hapte rrugë të gjerë pranimit të biblës dhe të dogmave e legjendave të saj dhe i mbyllte rrugën çdo lloj kërkimi dhe diturie. Skolastët e mëvonshëm, si bie fjala Thoma Akuini i shekullit të 13-të, filluan të pranonin rolin e arsyes por t'i jepnin asaj një vend të kufizuar dhe ta bënë të nënshtruar ndaj arsyes hyjnore, që mishërohej në biblën dhe në vendimet e Vatikanit.

Bogdani në dualizmin besim-arsye zë një pozitë të ndër-mjeme. Së bashku me Shën Augustinin ai i njuh një rol arsyes, por një rol të kufizuar, i cili mund dhe duhet të plotësohet me besimin sipas këtyre fjalëve: «intelligemus dum possumus, dum non possumus, credamus» («marrim vesh sa mundemi, qish mos mundemi, besojmë»). Po këtë kufizim të arsyes në të mirë të besimit Bogdani mundohet ta provojë me argumentin tjetër se intelekti njerëzor nuk është në gjendje të ngrihet deri te perëndia, prandaj për këtë ai duhet t'i bëjë thirrje besimit, fjalës së shenjtë: «po ku mos mundeni na me mbërijm, fjala e Hyjit të Qiellit, qi asht shprehur idetë shkruemit të shenjt të na forcojnë»²).

Në kërkim të argumenteve për të ngritur besimin mbi arsyen, Bogdani vjen në një tezë materialiste të teorisë së njohjes së Aristotelit. «Nihil est in intellectu, quod prius non fuerit in sensu».³) Kësaj teze Bogdani i jep një interpretim të tijin, në frymën e teologjisë. Sipas këtij interpretimi perëndia, duke qenë frymë e shenjtë e ligji më i lartë i botës nuk mund të kapet nga organet e shqisave, pra nuk

1) P. Bogdani, f. 44.

2) P. Bogdani, po aty, f. 6.

3) Fjali latine në përkthimin e Bogdanit; «Gjethëcisht bin nder mend tona, përzihetë ndëpër shqisat korpit».

mund të kapet as nga arsyeja njerëzore, sa kohë që kjo gjithë ushqimin e saj dhe të drejtën e ekzistencës e merr nga organet e shqisave. Në këtë rast njeriut i vjen në ndihmë ndriçimi i arsyes hyjnore, besimi, dëshmia e librit të shenjtë. Me këtë interpretim të lirë, arbitrar Bogdani vinte në konkluzionin, aq të kërkuar nga kisha se arsyeja hyjnore qëndron më lart se arsyeja njerëzore, se fjala e shenjtë nuk gabon e na jep të gjithë të vërtetën. Me gjithë këtë me arsyetimin e tij Bogdani nuk është në gjendje të provojë atë që kërkon të provojë — pafuqinë e arsyes njerëzore. Organet e shqisave dhe arsyeja nuk arrijnë të kapin përëndinë jo sepse ajo është ligji më i lartë i botës, por për arsye të tjera që ajo nuk ekziston, pra s'kanë ç'të kapin. Me një premisë të paqenë si kjo, edhe arsyetimi bëhet i paqenë dhe konkluzioni i tij pa vlerë.

Përsa i përket vetë Aristotelit, tezën e tij ai e kuptonte dhe e zbatonte drejt, në frymën e materializmit. Me anën e saj ai hidhte poshtë doktrinën idealiste të ideve të Platonit dhe e drejtonte studimin në të vetmin realitet që ekziston me të vërtetë, në realitetin që kapet me anën e organeve të shqisave. Duke mos qenë sensualist vulgar, Aristoteli e shtyn procesin e njohjes më tej, ngrihet nga të dhënat e shqisave të arsyeja, me anën e të cilës njeriu zbulon të përgjithshmen në sendet dhe arrin të vërtetën shkencore. Ndërsa Thoma Akuini e skolastë të tjerë me këtë tezë mbështesnin teologjinë, Aristoteli hidhte themelet e shkencës.

Teza sensualiste e Aristotelit se s'ka asgjë në intelekt që të mos ketë kaluar nëpërmjet organeve të shqisave në shekullin e 17-të kur botonte veprën Bogdani, po njihte një afirmim të mëtejshëm. Filozofi anglez i shekullit të 17-të Francis Bekoni e vuri në krye të filozofimit të tij dhe me këtë ai u bë krijuesi i filozofisë dhe i shkencave moderne. Po me këtë tezë disa vjet më vonë Xhon Loku, filozofi tjetër anglez, hodhi poshtë doktrinën idealiste të ideve të lindura së bashku me njeriun të Dekartit dhe e zhvilloi më tej materializmin. Dhe kultura jonë nëpërmjet veprës së Bogdanit po e bënte të vetën këtë tezë materialiste të Aristotelit, por po e përvetësonte duke kaluar nëpër rrugët e vështira të skolastikës e të teologjisë.

Në shërbim të teologjisë Bogdani mundohet të verë edhe një tezë tjetër materialiste të teorisë së njohjes. Në tregimin e tij biblik ai pohon se «Jesu Krishti është e vërteta dhe jeta, sepse i kallzon punët si janë në vete». Këtë

pohim ai e mbështet në tezën materialiste sipas të cilës «Veritas est conformatio intellectus cum obiecto, sicut est in se»¹). Po të lexohet dhe të kuptohet drejt, edhe kjo tezë provonte të kundërtën e asaj që kërkonte të provonte Bogdani dhe pikërisht se jeta dhe të vërtetat e Jesu Krishtit nuk ishin të vërteta sepse pikërisht nuk i kallzonin punët si janë në vetvete. Ato ishin thjesht legjenda e fantazi sepse bënin fjalë për gjëra të paqëna e të pandodhura siç ishte, bie fjala, ringjallja e të vdekurit, shndërrimi i ujit në verë etj., etj. Në qoftë se në fakt kjo tezë nuk i vlente Bogdanit për të provuar se Jesu Krishti është e vërteta, ajo i shërbente diturisë e shkencës sepse i tregonte objektin e saj të vërtetë që është realiteti objektiv dhe detyrën e saj të vetme që është të pasqyrojë këtë realitet me besnikëri, ashu siç është ai në vetvete. Duke u shkëputur nga legjendat e prrallat e fesë, duke ndjekur këtë rrugë të treguar nga filozofia materialiste dituria dhe shkencat kanë mundur të realizohen, të përparojnë e të pasurohen.

Një interes të veçantë tregon Bogdani për universin dhe bëhet autor i një kozmogonie të tërë të përzjerë edhe me një varg përfytyrimesh biblike. Në kozmogoninë e tij, ku është i pranishëm kori i engjëjve me të gjithë hierarkinë e tyre, Bogdani riprodhon skemën e përpunuar nga shkencëtari grek i shekullit të dytë pas erës sonë, Ptolemeut, e përvetësuar nga kisha dhe e shndërruar prej saj në dogmë të padiskutueshme: Toka është qendër e gjithësisë, Qielli është i mbyllur, i kufizuar në dhjetë sferat e tij, përtej të cilave është selia e Perëndisë, nga ku ajo qeveris botën ndënë Hënë e mbi Hënë!

Kur Bogdani shkruante këto radhë e bënte këtë pohim jo shkencor kishin kaluar mbi 100 vjet nga koha kur shkencëtari polak, Nikollë Koperniku, kishte formuluar dhe argumentuar sistemin e tij heliocentrik, antiskolastik dhe antiteologjik, kur Xhordano Bruno e kishte mbrojtur dhe e kishte thëlluar atë më tej dhe kur Galileo Galilei e kishte provuar në mënyrë të padiskutueshme me vëzhgimet e tij. Diskutimet rreth këtyre problemeve me siguri kishin ardhur edhe në dijeninë e Bogdanit, si njeri me një kulturë të gjerë bashkëkohore që ishte. Por në dijeninë e tij duhet

1) Fjali latine e përkthyer nga vetë Bogdani: «tue kjanë e vërteta një tenjimendunë të mendjes me atë kafshë qi kujton posi ansht në vetvete».

të ketë vajtur edhe kundërshtimi i kishës e ndjekjet që ajo u kishte bërë këtyre shkencëtarëve të guximshëm. Siç duket kundërshtimi i kishës tek ai kishte zenë vend më tepër se të vërtetat e shkencës. Në një farë kuptimi Bogdani i përmbahet traditës së Rilindjes që ishte më e ndjeshme ndaj autoritetit të autorëve të lashtë, me gjithë se ishin aq larg në kohë, se sa ndaj shkencëtarëve të ditës, megjithëse ishin aq afër në kohë, gati bashkëkohorë.

Megjithëkëtë teologjia nuk e kishte përpirë të gjithë Bogdanin dhe nuk ia kishte zënë plotësisht sytë për të mos parë fare të vërtetën shkencore. Kështu ai i shkon anës teologjisë, nuk përfill fare legjendën biblike dhe në kapitullin mbi Qiellin shpjegon në mënyrë shkencore me shkaqe natyrore dukuri të tilla qiellore si eklipsi i Djellit e i Hënës, Meteorët e Kometët, kurse në kapitullin mbi Dheun dukuri të tilla tokësore, si retë, mjergulla, shiu, bora, bubullima, vetëtima, era, tërmeti etj.

Edhe në këto raste Bogdani nuk bën përjashtim nga rregulli i tij patriotik dhe hyn në polemikë me besimet e gabuara dhe paragjykimet e pushtuesve osmanë. Këtë ai e bën jo vetëm për të vënë në vend të vërtetën, por edhe për të ulur pushtuesit osmanë, për t'i paraqitur ata si të paditur dhe plot me besime të kota. Kështu në rastin e tërmeteve, Bogdani ve në lojë Sanxhakbejnë e Shkodrës, i cili plot seriozitet pretendonte se Toka qëndron mbi brinjët e një bualli dhe se tërmeti ndodh kur bualli lëviz kryet, ose në rastin e eklipsit të Hënës pushtuesit osmanë pretendonin se ai ndodh nga që kulcedrat e dragonjtë e kanë përpirë Hënën! Prandaj, vëren Bogdani plot sarkazëm, për ta shpëtuar Hënën nga dragonjtë ata u bjenë dauulleve, tepsive. shtjenë me pushkë, a thua po rrëzohet e gjithë Turqia duke britur me zë të lartë drejt qiellit «lëshoie». Dhe koment i ironik i Bogdanit: «Kjo është sa renë aq edhe gaze përrallë»¹⁾

Këta elementë të shpjegimit shkencor të plot dukurive natyrore ruajnë vlerën e tyre si elementë që ndihmonin në kuptimin e drejtë të natyrës, kurse në kontekstin si i jep Bogdani, ato përbënin edhe një material të përshtatshëm dhe argument të fuqishëm për të vënë në lojë dhe për të diskredituar sanxhakbejtë dhe pushtuesit e tjerë osmanë. Me vërejtjet e tij shkencore natyrore, Bogdani sikur e paraandjente se kultura që do t'u duhej shqiptarëve për t'u

1) P. Bogdani, po aty, f. 30.

emancipuar dhe për të ecur në rrugën e përparimit duhet të ishte kultura laike, e mbështetur në shkencat e natyrës dhe e frymëzuar prej tyre.

Nga Qielli dhe Toka në tregimin e tij Bogdani kalon te njeriu. Bota e vogël e njeriut e tërhiqte atë aq shumë sa dhe bota e madhe e gjithësisë. Edhe ajo si kjo ishte njëlloj e pamatur, një lloj misterioze, njëlloj plot pikëpyetje si: ç'është jeta, ç'është vdekja? Nga ka dalë njeriu si ai ka ardhur në jetë dhe ku shkon, ç'bëhet pas vdekjes? Për të gjitha këto pyetje që plot ankth i shtron dhe i rishtron çdo gjeneratë njerëzish dhe çdo njeri në veçanti Bogdani ka përgjigjen e gatëshme. Ai e merr këtë nga bibla, nga libri i shenjtë. Legjenda e Adamit dhe e Evës është për të e mjaftueshme për të shpjeguar origjinën e njeriut, siç është e mjaftueshme ideja e shpirtit të njeriut si pjesë e shpirtit hyjnor, për të kuptuar se ç'është shpirti i njeriut dhe ç'bëhet ai pas vdekjes.

Bogdani në veprën e tij i pranon dhe i ritregon këto përgjigje të gatëshme, por nuk kufizohet në to. Mendja e tij e pangopur për dituri gërmon më tej, erudicioni i tij i gjerë shkon më larg dhe i plotëson përgjigjet biblike, duke dhënë dije të sakta mbi ndërgjegjen njerëzore e duke sjellë elemente të shkencës psikologjike në kulturën tonë. Në përbërjen e shpirtit (ndërgjegjes), në strukturën e tij ai dallon tri elementë kryesorë, të pamneduritë (kujtesa), të ndërgjuemitë (arsyeja), dhe volendetja (vullneti). Ai dallon dhe i ve në dukje vetëm këto tre elemente të ndërgjegjes për të provuar dogmën e kishës katolike mbi trinitetin e shenjtë, mbi perëndinë që është një në thelbin e saj, por që shfaqet në tre persona. Por pavarësisht nga qëllimi, ai dallon drejt elementet më të rëndësishme të ndërgjegjes nëpërmjet të cilëve ajo jeton dhe i lejon njeriut të orientohet në botë dhe pikërisht: kujtesa, arsyeja, vullneti. Gjithashtu ai dallon drejt edhe faktin tjetër se këta elementë të ndërgjegjes nuk lindin e veprojnë veçveç por janë të lidhur, bashkëveprojnë, përbëjnë një unitet të vetëm: «prej së pamendimit leen të ndërgjuemitë, e prej njanit e tjetrit rrjedh volendetja».

Në të tre elementët që dallon Bogdani është gati e gjithë ndërgjegja e njeriut. Ta njohësh atë do të thotë të njohësh se ç'janë këta elementë, të kuptosh se si lindin, si bashkëveprojnë ata. Kështu, tashmë dihet se kujtesa është ti-par dallues i ndërgjegjes njerëzore dhe përbën forcën e saj.

Në kujtesën e njeriut derdhet e gjithë bota e perceptimeve dhe e përvojave të tij, në kujtesë ajo ruhet dhe bëhet pronë gati e përhershme e njeriut. Të dhënat e perceptimeve, të ruajtura në kujtesë përpunohen më tej dhe bëhen bazë për lindjen dhe veprimtarinë e arsyes, me anën e së cilës njeriu zbulon të përgjithshmen e të domosdoshmen, futet në thelbin e sendeve dhe i kupton ato. Me të drejtë Bogdani kujtesën dhe arsyen i merr si të pandara dhe të dyja së bashku i bën bazë për vullnetin e njeriut, për veprimtarinë e tij të ndërgjegjshme. Ndryshe nga të gjithë kafshët, njeriu jeton dhe vepron në bazë qëllimesh të caktuara qysh më parë. Këto qëllime nxisin dhe ushqejnë vullnetin, i cili nga ana e tij vë në lëvizje njeriun dhe e shtyn të veprojë në njërën ose tjetrin drejtim. Kuptohet vetvetiu se vullneti do ta ndihmojë njeriun aq më shumë sa më mirë do të mbështetet ai në njohjen e drejtë të botës së jashtme, dmth në të dhënat e organeve të shqisave dhe në konkluzionet e arsyes, në të cilat pasqyrohet kjo botë, pikërisht ashtu siç e përfytyron gjendjen Bogdani — kujtesa lind arsyes dhe nga të dy së bashku rrjedh vullneti.

Në veprën e tij Bogdani shtron edhe një problem tjetër të rëndësishëm psiko-pedagogjik, problemin e inklinacionit natyror të ndërgjegjes, e informacionit gjenetik që është vendosur në të dhe të rolit të kulturës e të edukatës në ndryshimin e saj, rrjedhimisht në edukimin e saj. Për shpjegimin e inklinacionit natyror të ndërgjegjes së njeriut Bogdani i beson pa ndonjë entuziazëm të veçantë astrologjisë, e lidh karakterin e njeriut dhe tiparet e tij me veprimin e yjeve. Moshën e njeriut Bogdani e ndan në disa pjesë karakteristike dhe çdo pjesë me tiparet e saj e ven nën ndikimin e një planeti: deri në moshën 4 vjeçare që Bogdani e quan kështrinjtia, ndikon Hëna; nga 4 deri në 14 vjet, që ai e quan fëmëinjënia, ndikon Merkur; nga 14 deri 22 vjet, që ai e quan djelmënia me të cilën fillon dëshira për studimin e botës dhe formimin e personalitetit, ndikon Venera; nga 22 deri në 41, që është moshë në të cilën njeriu njih gjithë fuqinë e tij, ndikon Djelli; nga 41 deri në 56, që ai e quan burrënia dhe që është «koha kur njeriu asht ma i lidhur se kurrë» ndikon Marsi; nga 56 deri në 68 vjet, që ai e quan pleqnia dhe është koha kur «njeriu ka urti të mirë e jep këshilla të mira», ndikon Jupiteri; nga 68 deri në 98, që ai e quan pleqnia e mbetun, që është koha kur «njeriu... asht gjithë i mërzitshëm dhe i padurueshëm», ndikon Saturni.

Karakterizimi i moshave dhe i tipareve përkatëse të personalitetit të njeriut që bën Bogdani në vepër, janë të rëndësishme për çdo teori të edukatës. Ashtu siç është e rëndësishme edhe ideja e tij se në personalitetin e njeriut vepron një inklinacion i natyrshëm, por që nuk varet nga yjtë, siç shkruan ai, por nga faktorë të tjerë natyrorë që shkenca e sotme biopsikologjike i ka zbuluar dhe po i zbulon gjithënjë më thellë. Por ajo që duhet theksuar në arsyetimet psiko-pedagogjike të Bogdanit dhe që ua ngre vlerën atyre është ideja e tij se inklinacioni natyror me të vërtet ekziston, por ai nuk është fatal, ndaj tij njeriu nuk është i pafuqishëm. Përkundrazi, inklinacioni mund të ndryshojë, ai mund të formohet, siç shkruan Bogdani, nëpërmjet kulturës filozofike dhe nëpërmjet vullnetit të vetë njeriut, «të ndershmit» të tij. Këtë ide të rëndësishme të tij Bogdani e parashton dhe e argumenton nëpërmjet një anekdote të marrë nga Aristoteli. Sipas tij Filomenit, nxënësit të mjekut të famshëm të Greqisë së lashtë, Hippokratit, i sollën një portret të Hippokratit. Kur e pa Filomeni portretin tha se ai ishte ai i një «njeriu fort kurvar». Nxënësit ia komunikuan Hippokratit këtë thënjë të Filomenit, për të cilën ai dha këtë përgjigje, që po e japim si e ka shkruar Bogdani sepse tregon shumë mirë idenë e tij të rolit të edukatës në formimin e personalitetit të njeriut. «Përgjigj Hippokrati e u tha se fort mirë kish gjykuem Filomeni, se mirëfilli ashtu ansht natyra e tijna. Ma për të dashuritë të filozofisë dhe të ndershmërisë tha se ka dobitunë e vum mb'udhë dëshirat e këqia të zemërës së vet, e se ka ndjekur gjithëherë me zanë qish një kundër natyrës tijnaj.»¹⁾

Njohuritë mbi personalitetin e njeriut dhe ndërgjegjen e tij Bogdani i plotëson me ato që kanë të bëjnë me sjelljet e tij, me konceptet e tij mbi të mirën e të keqen, mbi lumturinë e fatkeqësinë, me një fjalë, me dituritë morale. Bogdani tregon një interes të veçantë për njohuritë morale jo vetëm sepse ato janë pjesë e rëndësishme e doktrinës së krishtere, por edhe sepse ai si patriot që ishte e ndjente se edukimi moral është një kusht i rëndësishëm për formimin e shqiptarëve si patriotë përballë pushtimit osman. Edhe në këtë problem të madh Bogdani nisat nga autoriteti i biblës e nga porositë e Mojsiut; i mbështet ato më tej në autoritetin

1) P. Bogdani, po aty, f.

e filozofëve të lashtë greko-romakë dhe më në fund mban edhe qëndrimet e tij të diktuara nga traditat e popullit tonë dhe nga kërkesat e gjendjes së tij nën pushtetin e osmanëve.

Në themel të mësimëve morale dhe si pikënisje të tyre Bogdani vë njeriun si një qenie e lirë përgjegjëse për ato që bën e që dëshiron. Në plot vende të veprës Bogdani shpall «lirinë e vullnetit» si karakteristikë themelore të njeriut, që e dallon nga kafshët. Në natyrë, shpjegon Bogdani, vepron domosdoshmëria, «gjithë vepronjë ndë mos do». Zjarri, shpjegon ai, nuk mund të mos djegë, djelli nuk mund të mos ndritë. Prej të gjithëve ndryshon vetëm njeriu që është qenie e ndërgjegjshme, që «ansht i lirë në veprat e vet, mundet me ban e mos me ban gjithë qish do». ¹⁾ Në polemikë me astrologët, që pretendojnë se yjtë ndikojnë mbi njerëzit, Bogdani ngul këmbë me forcë e pohon se ato «nuk kanë forcë mbi të liritë mendëse tanë, as kanë virtyt më nderuem volendetnë e njeriut». ²⁾

«Liria e vullnetit», të njeriut dhe paracaktimi kanë zenë një vend të rëndësishëm në arsyetimet e etërve të kishës dhe në veprimtarinë e klerit katolik. Shën Augustini i përmbahej idesë se njeriu është me të vërtetë i lirë në veprimet e tij, por në këtë vullnet njerëzor në mënyrë të domosdoshme vepron vullneti hyjnor. Pa hirin e zotit nuk ka liri vullneti. Bile zoti e ka paracaktuar se cilin do të marrë në parrajsë dhe cilin do ta lërë në skëterrë. Ndryshe nga Shën Augustin, Bogdani mbron lirinë e vullnetit të njeriut pa asnjë kusht, e bën atë përgjegjës të plotë për të gjithë veprat e tij. Bile, sipas Bogdanit, as perëndia nuk ka pushtet mbi njeriun. Po të ishte ndryshe, vazhdon ai, veprimi i njeriut do të ishte i domosdoshëm. i detyruar nga perëndia. dhe rrjedhimisht, nuk mund të bëhej fjalë për meritat apo mëkatet e njeriut. «As zoti kishte me gjykuem njerinë, përse për volendet të Tinëzat, e urdhënit tijnaj njeriu kish me veprue mirë o keq, e prashtu as kish me merituem Parajsinë, as me u gjykuem në Ferrë». ³⁾

Qëndrimi i Bogdanit ndaj lirisë së vullnetit ishte më i afërt me Rilindjen Evropiane se me kishën katolike. Rilindja me humanizmin e saj ishte për një njeri që të kishte

1) P. Bogdani, po aty, f. 41.

2) P. Bogdani, po aty, f. 27.

3) P. Bogdani, po aty, f. 28.

besim në forcat e veta, për një njeri që të ishte në gjendje të ndryshonte fatin e vet. Edhe gjendja e athershme e Shqipërisë nën pushtimin osman për një njeri të këtillë kishte nevojë, për një njeri që gjithshka nuk e pret nga qielli, por nga veprimi i vet, nga trimëria e vet. Kësaj kërkesë shoqërore Bogdani i përgjigjet duke hequr dorë nga doktrina shenaugustiane e paracaktimit dhe duke mbrojtur lirinë e vullnetit të njeriut, një liri të papënguar as nga perëndia. Por është e qartë se nuk mund të bëhet fjalë për liri vullneti në një vend ku sundon dhuna aq më pak nuk mund të ketë liri vullneti në një vend ku ndërgjegja e njeriut është e jetërsuar dhe i nënshtrohet një presioni të gjithanshëm ideologjik, siç ishte gjendja e Shqipërisë së athershme në kushtet e pushtimit osman. Liria e vullnetit dhe pushtimi osman ishin të papajtueshëm, njeri përjashtonte tjetrin. Prandaj të kërkonje lirinë e vullnetit ishte njëllloj si të kërkonje zhdukjen e pushtimit osman që e ndrydhte atë. Ndërsa në vendet e Evropës lartësimi i njeriut në emër të lirisë së vullnetit kishte përmbajtje anti-feudale. ishte një thirrje për të hequr qafe bujkrobërinë dhe zgjedhën e saj, në Shqipërinë e athershme, ai kishte përmbajtje kombëtare, ishte një thirrje për të hequr qafe zgjedhën osmane.

Sa kohë që liria e vullnetit duhet të zerë një vend aq të rëndësishëm në jetën dhe veprimtarinë e njeriut, sa kohë që ajo ka një rëndësi aq të madhe për figurën morale të tij, aq kohë Bogdani e quan të domosdoshme ta mbrojë atë edhe në luftë me «antagonisten» e fesë katolike siç ishte feja islame. Edhe në këtë rast ai me një gur kërkon të vrasë dy zogj, edhe të mbrojë dogmën e fesë së krishtere, edhe të ulë fenë islame dhe pushtuesit që janë të lidhur me të. Bogdani flet me ironi për fatalizmin karakteristik të fesë islame dhe ve në lojë njerin prej argumenteve të saj, siç është besimi në ndikimin e yjve në fatin e njerzve. «Të pafetë, vëren Bogdani, thonë se gjithë njeri lind me yllt të vet, i cili për forcë i prin me ban mirë a keq».1) Po këtë kritikë ai përsërit edhe lidhur me shpiegimin e gabuar të osmanët u bëjnë meteorëve që shkëputen natën nga qielli, duke lëshuar dritë. Turqit, vëren në këtë rast ai, mendojnë në mënyrë të gabuar se ylli që bie është shenjë se diku ka

1) P. Bogdani, po aty, f. 27.

vdekur një njeri, sepse njeriu siç lind me yllin e tij, ashtu edhe vdes.

Vepra e Bogdanit është plot me vlera laike. Në të ka plot arsytetime që s'kanë të bëjnë fare me teologjinë e krishtere. Disa prej vlerave laike ai i lidh me arsyetimet dhe qëndrimet teologjike, kurse disa të tjera i formulon dhe i shpall drejtpërdrejt, pa u bërë fort merak se sa ato lidhen me teologjinë. Veçse që të gjitha janë të frymëzuara nga dashuria për atdhe, nga aspirata e tij e thellë që Shqipëria të shpëtojë sa më parë nga pushtimi osman. Te Bogdani teologu është një me patriotin, teologjinë ai e ve në shërbim të patriotizmit dhe e bën mbështetje të tij.

Një nga këto vlera laike patriotike është poshterimi i pushtuesve, ulja e tyre në sytë e shqiptarëve, paraqitja e tyre si të egër e gjakatarë dhe burimi i të gjithë të këqijave për shqiptarët. Ai i poshtëron, së pari, nga pikëpamja e dogmës, si të pafe e të pabesë, siç u vu në dukje në plot raste gjatë analizës sonë. Ai i poshtëron, së dyti, duke i paraqitur si njerëz moralisht të rënë, që nuk mendojnë veçse si të rëmbejnë e të pasurohen dhe «janë zanë që të gjithë pas lakmive të kësaj jete e fëlliqësive»¹). Në poshtërimin moral të pushtuesve osmanë Bogdani është i palëkundur, nuk kursen asnjëri, as edhe vetë sulltanin e Turqisë, i cili siç thotë ai, bije në «nji madhështi fort e paudhë e lavd i parnesë»²). Ai i poshtëron, së treti, duke i paraqitur si tiranë të egër e gjakatarë, si armiqtë më të mëdhenj të shqipëtarëve, «të cilët kurraj nuk nginjen me na ban keq e me na pijn gjaknë tanë»³).

Vlera tjetër laike që ze një vend të rëndësishëm në veprën e Bogdanit dhe që i përgjigjet të njëjtës logjikë-logjikës së çlirimit kombëtar është lartësimi i shqiptarëve. Ai i ngre lart shqiptarët dhe i çmon për historinë e tyre të lashtë: Në njoftimet që jep rreth historisë së botës, sipas kalendarit biblik fillimet e Shqipërisë i shënon në vitin 2878 pas krijimit të botës nga zoti» zun fill regenia e Arbënit e rnoj ndier mbë Alessandërë, të birrë e Pirrit»⁴)

1) P. Bogdani, po aty, f. 7.

2) Parnesë — të kotë.

3) P. Bogdani, po aty, f. 59.

4) P. Bogdani, po aty, f. 180.

datë kjo që është shumë më parë se ajo që ai i ve themeli-
mit të Romës!

Në kalendarin e tij bibliko-historik Bogdani përmend edhe njerëzit e shquar të historisë së Shqipërisë siç ishte «Leka i madh» prej Petrele nd'Arbanë, që më 3623 zu fill monarkijnë e vet ndë Matiet»¹⁾ dhe Pirrua i Epirit më 3759 «kësi motti kje Pirri, mjeshtri i luftet, Regi i Arbënit poshtërë».²⁾ Do të kalojnë kohët e do të vijë shkencëtarët që do të zbulojnë origjinën e lashtë pellazgjike të shqipëtarëve, që do të përcaktojnë historikisht më saktë datat e mbretërimit të Pirros së Epirit dhe të Aleksandrit të Maqedonisë, por këta nuk mund t'ia ulin aspak vlerën përpjekjeve të Bogdanit për të vënë në dukje historinë e lashtë të Shqipërisë dhe njerëzit e saj të shquar. Vlera shkencore dhe patriotike e përpjekjeve për të zbuluar dhe vënë në dukje historinë e lashtë të popullit shqiptar dukej që kur botonte Bogdani veprën e tij, do të duket akoma më mirë e qartë në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Siç dihet një nga temat e preferuara të Rilindjes Kombëtare dhe në të njëjtën kohë një nga temat e luftës së saj ideologjike ka qenë tema e lashtësisë historike të popullit shqiptar dhe ajo e njerëzve të shquar të historisë së tij. Në këtë çështje Bogdani del një prekursor i Rilindjes Kombëtare dhe një patriot i vendit dhe i popullit të vet.

Popullit shqiptar Bogdani në veprën e tij i ka dhënë një vend nderi jo vetëm për historinë e tij të lashtë, por edhe për vlerat e tij moralo-patriotike. Nëpërmes tregimeve të tij për profetët dhe për jetën e Jesu Krishtit Bogdani, me rast dhe pa rast, në frymën e biblës dhe ndonjëherë kundër saj, flet e shkruan për shqiptarët, për vetitë dhe për zakonet e tyre. Si përfaqësues tipikë të shqiptarëve ai merr malsorët edhe sepse i njeh më nga afër si besimtarë të fesë katolike, edhe sepse janë patriotë e trima që e kanë treguar dhe tregojnë në çdo hap, në gjithë jetën e tyre, trimërinë përballë dhunës dhe brutalitetit të pushtuesve. Siç theksohet në «Historinë e popullit shqiptar» malsorët e Malsisë së Madhe vazhduan të ishin bartësit kryesorë të rezistencës shqiptare gjatë shekullit të 17-të. Si shembull të trimërisë së shqiptarëve ai jep në veprë luftën e kelmendasve kundër një pa-

1) Matie — Maqedoni.

2) P. Bogdani, po aty, f. 181.

shai turk, Vuca Pashës, më 1639. Në këtë vit, sipas tregimit të Bogdanit, u mbledhën 500 kelmendas e i dolën përpara Vuca Pashës që kishte ardhur për t'i nënshtruar me 12 mijë ushtarë. Kelmendasit e thyen ushtrinë prej 12 mijë vetash dhe vranë vetë pashanë osman. Shkakun e fitores në këtë luftë kaq të pabarabartë Bogdani me të drejtë e shihte në trimërinë e malësorëve dhe në faktin tjetër se ata luftonin për një çështje të drejtë, mblihdeshin në luftë vullnetarisht, vetëm me thirrjen «kush asht trimë», ndërsa ushtarët e Vuca Pashës bënë një luftë të padrejtë dhe ishin mbledhur me detyrim e me pará. Këtë ndryshim midis shqiptarëve dhe pushtuesve osmanë, këtë epërsi morale të të parëve mbi të dytët Bogdani e jep përmbledhur në këto radhë: «Kush mundetë me i ram mbah se ma i vobek një Vucia Pasha, i cili për të mbledhë një ushtërij 12 mijë vetësh nuk i mbastuem shum milionj aar, se kelmendasit tanë të cijtë me një zaan eja kush asht trim, mbledhunë affërë 500 vetë, vraanë Vucia Pashën, vjetin të Krishtit 1639».¹)

Për të vënë në dukje krenarinë e shqiptarëve, shpirtin e tyre të panënshtueshëm Bogdani nuk kufizohet vetëm me ngjarjen e kelmendasve më 1639, por i drejtohet gjithë historisë së tyre të gjatë. Ai përmend dëshminë e Herodianit, një historiani grek të fundit të shekullit të 2-të dhe gjysmës së parë të shekullit të 3-të pas erës sonë, i cili shkruante se «Perandori Augusti dëshironte fort me pasunë ndë ushtërinjt tinaj t'Arbëneshetë: përse thoj se pësonjënë shumë e nuk druenë për hua (uri) e për het(etje) se janë ma zemërorë se të tjerët».²) Dhe jo vetëm Cezar Augusti, por edhe Leka i madh, sipas Bogdanit, i ka çmuar shumë shqiptarët për trimërinë dhe qëndresën e tyre. Në bazë të këtyre shembujve të afërt e të largët Bogdani vjen në konkluzionin se malsorët kurrë nuk përuken, bile nuk përuken as para sanxhakëve e ministrave të «nji kaqi t'madhi mizuer, oi ban me djersunë gjithë shekullinë (botën)».³). Në këtë konkluzion duket se ku i punonte mendja Bogdanit: ai ngrinte lart trimërinë e shqiptarëve jo në emër të vetë trimërisë por në emër të luftës në të cilën duhet të ngriheshin shqiptarët kundër «të madhit mizuer» siç ishin pushtuesit osmanë.

1) P. Bogdani, po aty, pj. I, f. 43-44.

2) P. Bogdani, po aty, pj. II, f. 140.

3) P. Bogdani, po aty, pj. II, f. 60.

Po në këtë vijë arsyetimi të Bogdanit, janë edhe vargjet shqip të shkruar nga një kushëriri i tij, Lekë Bogdani, dhe botuar në hyrjen e veprës. Në këto vargje poeti i ri me entuziazëm flet për bukuritë e qyteteve të Shqipërisë, për Prizrenin, vendlindjen e Bogdanit, për Shkodrën, Lezhën, Zadrimën; me mall e krenari kujton djemtë, vajzat dhe gratë e këtyre qyteteve («tue kënduem... gjithë zemërat i shkrijn»), ve në dukje trimërinë e shqiptarëve, të cilët armët nuk i ndajnë nga vetja («gjithë nd'arme mbukuruem») dhe e quan atë tipar dallues të shqiptarëve, që nuk e gjen në vende të tjera («thue s'ka dhen tjetër») dhe që duket sheshit gjithandej («treg të rij ende të vjetër-trimnisë ka shetitun»). Shembujt e trimërisë e bëjnë për vete poetin. Ato ai i gjen në jetën e athershme të shqiptarëve, por i kërkoi dhe i gjen edhe në historinë e lashtë («Aleksandri i madh mundi Darin»), në historinë biblike («mbyti Gjuditi Holofernë»), në historinë kombëtare («Skanderbegu shitoj mberetnë».)¹⁾

Me motivet e bukurisë së Shqipërisë, të trimërisë së shqiptarëve, të veprave legjendare të Skënderbeut zgjerohet gama e problemeve laike që trajton Bogdani në veprën e tij dhe së bashku me këtë del më në pah patriotizmi i tij, qëllimi më i thellë i jetës dhe i veprës së tij.

Njeri i shquar i kulturës dhe patriot i madh Bogdani u bë edhe me gjuhën shqipe me të cilën e shkroi dhe e hartoi veprën. Bogdani me të drejtë në parathënien e veprës ankohet për vështirësitë që iu desht të kapër Xenie për të shkruar e për të botuar veprën e tij. Në këto vështirësi bën pjesë alfabeti me të cilin do të shkruhej vepra, alfabet i cili nuk ishte shumë i përpunuar dhe ekzistonte vetëm në disa vepra të pakta të Gjon Buzukut, Pjetër Budit, Frang Bardhit e të ndonjë tjetri. Në përpunimin e alfabetit ndihmesa e Bogdanit është e ndjeshme. Ai dha një alfabet më të thjeshtë e më të përpunuar se autorët e mëparshëm.

Por vështirësitë akoma më të mëdha ishin në fushën e gjuhës. Vepra e Bogdanit kishte një përmbajtje të pasur teologjike-filozofiko-shkencore natyrore, çka kërkonte një terminologji të tërë për t'u shprehur, terminologji, e cila për shkak të gjendjes së kulturës sonë të athershme gati nuk ekzistonte. Për këtë vështirësi ishte i ndërgjegjshëm Bogdani,

1) Mberetnë-sulltanin e Turqisë.

i cili në parathënien e veprës shkruante: «Tue kjenë vepërn fort e naltë, e hollë, ghiuha jonë chi me dijet dvuer ende fjalëtë, vështirë mundetë gjithë punëtë ndijerë ndë skajt me i shtjellë». Në pohimin e Bogdanit se gjuha bashkë me dijet humbi dhe fjalët ka një notë të theksuar patriotike. Me këtë ai u jepte zemër të gjithë atyre që do të shkruanin në të ardhmen në gjuhën shqipe, duke u vënë në dukje se gjuha shqipe edhe në të kaluarën ka qenë një gjuhë diturie dhe se, rrjedhimisht, edhe në ditët e sotme ajo mund të bëhet fare mirë një gjuhë e tillë.

Si i kapërxe vështirësitë Bogdani ose, siç thotë ai vetë, si «i nxorri punët ndë skajt»? Përgjigjen këtyre pyetjeve pjesërisht ua jep vetë Bogdani në parathënien e tij dhe plotësisht e jep vetë vepra. Një rrugë që do të ndiqte dhe që ishte ajo më e natyrshmja ishte ajo që fjalët dhe konceptet ti gjente në vetë gjuhën ose ti krijonte duke u mbështetur në karakteristikën fjalëformuese të vetë gjuhës. Në këtë drejtim Bogdani ka bërë një punë të madhe krijuese. Një pjesë të shumtë të fjalëve e të termave i ka gjetur në vetë gjuhën, por dhe plot prej tyre i ka krijuar vetë. Janë me qindra konceptet teologjike filozofike e shkencore natyrore që i ka gjetur dhe i ka futur, nëpërmjet veprës së tij, në qarkullimin kulturor.

Një rrugë të dytë, që ka ndjekur, krahas krijimit të fjalëve të reja, ka qenë ajo e riaktivizimit të shumë fjalëve të vjetra, duke i zbuluar dhe ringjallur fjalët e harruara dhe të fshira nga koha: «tue votë unë, siç shkruan ai në parathënie, mbas disa fjalësh plaks, të mos harrohej e të duarej ghiuha».

Një rrugë e tretë ka qenë ajo që për të gjetur fjalët dhe termat të mos kufizohesh vetëm në një dialekt, por të kërkonte ndihmën edhe të dialekteve të tjerë, t'i ngrinte fjalët lokale e krahinore në nivelin e përdorimit të përgjithshëm. «...tue kjanë unë...., siç shkruan ai vetë, prej diocezit të Prizrenit më ansht dashun me djersë të madh shumë fjalë me nderequnë ndë dhe të Shkodrësë.»

Më në fund, Bogdani nuk ka nënvleftësuar edhe një rrugë tjetër siç ishte ajo që të merrte hua nga gjuhët fqinjë, por kjo, siç thekson ai me të drejtë, vetëm në rastet më të nevojshme dhe në një sasi shumë të vogël: «... unë tue vum roe të gjumtët e ghiussë arbëneshe, e cilla për të pakëtë vet të marrë pjesë huan ghiuheshit Konfinjetare».

Sot, kur kemi në dorë veprën e Bogdanit dhe kur, për më tepër, dimë edhe rrugën e gjatë e plot pengesa e vështirësi që ndoqi shkrimi i gjuhës shqipe, mund të vërejmë se Bogdani i kapërxeu me sukses të gjitha pengesat e vështirësitë dhe dha një ndihmesë të veçantë edhe në shkrimin e gjuhës shqipe. Me veprën e tij ai u tregoi bashkëkohësve dhe pasardhësve një model të shkrimit të gjuhës shqipe, u hapi atyre rrugët më të përshtatshme të shkrimit e të pasurimit të saj.

Dy shekuj më vonë, kur filluan në plan të gjerë kombëtar përpjekjet për shkrimin e gjuhës shqipe, Naum Veqilharxhi, Jani Vreto, Sami Frashëri e vlerësuan shumë lart veprën e Pjetër Bogdanit dhe u mbështetën në përvojën e tij si për të krijuar alfabetin më të përshtatshëm të gjuhës shqipe ashtu dhe për ta shkruar atë, për ta bërë gjuhën shqipe gjuhë mësimi e diturije. Këtë meritë Sami Frashëri ia njej shprehimisht Pjetër Bogdanit, kur në një nga zërat e Enciklopedisë së tij të famshme kujton se gjuha shqipe është shkruar prej disa shekujsh më parë, se me këtë gjuhë është shkruar një literaturë e tërë kombëtare nga autorë myslimanë me gërma arabe, nga autorë ortodoksë me gërma greke, nga autorë katolikë me gërma latine.

Për ndjenjat patriotike që e kanë frymëzuar Bogdanin në hartimin e veprës së tij flasin edhe kërkesat e tij për përhapjen në Shqipëri të diturive në gjuhën shqipe. Në parathënien e veprës, Bogdani paraqitet si një propagandist i «dijes dhe urtësisë». Paditurinë ai e quan shkaku më të thellë të prapambetjes së shqiptarëve dhe të robërisë së tyre. «Prashtu dergjet dheu ndë robii errëtë, e vërbuem me dy palë mjegulla të zeza mbë faqe, qi janë mëkati i të padijtunitë, përse u dvuer dijeja e urtija e tue kjanë dheu i Arbënit ndë mjedistë të pafeevet...». Në këto fjalë është Bogdani patriot, të cilit i qan zemra pse populli i tij ndodhet në padituri e errësi, i verbuar me dy palë mjegulla në sy. Është Bogdani patriot edhe për arsyen tjetër se shkaku e paditurisë e të errësisë ai e sheh në pushtimin e huaj, në faktin se dheu i Arbënit ndodhet në mes të pafevet. Nga një konstatim i tillë i shpallur në vepër delte vetvetiu konkluzioni thellësisht patriotik: që të shpërndahet mjergulla dhe t'u hapen sytë njerëzve të dheut të Arbërit duhet të zhduket mjedisi mbytës, duhet të hiqet qafe sundimi i të pafevet. Në ndërgjegjen e Bogdanit si prift që ishte, si njeri i bindur në besimin e tij, përpjekjet për dije e urtësi ai i

bënte për t'i sjellë besimtarët nën hijen e Zotit. Por objektivisht ato ishin edhe përpjekje për çlirimin e Shqipërisë, sa kohë që përhapjen e lirë e të gjerë të mësimit e të diturive ai e shihte në zhdukjen e pushtimit të huaj. Në këtë çështje Bogdani nuk njihte asnjë lëkundje, asnjë lloj dyzimi. Teologu e patrioti ecnin në të njëjtën rrugë, ata ndiqnin të njëjtin synim sa kohë që armiku i besimit fetar ishte edhe armiku i kombit. Në këtë çështje, bile, Bogdani e kalonte masën, bëhej më intransigjent sa duhej. Armiqësinë ndaj pushtuesit që ishte e drejtë ai e shtrinte edhe ndaj fesë islame gjë që politikisht mund të sillte pasoja negative, sa kohë që besimtarë të fesë islame ishin jo vetëm pushtuesit osmanë, por edhe një pjesë e vëllezërve të tij shqiptarë. Këtë intransigjencë e ndreqën më vonë Rilindasit e shquar, të cilët në themel të luftës së tyre për bashkimin politik të shqiptarëve vunë tolerancën fetare dhe aspak lartësimin e njerit besim fetar mbi tjetrin.

Sensi i lartë patriotik i Bogdanit, intuita e tij patriotike duket edhe në kërkesën tjetër të tij, që dija dhe urtia të mësohet e të përhapet në gjuhën amtare shqipe. Diturinë dhe gjuhën shqipe Bogdani i merrte në lidhje të pazgjidhëshme, në bashkëveprimin e tyre të ndërsjelltë. Gjuhën shqipe ai e shihte si veglën më të mirë të diturisë për popullin shqiptar, kurse diturinë si mjetin më të mirë që gjuha shqipe të afirmohet dhe t'i shpëtojë rrezikut të humbjes që e kërcënon. Kur flet për qëllimin e veprës ai shkruan shprehimisht se qëllimi është që njeriu të marrë vesh «mbë ghiuhetë të vet» dhe, së bashku me këtë, të mos humbasin fjalët « të cilatë sa e zanë e po tretenë». Prandaj n'emër të këtij qëllimi të lartë, «që të mos lanë dijenë e ghiuhën e dheut me u duerunë», Bogdani kërkon që gjuha shqipe të mësohet mirë dhe të shkruhet bukur. «E madhe do bij e frujt, shkruan ai, është pra me nderekunë këtë shkallë t'urtisë e me të shkruem bukur. . .»

Kërkesa për dituri në gjuhën e dheut të vet ishte një bindje e thellë e Bogdanit. Ai ndalet gjatë në këtë temë dhe jep një varg argumentash në dobi të saj. Për t'i nxitur shqiptarët që të marrin rrugën e diturisë në gjuhën shqipe ai i drejtohet krenarisë së tyre kombëtare. Për këtë ai u kujton atyre se gjuha shqipe nuk ka qenë gjithënjë e varfër dhe e pashkruar. Përkundrazi, ajo ka qenë një gjuhë e lashtë diturie, që, për shkak të pushtuesve osmanë sëbashku me

dituritë, humbi dhe fjalët. Për të nxitur krenarinë e sedrën e shqiptarëve, ai u kujton edhe shembullin e popujve të tjerë. Ai i këshillon shqiptarët dhe u bën thirrje që të mos e lenë të humbasë dituria dhe gjuha e dheut të tyre, pasi kë-shtu veprojnë të gjithë popujt e tjerë, «lëfton gjithë dheu e shekulli për të vet», se në popujt e tjerë, «dulëzojnë doto-rëtë, leterarëtë e dijeja».

Më 1899 në veprën e tij «Shqipëria ç'ka qenë. . . . «Sami Frashëri shkruante këto fjalë për shkrimin e gjuhës shqipe dhe gjendjen e saj: «në ka mbetur gjuha shqipe pashkruarë, s'ka mbetur se është gjuhë e ligë e e metë, po vetëm se s'jemi kujdesur ne ta shkruajmë. S'na ka faj gjuha, faji është i yni». Argument dhe arsytim pak a shumë i njëlojtë me atë që jepte Bogdani 200 e ca vjet më parë, në parathënien e veprës: «Kush nuk e sheh si sillemi rreth shekullit, shkruan ai, tue votë mbë dyert e huaj, Querentes verbum, tye ly-punë dije, ende tue kthym me fort të liga tregëti andej për të paa zellt tanë». Me këto fjalë ai i këshillonte shqiptarët e mësuarë jashtë shtetit se këta duhet të mendojnë jo për interesat e tyre të vogla egoiste, jo për t'u pasuruar me tregëti, por për interesat e përgjithshme të popullit e të atdheut, për t'i dhënë popullit dritë e kulturë. Në vazhdim të këtij konstatimi Bogdani jepte këshillën tjetër se kulturën e di-turinë nuk duhet ta presim nga të tjerët, por nga vetë puna jonë, nga përpjekjet dhe zelli ynë.

Atë që e kërkonte nga të tjerët e provonte Bogdani vetë me veprën dhe punën e tij. Ai shkruante se për harti-min dhe botimin e veprës së tij ka punuar me një dëshirë të zjarrtë dhe me një zell të madh dhe është përpjekur ta bo-tojë sa më shpejt. «. . . ma unë, shkruan ai, tue pasunë mallë e shtampesë gjithë atyneve u ktheve faqenë veçsa u lu-tesha të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut timë të keshe një qirij ndezunë ndore për të ndritun atë të vobek dhë të Arbënit». Malli i shtampës për të cilën bën fjalë Bogdani nuk është dëshira e autorit për të parë sa më parë të botuar krijimin e tij, por entuziazmi i predika-torit për t'i dhënë sa më shpejt në dorë popullit një vepër që do ta ndriçonte dhe do ta edukonte. Për të treguar edhe njëherë modestinë e tij dhe për të mos krijuar ndonjë dy-shim se mos shkruan për nder dhe lavdi të vet Bogdani shkruan shprehimisht: «. . . përsa i përket frazës, dije, se unë shkruaj për njerëz të paditur dhe shkruaj për dobi të të shenjtës fe, jo për nder timin».

Pjetër Bogdani e ndjente se me veprën e tij bënte një punë të rëndësishme, prandaj ai kërkonte që ajo të delte sa më e mirë dhe sa më e përsosur. Ai ankohet plot modesti për cilësinë dhe vlerën e veprës së tij, kurse mungesat e dobësitë gjuhësore ai ia hedh faktit se ajo është botuar në dhë të huaj dhe është shtypur nga punëtorë që nuk e njihnin gjuhën shqipe. «Të lutemi pra letërarit em i urtë, i drejtohet ai plot modesti lexuesit e kritikut, të më ndejsh ndë gjeç fjalëzë, që të trazon veshetë. Përse as djelli pa hije, as hëna pa mjegullajë mbë faqe nuk anshtë. Po venë re se kush na ka pushtuem, e ndë të kujet dhe jemi ani më zemërë anko, possi tha Ovidi:

Si qua videbentur casu non dicta latine.

*In qua scribeham barbara terra fuit».*¹⁾

Modestia e Bogdanit në këto fjalë e qëndrime ka pjesën e saj, por ajo që ka më tepër rëndësi dhe që vlen të vihet në dukje është përgjegjësia e lartë që ai ndjente ndaj popullit dhe dheut të tij të Arbënit, dëshira e tij fisnike që vepra e tij të delte sa më e plotë dhe gjuha shqipe të shkruhej sa më drejt e bukur. E njëjta vërejtje mund të bëhet edhe për pohimin tjetër modest se është munduar shumë por nuk premtonte të ketë sjellë diçka të re. Në të vërtetë e gjithë vepra është e re në kuptimin më të mirë të këtij koncepti. Ajo shënoi një etapë në kulturën tonë kombëtare dhe u bë një model e frymëzim për zhvillimin e saj të mëtejshëm. Ajo shënoi një etapë të re në disa drejtime; në drejtimin e ideve patriotike që ka hedhur nëpër të gjithë veprën, të gërshetuara këto edhe me një material të pasur të marrë nga mendimtarët e kohëve të lashta dhe nga shkenca natyrore; në drejtimin e kompozicionit, vepra është plot me faqe të tëra të hartuara në një prozë të përsosur artistike dhe plot me vargje të shkruara në bazë të rregullave më rigorozë të krijimit poetik; në drejtimin e gjuhës shqipe — siç u theksua edhe më lart ajo është dokumenti më i rëndësishëm i gjuhës së shkruar shqipe për gati dy shekuj deri në Rilindjen kombëtare.

Vepra e Bogdanit për ne është e afërt dhe e shtrenjtë edhe për entuziazmin me të cilin ai e ka shkruar. Është kjo dëshirë e pakufi për ta përfunduar veprën e për ta parë

1) Në goftë se rastësisht sheh shprehje jo latine, arsyeja është se i kam shkruar në dhe të huaj.

atë të botuar që e ndihmoi të kapërxente gjithë ato pengesa të shumta e të vështira që i nxirrnin rrethanat e kohës — vështirësi të karakterit intelektual «m'u desht, siç pohon vetë, me djersë të mëdha me qitunë ndë dritë plot fjalë plaka...» vështirësi të karakterit politik — «Mu desht mue shumë herë me ngrehun e me shkrehun librarijnë¹⁾ teme, tue jam porositunë kjorevet²⁾, gozhduem arshevet, e lidhunë thasevet e vetë tue ikunë maleve»: vështirësi të karakterit botues — për vite vepra i mbeti në sirtar, sepse cenzura e Vatikanit nuk jepte lejën e botimit dhe e detyroi, për këtë, të bënte përkthimin e veprës në gjuhën italiane. Të gjitha këto rrethana të vështira, të cilat ai i kapërxeu një nga një me sukses, flasin për karakterin e fortë të Bogdanit, për vullnetin e tij të hekurt, të ushqyer e të kalitur nga dashuria e tij për Atdheun dhe popullin e robëruar. Ato e bënë veprën e Bogdanit një vepër jo të zakonshme, një vepër luftarake jo vetëm në planin teologjik, por dhe në atë laiko-atdhetar.

Bogdani me veprën dhe personalitetin e tij ze një vend të veçantë në panteonin e kulturës dhe të patriotizmit, shqiptar. Si të gjithë personalitetet më të shquara të kulturës sonë ai ishte njeri dhe i mendimit dhe i veprimit: kulturën e ka krijuar dhe e ka ngritur lart jo në emër të vetë kulturës, por në emër të çështjes së madhe të lirisë kombëtare dhe të emancipimit të popullit të vet. Si të gjithë personalitetet më të shquara të kulturës sonë ai dha pjesën e tij në shkrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, shpalli dhe argumentoi motivet e rëndësishme të ideologjisë së çlirimit kombëtar siç janë lashtësia e popullit shqiptar, lavdia e historisë së tij, trimëria dhe virtutet e larta morale që e karakterizojnë; tregoi një dashuri të pafshehur për Shqipërinë, «Dheun e Arbënve» dhe popullin e saj, «arbanasët», dhe një dëshirë të zjarrtë për ta parë Shqipërinë, si plot vende të tjera të Evropës, një vend të lirë, të përparuar e të begatë.

Bogdani është pjesëtar i krijimit dhe përpunimit të atij mesazhi filozofik, të asaj prozie të madhe që njerëzit e shquar të kulturës sonë duke filluar me Barletin e kanë ruajtur, e kanë rritur, e kanë transmetuar nga brezi në brez

1) Librarijnë — bibliotekën.

2) Kjorevet — rafteve.

për të arritur në thesarin e kulturës të Rilindjes Kombëtare, që populli ynë e çmon aq shumë dhe për të cilin ai është aq tepër krenar. Kjo është dhe arsyeja më e thellë, që Bogdani dhe vepra e tij do të mos harrohet asnjëherë, që ai do të nderohet për gjithnjë si një njeri i shquar i patriotizmit dhe i kulturës sonë kombëtare.

R é s u m é

PJETËR BOGDANI — NOTRE HUMANISTE EMINENT

En ce 300^{eme} anniversaire de la mort de Pjetër Bogdani, nous commémorons avec respect le souvenir du théologue patriote lequel ne s'est pas soucié du commandement de l'église «Rendez à César ce qui appartient à César» le substituant par l'appel «viens qui se sent courageux» pour sauver «ce pauvre pays de l'Arbër» de l'esclavage pharaonique.

Outre le patriote nous commémorons aussi avec respect en ce 300^{eme} anniversaire de la mort l'érudit exceptionnel, lequel grâce à son oeuvre monumentale «Cuneus prophetarum» a donné à notre culture des espaces inconnus jusqu'alors. Les légendes bibliques co-existent dans l'oeuvre du penseur parallèlement aux noms et aux doctrines des philosophes les plus réputés du monde gréco-latin, aux sciences naturelles, aux éléments de l'histoire et de la géographie de la pédagogie et de la psychologie, tous cela donné en langue albanaise dans un style littéraire recherché soigneusement et avec un talent particulier.

Bogdani de la manière dont il a conçu et présenté le matériel de son oeuvre, est un théologue convaincu, mais non dogmatique, un homme qui croit à la sainte parole, mais pas aveuglément. Il est toujours à la recherche des arguments pour tout ce qu'il écrit. Ces arguments il les cherche chez les pères de l'église et dans la scolastique moyenâgeuse de Saint-Augustin et de Saint-Thomas et plus souvent dans l'ancienne philosophie gréco-romaine, de Platon, d'Aristote, etc.,

29) Librarijnë = bibliotekën.

30) Kjorevet = rafteve.

Ainsi, tout au long de sa narration biblique Bogdani introduit des noms de philosophes et d'écrivains anciens gréco-latins, rappelle les idées émanant de leurs oeuvres, des événements se rapportant à leur vie. Et parallèlement à cela, il n'oublie jamais son peuple albanais, son histoire, la réalité de sa vie. Chaque fois qu'il parle des Albanais, et il le fait assez souvent, Bogdani n'a que de bonnes paroles et de hautes appréciations à leur égard alors qu'aux occupants ottomans il réserve des mots durs et des attitudes critiques. De la façon dont Bogdani présente le matériel, il fait le travail du théologien et du philosophe à la fois et par là aussi le travail du patriote.

Un intérêt particulier présentent les idées et les concepts de Bogdani sur l'Univers, élaborés dans toute une cosmogonie. Bogdani dans sa cosmogonie reproduit la scène du savant grec du 2^{ème} siècle de notre ère, Ptolémé, assimilée par l'église et transformée par elle en dogme irréfutable. Cependant la théologie ne lui avait pas entièrement obscurci la vue pour l'empêcher de discerner la vérité scientifique. Ainsi, dans le chapitre sur le Ciel il explique de manière scientifique par des causes naturelles des phénomènes célestes tels que l'éclipse du Soleil et de la lune, les météores et les comètes, tandis que dans le chapitre sur la Terre il analyse des phénomènes terrestres tels que les nuages, le brouillard, la pluie, la neige, le tonnerre, l'éclair, le tremblement de terre etc.

Bogdani a porté haut le drapeau d'une nouvelle culture dans son essence humaniste aussi bien quant à la haute appréciation de l'autorité du penseur et de l'écrivain ancien gréco-romain, que par la propagation de maintes valeurs laïques qui répondaient directement aux exigences de la société albanaise de l'époque. Ainsi, il interrompt à plusieurs reprises la narration biblique et parle de l'ancienne origine des Albanais en tant que descendants du «Grand Alexandre» et de «Pyrros de l'Épire».

Outre l'origine des Albanais, Bogdani met en relief leur belle vertu, le courage. Il estime particulièrement les montagnards albanais pour leur fierté et leur esprit indomptable.

Des idées humanistes et illuministes, ainsi que des sentiments patriotiques qui ont inspiré Bogdani dans son oeuvre témoignent également ses exigences relativement à la diffusion en Albanie des connaissances en albanais.

Bogdani par son oeuvre et sa personnalité occupe une place à part dans le patrimoine de notre culture. Il a apporté sa contribution à la conception de ce message philosophique et historique que les hommes célèbres de notre culture, à partir de Barleti au XV^{ème} siècle et au

début du XVI^{ème} siècle, l'ont conservé et enrichi de génération en génération pour le faire parvenir au trésor de la culture de notre Renaissance Nationale. C'est la raison pour laquelle que Bogdani et son oeuvre ne seront jamais oublié et il sera honoré toujours comme une figure éminente de la cause nationale et de notre culture.

MAHIR DOMI

PJETËR BOGDANI DHE LETËRSIA E VJETËR SHQIPE

Në veprimtarinë aq të gjerë e të ndryshme të Pjetër Bogdanit si klerik i lartë e si dijetar, si letrar me shumë kulturë e mendimtar erudit, si patriot plot dashuri për gjuhën shqipe e për popullin shqiptar dhe si luftëtar i zjarrtë për zhvillimin kulturor e për çlirimin e tij nga zgjedha turke, zë një vend kryesor vepra «Çeta e profetëve» që botoi ai në Padova në vitin 1685.

Pjetër Bogdani bëri studime të rregullta në Itali, ku kreu edhe arsimin e lartë e mori titullin doktor i filozofisë dhe i teologjisë. Qe peshkop i Shkodrës për 21 vjet (1656-1677), duke qenë i ngarkuar njëkohësisht me administrimin e kryepeshkopatës së Tivarit, dhe 12 vjetët e fundit të jetës së tij si kryepeshkop i Shkupit. Ai jetoi e punoi në një periudhë shumë të rëndë të historisë së popullit tonë, kur u rëndua edhe më shumë zgjedha otomane, por u shtua edhe qëndresa ndaj saj, kur projektohen ose shpërthejnë lëvizje popullore të gjera për ta shkundur këtë robëri. Në këtë kohë një zhvillim mund të themi jo të papërfillshëm mori edhe

shkrimi i gjuhës amtare në Shqipërinë Veriore, që gjeti snprehje sidomos në formimin e një letërsie fetare e didaskauke në këtë gjuhë, për të ruajtur fenë e të parëve kundër foscë së imponuar nga pushtuesi, për t'i dhënë popullit libra në gjuhën e tij, për ta përpunuar e zhvilluar këtë gjuhë e për të mos e lenë atë të prishet e të humbasë, duke u bashkuar ndjenja fetare dhe ndjenja kombëtare, duke vijuar një traditë më të vjetër.

Duke nisur nga vepra e parë e botuar që na ka arritur, «Meshari» i Gjon Buzukut (1555), autorët e kësaj letërsie i lidhin në themel të njëjtat shkaqe e synime, që me kohë vijjnë duke u qartësuar më shumë, duke u zhvilluar më tej. Buzuku në pasthënien e librit të tij thotë se e shkroi atë nga dashuria që kishte për bashkatdhetarët e tij, «në dashnunitë së botësë sanë», si thotë ai, dhe nga dëshira për të ndritur pak mendjet e tyre. Pjetër Budi (1566-1623), që shtjelloi një veprimtari të dendur letrare, fetare, politike, përktheu në shqip një sërë veprash fetare, nga të cilat arriti të botojë vetëm katër. Me mëse 100 iaqet prozë origjinale që shkroi dhe me 3200 vargjet poezi, ai e çoi përpara letërsinë shqipe dhe gjuhën letrare shqipe, dha disa aspekte e probleme të shoqërisë shqiptare të kohës, realizoi edhe vargje me vlera artistike. Budit i copëtohet zemra kur shen gjendjen e vështirë të popullit shqiptar të shtypur, që dergjet në mjerim e padije, braktisjen gjithnjë e më shume të iesa së krishterë, dëmin që ka gjuha shqipe nga moslévrimi i saj me shkrim, u bën thirrje klerikëve të mësuar të përkthejnë shqip libra fetarë e të hartojnë edhe të tjera shkrime. Ai thotë se: «...i madh ka qënë gjithëherë kujdesi, dëshiri i zemërsë sime për ndihmë të Patriesë e giuhusë sonë, që u vduor ende po vdaretë ma të shumënë veçësë për letërë e për të mpsuom». Frano Bardhi (1606-1645) përktheu ndonjë libër fetar, shkroi latinisht me kompetencë e erudicion një vepër historike polemike për të mbrojtur prejardhjen shqiptare të Skënderbeut, po ashtu një fjalor latinisht-shqip. Edhe ai në parathënien e kësaj vepre të fundit flet për qëllimin e tij që me këtë fjalor t'i vijë në ndihmë «giuhës sanë qi po bdaretë e po bastardhohetë».

Kësaj letërsie i përket edhe vepra e Bogdanit, po me synime më të mëdha e më të qarta, me realizime më të rëndësishme, me vlera më të shumta, që shënojnë hapa të rinj përpara, një fazë më të lartë zhvillimi. Me të s'kemi një përkthim a përshtatje, as një shkrim me lëndë të zakonshme

të shërbimit e të mësimit fetar, si në botimet paraardhëse, po një vepër kryesisht origjinale, e para vepër origjinale e letërsisë shqipe, një traktatë teologjike-filozofike, me elemente të shumta enciklopedike, shkencore e letrare.

Me kulturën e tij atë të gjerë, enciklopedike, me mendimet e tij përparimtare, iluministe dhe atdhetare, me aftësitë e tij të shumta, me punën e tij të gjatë këmbëngulëse tri-dhjetëvjeçare, Bogdani i dha letërsisë shqipe, popullit shqiptar, një vepër madhore, që kurorëzoi traditën e mëbarshme letrare e kulturore, rrymën mendore të mësipërme, që theksoi nevojën e domosdoshme të dalies së popullit shqiptar nga padija, të zhvillimit të kulturës së tij kombëtare dhe të gjuhës së tij amtare, duke paralajmëruar periudhën e mëpasme të zgjimit të përgjithshëm kombëtar. Rilindjen.

Edhe Bogdani e shqetëson më shumë se çdo tjetër gjendja e rëndë e shtypjes, e mjerimit dhe e padijes, në të cilën dërgjet populli shqiptar. Ai reagon me forcë kundër gjendies dhe kërkon të nuanohet me ndihmë për ndryshimin e saj, para së gjithash për ndryshimin e mendies së bashkatdhetarëve të tij. Këto ai s'mungon t'i shprehë qartë mëse nëherë. Diçka Bogdani e shikonte si mjet të domosdoshëm për zhvillimin e vendit e përelimin e tij. Këtë mendim dhe mendimin e përkrahueshëm të Bogdani se një popull mund të marrë kulturën e nevojshme vetëm në gjuhën amtare, do ta gjejmë më vonë të thënë pak a shumë në të njëjtën mënyrë tek ideologu i parë i Rilindjes sonë Kombëtare, Naum Veqilharxhi. Bogdani e vështron paditurinë si një nga arsyet kryesore të të këqijave që kanë rënë mbi popullin shqiptar; me diçka lidh ai edhe lirinë e një populli, edhe praktikën fetare: «Prashtu dërgjetë dheu ndë rahi errëtë... përse u dyer diçka e urtia... E shofëmë përditë se ndatë dhó ku lulëzojnë dotorëtë, letëratë e diçka, lulëzon shejtëia fo me gjithë vepëratë miras». Atij i çan zemra, kur sheh se «gjuhë jonë me diçka dyer edhe fjalëtë dhe se zëllami rreth shekullit tue votë ndë dvertë hui quarentes verbum te detinë me lypunë diçka...». Prandaj, mendon ai, i duhen dhë-

1) Edhe Naum Veqilharxhi në qarkoren drejtuar bashkatdhetarëve më 1836, plagë të madhe të popullit shqiptar quaj paditurinë. Ky do të shpëtojë vetëm duke marrë kulturë. Po kulturën një popull mund ta marrë vetëm me anë të gjuhës së vet. Prandaj detyra jonë e parë, thotë N. Veqilharxhi, është që të shkruajmë gjuhën amtare të lënë pas dore dhe të përhanim arsimin shqip.

në popullit libra në gjuhën amtare, duhet lëvruar e përpunuar gjuha jonë për t'u bërë një mjet i fuqishëm kulture. «E madhe dobi e fryjt anshtë pra me ndrequnë këtë shkallë të urtisë e me të shkruem bukurë me shqyrëtuem e me dijtunë se si i duhetë nierit temelitunë me e përciellë... me fryjtit shpirtit vet ende të popullit, të mos lanë dijen e giuhën e dheut me u dvarunë, posi lëfton gjithë dheu e shekulli për të vet».

Kështu edhe në periudhat më të errëta të historisë sonë, si në shekujt e parë të pushtimit turk, dijetarët e shkrimtarët shqiptarë kanë menduar e punuar për zhvillimin e kulturës kombëtare shqiptare, të gjuhës e të letërsisë shqipe. Shoku Ramiz Alia, në fjalimin e tij në 100-vjetorin e Mësonjëtores së parë shqipe në Korçë, theksoi se «Lufta për gjuhën e shkollën shqipe, që populli ynë e ka zhvilluar në shekuj, përfaqëson një nga faqet më të ndritura të historisë sonë kombëtare. Ajo ka qenë pjesë e përpjekjeve vigane për të ruajtur e afirmuar identitetin kombëtar, për të shporrur pushtimet e huaja dhe për të përballuar synimet e tyre asimiluese».

Bogdanit iu desh një punë e madhe për të hartuar librin e tij dhe një luftë këmbëngulëse për ta botuar atë. Më 1685 ai i shkruante Vatikanit për t'i treguar nevojën e librave fetarë në gjuhën shqipe dhe për t'i kërkuar ndihmë për botimin e veprës së vet. Po iu desh të kapërcejë shumë pengesa për t'ia arrirë qëllimit, siç e tregon vetë. Mbas «kie mbaruem vepëra e nkryem gjithë arbënisht m'urdhënoj S. Kuvent qi ende italianisht ta nkthenjë». Edhe ai e kreu këtë kërkesë. Megjithatë libri s'u botua nga Vatikani, po me shpenzimet e një kardinali, i njohur i Bogdanit dhe mik i tij.

Vepra kishte 400 f., duke qenë e ndarë në dy pjesë të përfshira në dy vëllime. S'ishte një vepër e shërbimit fetar. as e mësimi fetar. siç qenë veprat e paraardhësve të Bogdanit. po një vepër teologjike-filozofike me elemente të shumta enciklopedike, e përshkuar nga një dashuri e madhe për popullin shqiptar e gjuhën shqipe, nga dëshira për të ndihmuar efektivisht në ngritjen kulturore të bashkatdhetarëve, nga urrejtja për sunduesin otoman. Është botuar në

2) *Fjala e shokut Ramiz Alia në Korçë me rastin e 100-vjetorit të Mësonjëtores së parë shqipe*, «Studime filologjike», 1, 1987, f. 3.

dy shtylla, në çdo faqe italisht dhe shqip. Mban edhe titullin «Cuneus prophetarum».

Pjesa e parë është një trajtesë e problemeve teologjike e filozofike të doktrinës së krishterë, ku vendin e parë e zë krijimi i rruzullimit sipas Biblës. Pjesën e dytë e përbën një shkrim tregimtar, kryesisht jetëshkrimi i Krishtit. Këto dy pjesë janë të lidhura midis tyre, sado të karakterit të ndryshëm, njëra dituror, tjetra letrar. Sidomos pjesa e parë është e pasur me çështje e probleme të ndryshme ontologjike, gnoseologjike, diturore etj. Në bazë qëndron kryesisht filozofia mesjetare e krishterë, po me elemente edhe të rrymave mendore të mëpasme, të humanizmit e të racionalizmit. Si konstaton një studiues i Bogdanit, I. Rugova³, është një filozofim i pasur dhe i thelluar me argumente për krijimin në kuptimin më të gjerë, për qenien, për natyrën, për njeriun, për jetën dhe përvojën njerëzore. Tezat e doktrinës së krishterë autori nuk i paraqit si dogma të imponuara pa tjetër, vetëm nga besimi, po përpiqet të arsyetojë, të tregojë vërtetësinë e tyre, duke u orvatur të pajtojë fenë me të dhënat e diturive. Gjen shprehje aty një aftësi e veçantë për trajtimin e problemeve nga më të vështirat, një logjikë e fortë; dalin aty njohuritë aq të gjera të tia në fushat më të ndryshme të dijes, përpjekja e suksesshme për ta bërë të qartë, të kapshëm e të kuptueshëm trajtimin e një problematike abstrakte e të vështirë, siç qe kjo, nga një masë sa më e madhe lexuesish nëpërmjet shtjellimit të një mendimi sistematik të lidhur e të zhdërvjelltë, dhe një gjuhë sa më të saktë e të pasur. Mbi të gjitha këto shquhen origjinaliteti i vështrimit të tij, aftësimi i gjuhës shqipe për të shprehur nocionet e konceptet abstrakte e të holla, një mendje e mprehtë dhe një erudicion mund të thuash jo i zakonshëm.

Autori është njohës i mirë jo vetëm i letërsisë teologjike, por edhe i letërsisë klasike greke e latine. Del se ai ka njohuri edhe për mendimin shkencor të shekullit të tij. Janë vënë në dukje takimet e Bogdanit me racionalizmin e ndonjë rryme tjetër të mendimit të kohës. Tek ai mendimi, arsyeja, janë mjet për njohjen e Zotit, të botës, të njeriut. Po ashtu vërehet prirja për t'i bazuar njohuritë e tij teologjike e ideologjike në realitetin, në konkretin.

3) I. Rugova, *Vepra e Bogdanit, 1625-1689, Prishtinë, 1982.*

Në pjesën e parë të veprës trajtohen edhe probleme të ndryshme të shumë degëve të shkencave shoqërore, por edhe natyrore, si të gjeografisë, teorisë së letërsisë, astronomisë, fizikës, matematikës etj. Pranë shpjegimesh jo të qëlluara ose jo në përputhje me të dhënat e shkencës, gjejmë edhe shpjegime të sakta e të arsyeshme të dukurive të natyrës, që, natyrisht, ai orvatet t'i pajtojë me doktrinën fetare. Ai flet për burimin e dukurive atmosferike, si formohen shiu, breshëri, bora, vetëtima etj., si shkaktohen tërmetet, duke goditur besimet e kota që qarkullonin për to. Tërmetet i shpjegon si avuj që dalin nga toka. po nuk mund të shpërthejnë, prandaj shkaktojnë dridhje. Për vetëtimën e bubullimën lufton besimin e kotë se shtie shën Ilia. Për tokën pohon se ajo qëndron vetë. dhe nuk e mban një mëzat. sikur besojnë disa. Po kështu flet për të zënë të diellit e të hënës etj.

Me interes janë edhe idetë e tia pedagogjike si ajo e moshave, konceptet e tia morale. Për t'u përmendur është mendimi i tij mbi lidhien midis njihtes shoisore dhe njohjes mendore. «Gjithqish hin në mend. — thotë ai. — përcillet nënër shoise të trunit». Bëhet fjalë për kategoritë estetike, sidomos për të bukurën. Për këtë ai ka konceptin e filozofisë mesietare. Zoti, sinas këtti koncepti. krijoi vetëm gjëra të bukura: kozmosin, njeriun, natyrën dhe krijesat e niveleve më të ulta. Bogdani mendon se e bukura dhe e ndershmja, moralia, shkoinë ose duhet të shkoinë bashkë. Ai siell edhe ndonjë shembull nër të treguar se e bukura nërkon me të pastrën: «Drini e Buna, kur dalënë iashtë hripieshit së tyne e rriedhinë ndënër hërrakë të Hasit e Zadrinës, ndo Sitnica, e si Vardari ndënër Shkunit e ndënër Kosovë, gjithëherë ecinë e ianë më të turbullta, tue bajtunë me vehëte nlehë e baltë, se kur ecinë amësë vet».

Pietër Bogdani e coi përpara mendimin shoiptar, e ngriti më lart letërsinë shoipe, me përmbaitien aq të nasur të veprës së tii, me idetë e tii, me problemet filozofike që ai trajtoi me nivelin e dñhur të lartë, si edhe me ndieniat afshodashëse të tii, që gjetën shprehje në parathënien, por edhe në tekst, sa herë që atij i bëhet i mundshëm një veprim i tillë. Ai gien rast të përmendë qëndresën hurrërore të kelmendasve me admirim e kërenari: «Kush mundetë me i ra mboh se ma i vobek kie Vuca Pasha, i silli, nër të mbhëledhë nji ushëri 12000 vetësh, nuk i mbastuen shumë miljon ar, se kelmendasit tanë, të sijtë, me nji zan «Eja

kush anshtë trim», mbëledhunë afërë 500 vetë, vranë Vuça Pashën, vjetit së Krishtit 1659, e ndë nevojë mpsuen me granë lëkurën e qarrit posi të begatëtë majën e miellit, ende atyne ajo gjellë ma shije u ka se Pashallarëvet e Sangjakëve mishi i k'ingjavet e vjetavet njomë». Në një vend tjetër ai thotë: «Malësorëtë tanë, të sijtë kurrë nukë përvihenë ndjerë nd'anet Senjakëvet. Qevali të nji kaqi të madhi mizuer, qi ban me djerunë gjithë shekullorët». Bogdani njuh mirë historinë e Shqipërisë e shkrimet për të, ka parasysh shpesh Barletin. Diku ai përmend thënien e Herodianit se Çezar Augusti «dëshironte fort me pasun ndë ushtëritë tinë t'ar-bëneshëtë. Përse, thoj, pesonjienë shumë e nuk druen për hu e për het e se janë më zemërorë se të tjerët». Nga kjo thënie shihet se ai i bën një shqiptarët me ilirët, i lidh gje-nealogjikisht këto dy entitete etnike.

Pjetër Bogdani e pasuroi letërsinë shqipe jo vetëm me mendimin filozofik e dituror, që ai e shtjiellon në një nivel të ngritur, po edhe me vlerat e shuma letrare artistike të reja që solli ose realizoi në një masë e shkallë më të lartë.

Ky mendimtar e letrar i shquar i letërsisë sonë të vjetër dha ndihmesa lidhur me gjinitë letrare, me mjetet artistike, me stilet e ligjërimet, me aftësimin e giubës sonë për të shprehur mendime abstrakte, me vizatimin e figurave, po edhe në teorinë e letërsisë. Ai e ngriti më lart si prozën ashtu edhe poezinë.

Në teorinë letrare ai shtron problemin e klasifikimit të tipeve të shkrimit, analizon rolin e metaforës dhe të disa figurave retorike në shkrimet biblike: flet për analogjinë dhe për figurat alegorike si parabolat, përmend rolin dhe kuptimin e simboleve në këto tekste.

Me jetën e Krishtit e jetën e Shën Mërisë ai shtiu në letërsinë tonë llojin e jetëshkrimit. Figura e Krishtit është vizatuar me realizëm. Ajo realizohet përmes rrëfimit artistik nga veta të ndrvshme. Vend të rëndësishëm zë nërshkrimi i viseve e ai i personazheve me vizatimin e fizikut të këtyre. Përdoret dialogu biblik në formë të ligjëratës së zhdrejtë, ndonjëherë edhe dialogu i drejtpërdrejtë, por edhe monologu. Fjala është e ngarkuar me mjaft emocionalitet e me ngjyrim afektiv.

Në veprën e Bogdanit gjejmë edhe shembulla të polemikës. Ajo zhvillohet në planin filozofik-shkencor dhe në planin ideologjik. Drejtohet në radhë të parë kundër koncepteve dhe botëkuptimit të islamizmit, po ndonjëherë edhe

kundër shpjegimit kristian të vjetër të ndonjë dukurie natyrore si vetëtima. Edhe në polemikë shfaqet kultura e gjerë e autorit, mënyra e procedimit të zakonshëm të tij, temperamentit i tij i shprehur në argumentet që jep e në intonacionin stilistik të parashtrimit. Bogdani i njeh gjërat në thellësi. Së pari jep tezën që kërkon të luftojë, pastaj kundërgumentimin e vet, antitezën, me elementet e komentimit e të shpjegimit.

Bogdani dha ndihmesa të rëndësishme veçanërisht në formimin e prozës shkencore shqipe, si nga shtjellimi i parashtrimit, si nga përpunimi stilistik e gjuhësor i saj. Autori tregon një mjeshtëri të veçantë e origjinalitet në shprehjen letrare të mendimit të tij të pasur për probleme të vështira filozofike. Stili i tij mban vulën e stilit klasik të lashtë, që është faktori kryesor i formimit të personalitetit të tij letrar. Ai dallohet për përpikëri, maturi, herë-herë për hijeshi. Të sjellim një shembull të përshtatshëm si përmylljen e parathënies shumë domethënëse për patriotizmin e Bogdanit e aq karakteristike për aftësitë letrare të tij. Ai i drejtohet lexuesit kështu:

«Të lutemi pra, letërimi em i urti, të më ndëjejshtë ndë gjeç fjalëzë që të trazon veshëtë. Përse as dielli pa hie, as hana pa njëgullazë mbi faqe nuk anshtë, po venë roe se kush na ka pushtuem e ndë kujet dhe jemi, ani me zemërë anëko posi tha Ovidi (Libri II, elegjia I:

*Si qua videbuntur casu dicta latine,
in qua scribebam barbara terra fuit».*

Pjetër Bogdani lëvroi me mjeshtëri edhe vjershërinë shqipe. Ai nuk shkroi aq shumë poezi sa Pjetër Budi, po 11 vjershat e tij dallohen për mendimin e ngjeshur, ndonjëherë për imagjinatën e fuqishme, gjithnjë për teknikën e sigurt e të goditur, për figurat stilistike që përdor³. Ato përbëhen prej 10 poezish kushtuar qenieve mitologjike, sibilave, në bazë të letërsisë greke dhe Virgjilit, si dhe 1 vjershë drejtuar arqipeshkvit të Tivarit, Smajevicit.

Këngët e sibilave karakterizohen nga një mendim metafizik shumë abstrakt, nga një fuqi përfytyruese e shënuar, nga një figuracion artistik i pasur. Ndër to ka tërhequr vë-

3) Shih I. Rugovën në veprën e cituar për realizimet artistike.

mendjen e studiuesve sidomos poezia kozmogonike «Krijimi i rruzullimit», që është veçanërisht e fuqishme. Përbëhet prej dy strofash, me vargje 11 rrokësh, ku konceptimi i shkallës së lartë të abstraksionimit shoqërohet me një të menduar e të perceptuar real dhe jetësor. Le të japim disa vargje:

Ndë Qiellt nuk'ishte as Yll, as Dielli,
Qi me dritëtë vet zbardhen dritë të re,
As Hana delte me dy të rgjanta bri,
As prej qiellshit vinte ndonji rreze përdhe.

Pjetër Bogdani është ndër përkthyesit e parë diturorë e letrarë në gjuhën shqipe. Me versionin italisht, me të cilin qe detyruar të shoqërojë botimin e veprës së tij, ai del si i pari përkthyes nga shqipja në një gjuhë të huaj. Në vepër ai përmend autorë grekë e latinë, filozofë e letrarë, duke dhënë mendimet e tyre, ndonjëherë edhe citate të shkurtëra të thënieve të tyre. Kështu përmenden: Sokrati, Platoni, Aristoteli, Diogjeni, Aristarku, Epikuri, Hipokarti, Pitagora, Varoni, Seneka, Ciceroni. Ovidi, Plini i vjetër, Salusti, Properci, Averroë, Makiaveli. Jipen të përkthyer vargje të Homerit, të Virgjilit, Juvenalit. Pjetër Bogdani është kështu i pari përkthyes letrar në gjuhën shqipe. Edhe në këtë fushë diktohet mjeshtëria e tij, aftësia interpretuese dhe transponuese, kujdesi i madh që të jetë e kuptueshme si duhet poezia në gjuhën e përkthyer, të jetë shprehja sa më shumë në frymën e gjuhës shqipe. Ka një gjuhë të formuar poetike. përkthen lirshëm e në mënyrë krijuese.

Një ndihmesë të madhe i dha Pjetër Bogdani përpunimit dhe pasurimit të gjuhës letrare. Ai i kushtoi kësaj pune vëmendje të veçantë dhe një punë këmbëngulëse. Është i pari autor që shtron në mënyrë të tërthortë problemin e gjuhës letrare, të koinesë letrare, që ishte duke u zhvilluar në bazë të gegërishtes veriperëndimore. Ai vë re ndryshimin që ekziston në mes të së folmes së tij amtare të Hasit të Prizrenit dhe ligjërit të Shkodrës, dhe s'u kursye në punën jo të vogël që i'u desh për t'u shkëputur nga veçoritë dialektore të vendlindjes së tij e për të shkruar në pajtim me traditën letrare të shqipes të asaj kohe. «M'ashtë dashtunë, — thotë ai, — me djersë të mëdha shumë fjalë me ndrequnë ndë dhe të Shkodrësë».

Pjetër Bogdani ka meritën e madhe që e bëri shqipen

të aftë për të shprehur edhe konceptet më të ndërlikuara, më abstrakte e më të holla, më të vështira, të filozofisë, të teologjisë e të shkencave të ndryshme. Ai tregoi kujdes për të përdorur një shqipe sa më të pastër e për ta pasuruar gjuhën e shkruar me fjalët e shprehjet e nevojshme. Mblodhi me kujdes fjalë të rralla e të lashta, i përdori ato në veprën e tij, duke u ndihmuar edhe nga i ungji, Andrea Bogdani, që i dha shumë fjalë «t'arbëreshe, të sijat i kish udob e për duer».

E rëndësishme qe veprimtaria e tij aq e frytshme për krijimin e pasurimin e terminologjisë filozofike e shkencore. Po aq rëndësi kanë edhe ndihmesat e P. Bogdanit për ndërtimin sintaksor të ligjërimit e për përsosjen e shqipes letrare në stilet e ndryshme e mjetet e tyre, «Dëshirova, — thotë, — mirëfilli qish po flasëm italianisht, bukur të kumbon e të kallëzon arbërisht».

Nevoja për të harmonizuar tekstin shqip me tekstin italisht e anasjelltas, e detyron të prekë herë njërin, herë tjetrin «tue u njëmendun herë giuha jonë me të italianesë, herë kjo me tanët», dobëson herë-herë vetvetishmërinë e rrjedhshmërinë e shprehjes e të stilit, çka dëmton origjinalitetin e strukturës sintaksore të shqipes. Autori ndjek në ndërtimin e periudhës shtjellimin e periudhës latine, pa arritur gjithmonë ta realizojë. Megjithatë s'mund të mohohet hapi i madh përpara që bën me veprën e tij gjuha letrare shqipe edhe nga ana e strukturës sintaksore. Periudha e Bogdanit është më mirë e ndërtuar, më e lidhur, më e shkahtët se ajo e paraardhësve të tij. Budit e Bardhit. Zotëron, sidomos në pjesën e parë, periudha e gjatë, shprehje e një mendimi kompleks. Bogdani arrin të shprehet me përpikëri e hijeshi, me figura të goditura. Pra «Çeta e profetëve» shënon pasurimin e letërsisë shqipe me vlera të reja letrare reale të shumta.

Nga sa u parashtrua, shihet mirë se Pjetër Bogdani, filozof e mendimtar i shquar, letrar i talentuar e me kulturë të gjerë, është figura më e madhe e letërsisë sonë të vjetër, që e bën të zërë një vend të shënuar në historinë e gjithë letërsisë shqipe.

Ky personalitet i shquar i historisë kulturore të popullit tonë meriton të bëhet objekt edhe studimesh të mëtejme, për gjerësinë e rëndësinë e veprës e të veprimtarisë së tij në fusha të ndryshme.

Résumé

PJETËR BOGDANI ET LA VIEILLE LITTÉRATURE

Dans l'activité si large et variée de Pjetër Bogdani, une place principale est occupée de l'oeuvre «Cuneus Profetarum» qu'il a publié en 1685 à Padoue. Elle fait partie de la production littéraire en albanais du 17^e siècle, inspirée du dévouement religieux et des sentiments patriotiques, tout en suivant une tradition antérieure de caractère religieux et didactique. Mais Bogdani a avancé beaucoup plus que ses prédécesseurs. La large culture théologique, philosophique, encyclopédique et littéraire lui donne la possibilité de voir plus loin et d'une manière plus large, d'avoir des buts plus prétentieux, des réalisations plus importantes avec des valeurs particulières philosophiques et littéraires, de faire avancer la pensée albanaise et la littérature en albanais de leur frayer le chemin vers le développement ultérieur. Bogdani a donné à la culture albanaise une oeuvre monumentale en ce qui concerne son contenu, ses problèmes et idées et aussi ses diverses valeurs littéraires.

multiples et importantes sont les mérites de Bogdani en tant qu'homme de lettres érudit et doué.

Son oeuvre était une oeuvre originale, la première oeuvre originale en albanais, traitant de difficiles problèmes théologiques et philosophiques, pleine d'érudition et d'observations sur la difficile situation d'alors et sur l'histoire du peuple albanais. Ce penseur érudit trouve l'ignorance comme le plus grand malheur de ses compatriotes et il s'efforce, d'illuminer leur esprit, pour l'enseignement en langue maternelle.

Dans cette oeuvre Bogdani a donné une contribution importante théorique et pratique pour la science et l'art des lettres. Dans la théorie littéraire il a posé des problèmes généraux et des problèmes divers du style et de la poétique, il a discuté sur les manières d'écrire, sur les figures rhétoriques, sur les symboles, sur les catégories esthétiques et surtout sur le concept du beau. Il a introduit dans la littérature albanaise le genre littéraire de la biographie, il a cultivé avec sûreté et intelligence la polémique sur le plan philosophique et d'érudition et sur le plan idéologique.

Cet auteur a contribué au développement de la prose en albanais, surtout de la prose scientifique. Il s'est montré original et un vrai maître dans l'expression de sa riche pensée. Il est un styliste, distingué. Son style est marqué de l'exactitude de la concision, de la

maturité, parfois de l'ampleur. Il a de bonnes réalisations dans la conception des figures artistiques et dans la construction syntaxique du discours.

Bogdani a cultivé aussi, avec maîtrise et une main sûre, la versification en albanais de 11 poésies qu'il a composés. Il est le premier traducteur littéraire en langue albanaise grâce à la traduction de strophes et vers de quelques auteurs latins.

Pjetër Bogdani a fait de l'albanais une langue capable à exprimer des concepts des plus compliqués, abstraits et fins et il a beaucoup travaillé pour l'enrichir de mots et expressions généraux ou terminologiques.

Tout cela fait de cet auteur la personnalité la plus remarquable de notre vieille littérature.

Prof. dr. ENGJELL SEDAJ
FAKULTETI FILOLOGJIK
PRISHTINË

POEZITË ORIGJINALE DHE TË PËRKTHYERA TË PJETËR BOGDANIT*

P. Bogdani njihet më tepër dhe kryesisht si prozator, që e ka kultivuar dhe e ka ngritur më së larti stilin e ligjërimin bisedor në letërsinë e vjetër shqiptare, por më pak njihet si poet,¹ ndonëse vëllimisht numri i vargjeve të tij origjinale dhe të përkthyer nuk është i vogël. Madje, derisa mos të konstatohet ndryshe, shumë vargje latine (dhe italiane), të

*) Këtë punim autori ia dërgoi redaksisë për ta botuar në materialet e Konferencës «Pjetër Bogdani dhe vepra e tij» në të cilën qoftuar të merrte pjesë.

1) Edhe në *Historinë e letërsisë shqipe I*, Tiranë, 1959, f. 233, thuhet se përveç dy vjershave, njëra e L. Sumës dhe e L. Bogdanit, «është edhe një vjershë nderimi e vetë Bogdanit për nder të Andrea Zmajeviqit», kurse për poezitë e tjera të tij, pothuajse nuk flitet më.

kënduara për nder të sibilave dhe në lidhje me to, mund të konsiderohen të tij, si poet latinist (dhe italianist), sikundër edhe ata humanistë shqiptarë, që këndonin poezi në gjuhën latine².

Përveç 133 vargjeve në gjuhën shqipe mbi sibilat, në «Çetën e profetëve» të P. Bogdanit, mund të vihen re edhe shumë vargje të tjera origjinale dhe të përkthyer, si dhe disa vargje në gjuhën latine dhe italiane, për të cilat nuk dihet saktësisht autorësia. Kështu pra, në pjesën e parë dhe të dytë të veprës, si dhe në mesin e parathëniesve dhe të përkushtimeve, që janë pa numër faqesh³, në këtë libër gjithsej vargje origjinale të P. Bogdanit janë 161. kurse të përkthyer nga ai janë tri vargje të Homerit⁴, katër vargje të Juvenalit⁵, pesë të Virgjilit⁶, tre të Marcialit⁷, dy nga teksti i Tomë Akuinit⁸, katër nga libri i Proverbave të Biblës⁹, gjashtëmbëdhjetë nga poezia e «Krijimit të rruzullimit»¹⁰ të poetit të panjohur dhe në katër vende të tjera¹¹, 22 vargje.

2) Ndër humanistët shqiptarë, që këndonin poezi në gjuhën latine, pa dyshim, më i shquari është Mikel Maruli. Disa poezi të tij janë përkthyer nga autori i këtij shkrimi dhe janë botuar në «Jeta e re» nr. 6 (1984), Prishtinë, 1984, f. 1077-1091. Krh. edhe M. Hysa, *Krestomatia e letërsisë së vjetër shqiptare*, Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Prishtinë 1986, f. 22-32.

3) Këtu nuk janë marrë në shqyrtim poezitë përkushtimore të autorëve të tjerë në 53 faqet e librit në fillim pa numër faqesh. Këto poezi përkushtimore dhe parathënie në gjuhën shqipe dhe të përkthyer nga gjuhë të huaja (latinisht, italisht dhe serbokroatisht) janë botuar te: «Jeta e re», nr. 1, (1984), Prishtinë, 1984, f. 53-79 me një parathënie të shkurtër mbi to nga Ëngjëll Sedaj.

4) *Cuneus prophetarum*, I, I, 1, 19 (Numrat tregojnë «pjesën», «shkallën», «ligjëratën» dhe paragrafin).

5) I, I, 1, 14.

6) I, I, 2, 18; II, II, 1, 5.

7) II, I, 4, 17.

8) I, II, 1, 8.

9) I, III, 4, 16.

10) I, I, 4, 4. Kështu «në frymën e terminologjisë së Bogdanit» e ka titulluar këtë poezi Ibrahim Rugova te: *Vepra e Bogdanit 1675-1685*. «Rilindja», Prishtinë, 1982, f. 259.

11) I, III, 2, 2; II, I, 3, 14; II, I, 4, 7; II, II, 1, 5.

gjithashtu të teksteve poetike, pa emër autori. Gjithsej pra 217 vargje origjinale dhe të përkthyer, pa llogaritur edhe disa vargje të tjera, të cilat P. Bogdani i krijon nga teksti latinisht (ose italisht) në prozë.

Duke lexuar me vëmendje «Çetër e profetëve» kuptojmë se autori i saj krijimin e vargjeve në gjuhën shqipe e kupton ndryshe nga lisiërimi poetik i himneve dhe i psalmeve biblike, të cilat besnikërisht i përkthen (në gjuhën shqipe). Kështu bie fjala, ato vargjet e bukura të profetit Sofonia: *Dies irae: dies illa: dies tribulationis et angustiae: dies calamitatis et miseriae: dies tenebrarum, et caliginis: dies tubae, et clangoris*, sikundër edhe shumë e shumë psalme të Davidit, poetit më të madh të letërsisë së vjetër hebraike¹², P. Bogdani i përkthen në prozë: *Ditta, e menissë, ajo dittë, ditta e travajevet, e shterghimvet, ditta e ç'ku-shëllimevet, e mjerissë, ditta e territ, e n'çjigjit, ditta e bo-riussë e keldhitmessë*¹³, ndonëse pikërisht këtë poezi, në formën që kishte marrë ajo në mesjetën e vonshme¹⁴, P. Budi do ta vërë në plan të parë të poezive të tij në «Doktrinën e krishterë».¹⁵

Botëkuptimi i P. Bogdanit për poezinë është në lidhje më të ngushtë me thurjen e vargjeve dhe të strofave, të organizimit dhe të instrumentimit të tyre, gati siç mendonin dhe praktikonin poetët antikë dhe mesjetarë, të cilët shkruanin poezi sipas rregullave të ngurta të metrikës. Nuk mungojnë rastet në tekstin bogdania kur edhe proza përkthehet në vargje, duke dëshmuar prirjen e pamohueshme të autorit për këtë krijimtari më të përsosur të artit letrar. Rregullat e metrikës ai i kupton jo vetëm në organizimin

12) Krh. I, III, 3 dhe vazhdim.

13) I, III, 16, 2.

14) Autori i saj është Thomas di Celena nga shek. XIII. Më gjerësisht për të: Curtius; *Evropska književnost i latinsko srednjovjekovlje*, MH, Zagreb, 1971, f. 325.

15) Ajo ditë me meni

chite vignie ndee vonë

ketë shekullite te zii

ta diege e ta përvëlognie

Si profeta ban deshmi

me sibillene po thon.

(*Doctrina Christiana, Romae, 1664, 175*).

dhe ndërtimin e vargut të tetërrrokëshit (popullor) dhe të njëmbëdhjetërrrokëshit, sipas sistemit silabik, por edhe duke zbatuar asonancën ose rimën, e cila pothuajse gjithherë sa-
 johet në formen trokaike (dhe jambike). Prandaj, këtu do të
 mpetet anësh ajo pjesë e tekstit poetik, që nuk është thurur
 në vargje e strofa, për të përqendruar vëmendjen në ato
 pjesë të tekstit të natyrës versologjike. S'do mend se teksti
 bogdaniai është plot poezi, mirëpo këtu nuk është e orga-
 nizuuar në vargje as ajo poezia efektive *Madho shpirti em
 T'enezone Magnificat anima mea Dominum*¹⁶, në të cilën,
 bashkë me *Ty te nfalemi, o ylli i detit, e Ama e denje e Ti-
 nëzot*, në tekstin e «Mesharit» të Gj. Buzukut¹⁷ shfaqen «ru-
 dimentet e para të poezisë në literaturën shqiptare» (E. Ça-
 bej)¹⁸.

Duke folur për psalmet e Davidit, P. Bogdani thotë se
 «Shkroi Davidi 150 sal. qi mbahen ndë këta vjersha:

Kendoj Salma pensesdhjetë
 Mbij qind: e vjersha mij,
 Dyy, gjashtë qind e dhjetë
 Pa kater: ndë Arpe u bij¹⁹

Në fakt, këto katër vargje tetërrokshe, të cilat ai i quan
 «Vjersha», i përkthen nga dy vargjet heksametrike («due
 esametri») latine:

Ter quingenos David canit ordīne psalmos

Versus bis mille, sexcentos sex canit itte²⁰

në një mënyrë të lirë, në lidhje me kupimin e tekstit bu-
 rimor, por pa asnjë varg katalekti dhe me një mundësi ska-
 ndimi, megjithëse në vargun e dyte une të katert logjet za-
 nore (*mij* dhe *bij*) numërohen si dy rrokje dhe tneksi bie mbi
 rrokjen e shtatë. Prandaj, organizimi i pergjithshëm i kësaj
 strofe është si të thuash, mjaft i përsosur, duke u inkua-
 druar plotësisht në sistemin e vargëzimit, sado që këtu s'ke-
 mi të bëjmë me ndonjë tekst të rëndësishëm poetik.

Pothuajse, njësoj ka vepruar edhe me dy heksametra

16) II, I, 3, 11.

17) Gjon Buzuku, «Meshari» 2, «Rilindja», Prishtinë, 1988, f. 59.

18) Krh. Engjëll Sedaj, «Meshari» i Gjon Buzukut në përgatitjen
 e Eqrem Çabejt, te: «Jeta e re» 1 (1988), Prishtinë, 1988, f. 52-53.

19) I, III, 2, 2.

20) ibidem.

(latinisht) të Homerit, nga të cilët krijohen këto vargje tetë-
rrokëshe në gjuhën shqipe, në një tercinë mjaft karakteris-
tike:

Pak as gja, ushtërii
Po Regj, e nji Qefalij
Ndoron dhenë me godij²¹

Këtë botëkuptim mbi tetërokshin dhe në përgjithësi mbi vargun e rimuar mbasi ai do ta ketë trashëguar nga pararendësit e tij shqiptarë, përkatësisht nga poezia popullore shqiptare, sidomos nga ajo poezi popullore kishtare, që kishte një traditë në këndimin celebral, me anë të manua-
leve të doktrinave (Matranga, Budi), kurse vetëdija e tij mbi përkthimin e poezisë mbështetet në lirinë krijuese dhe në kujdesin e shtuar për kuptimin e poezisë në gjuhën e përkthyer²². Vetëdija e tij mbi artin poetik është e lartë dhe, në njërin anë, nuk largohet nga një traditë e gjatë dhe e pasur e këndimit celebral kishtar, kurse, në tjetrën anë, ajo bazohet në prozodinë klasike dhe në tercinën romane. Në rastin konkret në këto tri vargje tetërokëshe të rimuara AAA, fizionomia popullore del e qartë nga theksat ritmike në rrokjen e tretë dhe në të shtatën. Këtë këndim të formësuar dhe me një traditë të gjatë ndër shqiptarë, P. Bogdani e gërsheton me kantikën dhe odën e njohur (latine) si të thash, të antifonës liturgjike dhe me subjektin mesdhetar ose judaiko-kristian të përmbledhjes vëllimore «Oracula Sibyllina»²³, që kishte ushtruar ndikesë, jo vetëm mbi shën Augustinin dhe Dante Aligerin, por edhe mbi Thoma Akuinin²⁴.

Kjo lidhje gjeniale përmes figurshmërisë poetike, që e karakterizon edhe tërësinë e veprës së tij në prozë, e ngriti lart vlerën artistike të poezive origjinale dhe të përkthyer të P. Bogdanit.

21) Multos esse duces, aut quidquam proderit: esto **Rex unus**, Principis unus, qui Publica tracet. I, I, 19.

22) Krh. I. Rugova, *Vepra*, f. 184.

23) Njihen edhe si libri *Sibyllini dhe fata Sibyllina*. Krh. *Der kleine Pauly*, Lexikon der Antike. V, Munchen, 1975, f. 158-161; D. Srejić, A. Cermanović, *Rečnik grčke i rimske mitologije*, SKZ, Beograd, 1979, p. 381-383.

24) Krh. Šagi — Bunić, *Povjest kršćanske literature*, KS, Zagreb, 1976, f. 229.

Ndër shumë poezi përkushtimore në «Çetën e profetëve», ajo që i dedikohet A. Zmajeviqit, e që ka 24 vargje tërrokëshe, e shkruar në strofa katërshe, ndonëse është botuar pa emër të autorit, mund të mendohet se është e P. Bogdanit. Çështjen nuk po e bëjmë të diskutueshme përkritazi me autorin e kësaj poezie edhe për shkak të përmbajtjes së saj dhe të rrethanave të tjera në lidhje me raportet e P. Bogdanit me Tivarin dhe Zmajeviqët, që gëzonin gjithsesi autoritet të madh. Në strofën e parë të kësaj poezie

Ban — Baroni prej Tivari,
Zmajeviq, o drita jonë;
Ruen Arbenin i pari;
Posi Krishti mal Syonë.²⁵

nëse për një moment i lëmë anësh karakteristikat e tjera metrike dhe sintaktike, në krahasim me strofën e cituar më lart të vargjeve të Homerit, përsëri dalin elementet popullore të tetërrokshit me theksa ritmik në rrokjen e tretë dhe në të shtatën²⁶, përkatësisht *o, i, e, i* dhe *a* (Tivari), *o* (jonë), *a* (pari), *o* (Syonë).

Edhe në këto katër vargje, nga këto evokime të emrave të historisë karizmatike shqiptare dhe kishtare, të organizuara mirë në kuptimin rimor dhe ritmik, kuptojmë gjerësinë e mendimeve dhe të idealeve më të larta të poetit të talentuar për të kënduar poezi, si dhe njohjen e nuancave të ligjërimit poetik. Pra, vargu tetërrokësh, strofa katërshe dhe rima e alternuar janë të njëjtat veçori që karakterizojnë dhe poezitë e P. Budit²⁷, përkatësisht që karakterizojnë vargun e poezisë popullore, që del shumë i përhapur edhe në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare²⁸. Prandaj, kon-

25) Nga *Çeta e profetëve*, f. 21 pa numër faqesh.

26) Krh. Jakov Xoxa, *Hyrje në shkencën e letërsisë*, Prishtinë, 1970, f. 120.

27) Budi, Poezi, «Rilindja», Prishtinë, 1987, f. 34.

28) Krh. këto vargje të Naim Frashërit nga «Istori e Skënderbeut»:

U ngrit tati Shqipërisë
Si i vdekuri nga Varri,
morri udhën e Azisë
duke ikur si i marrë

ceptimi metrik i P. Bogdanit, në lidhje të ngushtë me përvojën e poezisë popullore, u forcua si një karakteristikë novatore në gjithë letërsinë shqiptare. Kjo karakteristikë e poezisë së tij nuk dallohet vetëm me forma, vargje, strofa, por edhe me frazeologjizma dhe ritme popullore. Pa dyshim, vargje të tij origjinale janë edhe ato që gjenden në gravurën e fundit të punuar nga Rufoni:

Krishtit për ty kryeqesuem
Me të madhe amiqnenij
Kamb, e duar depertuem
As ju fal o nierij.²⁹

Duke i krahasuar këto vargie (origjinale) me një strofë katërshe të Juvenalit të përkthyer nga P. Bogdani, kuptojmë se forca krijuese, e poetit në punë të formës është e barabartë edhe në procesin e përkthimit dhe se, për hir të vlerave të vargëzimit, teksti i tij poetik është një lloj mbindërtimi, sic mendon S. Hamiti, edhe për poezitë e tij mbi sibilat³⁰. Në fakt, përveç atij momenti përmbajtësor, në punët versologjike s'ka kurrfarë dallimi midis vargjeve origjinale dhe të përkthyerat të P. Bogdanit.

Lumja ti o gjin' e mirë
Hyji tyy si Purrini,
Kopeshtinevet pa hirë
Posi gramthi vetë bini³¹

Këto vargje i citon si të Juvenalit, por në disa raste shprehimisht thotë «posi thotë poeta», dhe nuk kuptojmë saktësisht për cilin poet e ka fjalën. Kështu, bie fjala, duke shfaqur botëkuptimin e tij të lirë mbi soditjen e dukurive

në të cilët gjithëherë është theksuar rrokja e tretë dhe e shtatë e vargut.

29) II, III, 2, teksti në gravurë.

30) Krh. Sabri Hamiti, *Vetëdija letrare*, «Rilindja», Prishtinë, 1989, f. 121.

31) Porrum et ceppas nefas violare et frangere morsu;
o sancta gentes, quibus haec nascuntur in hortis
Numina et cetera. (I, I, 1, 14).

natyrore dhe të rruzullimit. thotë «Krijoj Hyji shtatn' e nierit me faqe nalt prej qiellshit, posi thotë poeta: Faqe nierit të naltë i dha, e qiellin me soditunë e urdhënoj»³². Në lidhje me këtë mendim interes të veçantë zgjon gjithashtu edhe poezia e një «poeti» të panjohur, të cilën P. Bogdani e përkthen (në një mënyrë mjaft të lirë), duke vënë përmbajtjen e saj në lidhje me ato fjalët e *Gjenezës* se «dhei ishte i mbrazetë e i përziem» (*Terra erat inanis et vacua*):

Parëse qiellja, dheu, deti e zjarrmi
ishte: kje zjarrmi, dheu, qiellja e deti:

.....

Në qiell s'kishte as yll as dielli,
që me dritë të vet zbardhë dritë të re,
as hëna dilte me dy t'argjendtë brirë³³

Ndonëse kjo poezi është e përkthyer (nga italishtja) dhe e ndërtuar sipas modelit të eposit italian «Jerusalemi i çliaruar» të Tasos³⁴, renditja rimore e saj në njëmbëdhjetërokëshin e preferuar të P. Bogdanit, me mjete të tjera të ligjërimit poetik, inkuadrohet mjaft bukur në paraqitjet përmbajtësore të «ligjëratave» të tij përkitazi me figurshmërinë e krijimit gjenealogjik të rruzullimit, prej *Gjenezës* (*Biblës*), të *Teogonisë* së Hesiodit e këndeje. Në fakt, e vërteta poetike perceptohet në imagjinimin e situatave metaforike, të mishëruara në ligjërimin e gjuhës shqipe, ndoshta edhe më bukur se në gjuhën italiane. Prandaj në këtë poezi poeti e ka arritur përjetimin spontan poetik dhe tingëllimin e fuqishëm metrik. Në këto dy stanca, të përbëra nga tetë njëmbëdhjetërokësh, nuk rimojnë vetëm artikulet e vargëzimit të rregullt për krijimin e vargjeve dhe të strofave, por edhe elementet sintaksore, që janë: *qiellja, dheu, deti, zjarrmi, ujët, dielli, drita, hana, rrezet, valët e detit, mje-*

32) I, I, 6, 4.

33) I, I, 4, 4.

34) Krh. I. Rugova, *Vepra*, f. 173. Krahasimi me eposin e Tasos bëhet më tepër për shkak të strofës tetëshe sesa të vargut njëmbëdhjetërokësh. Kjo strofë edhe të P. Bogdani ka renditjen rimore: ABABABCC (Cuneus proph., I, I, 4, 4).

gulla, shiu, breshëri, lymenat dhe brigjet. Forca krijuese e poetit pra shfaqet në të gjitha momentet e rindërtimit të teksteve poetike aq sa ta merr mendja se është tekst origjinal i tij në të dy gjuhët: italisht dhe shqip³⁵. Në krahasim me disa poezi mbi sibilat, këtu stanca në elementet kryesore të strukturës së vargëzimit nuk ndryshon as në gjuhën italiane, si për shembull, rima është ABABABCC (*foco, mare, foco, mare, foco, mare, cielo, cielo*) si në gjuhën shqipe. Oktava ose strofë tetëshe kemi pothuajse në të gjitha këngët mbi sibilat, por vetëm në versionin shqip, çka do të thotë se kjo shprehje poetike të P. Bogdani është shumë e preferuar dhe novatore në letërsinë shqiptare edhe në kuptim të kultivimit të saj mjaft kuantitativ.

Se P. Bogdani ishte i prirur për poezi tregojnë edhe disa vargje të organizuara në rimë, si përkthim nga latinishtja ose italishtja, përkatësisht nga teksti burimor në prozë, si për shembull:

Roma ndë armë qish mos ka
me fe përpara i raa³⁶.

duke sakrifikuar shumë nga teksti burimor («Roma, kryeqytet i botës, çka nuk mund të mbajë me armë, e mban me religjion»), me të vetmin qëllim për të krijuar vargje. Edhe nga ai proverb i Salomonit se «tri punë janë muc të feshitura, e të katertenë as pak nukë e dij», P. Bogdani krijon poezinë

udhenë shqypesë mbë qielt,
udhenë gjarpenit përmbij gurt,
udhenë barkesë mjedis të deetit.
udhenë burrit ndë të rijtë vet³⁷

35) Krh. P. Bogdani, *Çeta e profetëve*, te: «Jeta e re», nr. 8 (1988), Prishtinë, 1988, f. 1072.

36) «Roma, caput mundi, quiddid non continet armis, religione tenet», (I, III, 3, 15).

37) I, III, 4, 15:

Viam aquilare in Caelo,
Viam Calubri super Petram
Viam naurs in medio maris
Viam viri in adolescentia sua.

sikundër edhe atë botëkuptimin e epikurianëve dhe të ma-
kiavelistëve:

«Hamë e pimë, se qish anshtë neserë s'e dijmë»³⁸
e bën poezi, duke u larguar dukshëm nga metoda e tij e bes-
nikërisë tekstuale në përkthim: kështu, bie fjala, *post mor-
tem* («pas vdekjes») e përkthen *qish anshtë neserë*, kurse
nulla voluptas, për shkak të rimës, e përkthen *s'e dijmë*.
Përkthime fragmentare të ngjashme gjenden edhe në pje-
sën e dytë të veprës, sepse ato ishin, në fakt një lloj shpër-
thimesh të poetit. Gati njësoj vepron edhe me ato fjalë «ger-
qisht kthyem mbe gjuhët tanë t'Arbëneshë»:

Te naltene Zot qi ruen
Qiel't e dhenë: t'adhoroni
Gjithë here, pa megeum,
Fort ta droni, ta levdoni

Vajzë Virgjineë Mrii
Qi thon' e shoqe ska,
Ti shekroijs o nierii
Lter, e kisha të mëdhaa

si një mbikëndim ose rikëndim i shkurtuar i nëntë heksa-
metrave latinisht³⁹.

Ky është edhe një prej momenteve të formimit të tij
poetik i cili, në një mënyrë më të plotë do ta dëshmojë ve-
ten në poezitë e sibilave. Prandaj edhe mund të thuhet se
P. Bogdani na paraqitet me më shumë poezi në shkallën IV
të pjesës I të librit. Njëmbëdhjetë «ligjëratat» e kësaj «shka-
lle» janë «kanketë» e sibilave dhe disa shënime mbi jetën e
tyre me përmbajtje të literaturës apokrifike ose intertesta-
mentare biblike për të kaluar në pjesën e dytë të veprës,
që është jeta e Mesisë (*De vita Jesu Christi*) jo në mënyrë
prozaike, por me këngë profetike, si të thuash, të të gjitha
trevave botërore, nga lindja dhe perëndimi.

Siç dihet, këtyre figurave legjendare, të cilat në aspek-

38) «Edamus et bibamus, quia post mortem nulla voluptas».
(I, I, 6, 11).

39) II, I, 3, 14.

tin liturgjiko-letrar e bashkonin antikën me mesjetën, kulturën e lindjes me të perëndimit, iu atribuoheshin qindra vargje profeteske mbi ngjarje të ndryshme, por për P. Bogdanin zgjojnë interes të shtuar ato vargje të tyre që e paralajmërojnë ardhjen e Krishtit, dhe, s'do mend, sibilat për autorin tonë kanë vlerën e profeteshave, siç i kishte cilësuar edhe P. Budi («Si Profeta ban dëshmi/ Me sibilenë, po thonë»⁴⁰. P. Bogdani sibilat i mendon edhe në shoqërinë e apostujve, të cilët qenë prirë nga ata që këndojnë në mjedis të vashëzave «të bashkuar me këngëtarë në mjedis të vashëzave lodërtare»⁴¹. Në këtë pikë përpigën madje edhe ato vargje të Virgjillit nga ekloga IV e tij mbi «djalin shoëtimtar», të cilat, në mënyrë të njohur,⁴² i interpreton P. Bogdani, por përsëri në oktavën e preferuar të tij sikurse poezinë e «Krijimit të rruzullimit»:

Paq e fruit i madh n'qielshit ka me kianë:
 Gjashtë vjet paresse len: ende mbas andaj,
 Gjashtë të tjera: sa dheu ska me përzanë:
 Mrekullë ke uiku, deleia, e kingji hai
 Bashkë: Kerthini Dialë, e kulshedra lanë
 veltemë: na droe, pa lot, as fial, as vaj:
 Ruchierbulli dhiti, e odhatë si nëhit
 Përse Zotynë mpach, i ruen, e i rhit⁴³

Mbase disa të dhëna në sibilat në të ishin të njohura më tepër nga tekstet në gjuhën italiane (dhe latine) sesa në gjuhën greke, nga e cila ai vetë thotë se janë «nxierrë gërciët»: pra janë përkthyer. Kështu, në njërin anë, mund të mendohet se ai e kishte tekstin bazë në gjuhën greke dhe,

40) P. Budi në përshtatjen ose rikëndimin e kësaj poezie e zëvendëson emrin e *Davidit* me *Profeta*: *Teste David cum Sibylla*. Kjo ka rëndësi pse *Davidi* konsiderohej poeti më i madh në tekstet biblike.

41) I, IV, 1, 1 (Përshtatja jonë).

42) Në eklogën IV Virgjili, duke folur për sibilën (Ultima Cumei venit) aludon në ato tri momentet kryesore mbi ardhjen e Mesisë, që janë «virgo», «nova progenies caelo» dhe «nascenti puero» Kth. P. Vergilli, *Maronis Opera*, Oxonii, 1950).

43) *Cuneus prophetarum*, I, IV, 2 1.

në anën tjetër, të gjitha ato momente të tjera që e plotësojnë këtë tekst me motive kombëtare shqiptare dhe kishtarë e mesjetare.

Dihet mirëfilli se edhe Mikelanxhelo i kishte pikturuar këto sibila në Kapelën Sikstinë të Vatikanit, së bashku me profetët, kurse pas tij (në vitin 1514) dhe Rafaelo Santi (në shoqëri me engjëjt) në kishën e shën Marisë së Paqes në Romë⁴⁴, të cilat P. Bogdani gjatë qëndrimit të tij në Romë mbase do t'i ketë shikuar. Së këndejmi, në Bizant, si të thuash, tradita sibiline është ruajtur edhe më mirë⁴⁵ për të arritur një lloj kulminacioni në mesjetën e vonë pikërisht duke simbolizuar librin dhe fuqinë e madhe të tij⁴⁶.

Duke pasur parasysh këto momente të simbolikës mesjetare, mund të kuptojmë më lehtë figurshmërinë e «librit» të P. Bogdanit dhe domethënien poetike të titullit të tij (*Cuneus prophetarum*), në përkthimin e të cilit, vërtet fundin në vështirësi. Sibilat e shkallës IV paraqesin vetëm fundin e kësaj «çete» të gjatë, por edhe fillimin e një «epoke» të re në historinë botërore (pjesën II të librit), epokën e shpëtimimit njerëzor nga mëkati dhe kohën e premtuar të Virgjilit. e të demitizuar, tërthorazi figurave dhe personazheve shumë të njohura dhe depërtuese të Pashtrikut, Sionit, Kampadolit dhe të Olimpit, të vajzës Mëri «me diell veshunë e mbathunë me hanë» që përsëri të vazhdojë jeta e jetësimit dhe e shpresës:

Pas tri ditësh do ta kthejë dritën
dhe do t'iu dëftojë ëndërrën vdekëtarëve

44) Vojtech Zamarovsky, *Junaci antičkih mitova*, SK, Zagreb, 1973, f. 276.

45) Khr. Sabina Osvat *Grëka i rimska mitologija*, «Vuk Karadžić — Larousse», Beograd, 1980, f. 307.

46) Krh. vargjet: *Liber scriptus proferetur / In quo totum continetur Unde mundus iudicetur*

të cilat P. Budi i përkthen kësisoj:

Kur letëra (= libri) të dalë,

Ndë të cijt anshtë shkruom

Gjithë mkat e gjithë fjalë (= çdo mëkat e çdo fjalë)

Qi a folë e ligjëruom. (Vep. e cit., f. 53)

dhe do t'i ndriçojë i patërhequri të gjitha gjërat
dhe do t'iu afrohet nga mjegulla qiellorëve të drejtë.⁴⁷

Këto vargje (të përkthyer) latine, në fakt, vetëm mund t'i kenë shërbyer P. Bogdanit si frymëzim përmbajtësor për të kënduar një poezi prej tetë vargjesh njëmbëdhjetërrrokëshe me rimë të alternuar ABABACC, kësisoji:

Mbasi Ljinë plake me vetehe vorroj:
Tue hjekunë mprapa Mornë ndë robij.
Si shqype nalt Krishti qieltë kaptoj.
Shkruem ndë gjaktë vet për ty, o njeri!⁴⁸

Duke i krahasuar kështu këto njëmbëdhjetë poezi, të cilat në versionin shqip kanë 133 vargje dhe latinisht 81 vargje⁴⁹, kuptojmë se ndryshimin në formë dhe në përmbajtje, kështu që, edhe pse janë të përkthyer nga greqishtja⁵⁰, ky përkthim është shumë karakteristik dhe krejtësisht ndryshon nga mënyra e tji e të përkthverit të tekstit në prozë. Ç'është e vërteta, në disa vargje në të cilat ai evokon Pashtrikun, Prizrenin eti, (Sion se Pashtriku mal Priserend ma i nalti), shfaqet origjinaliteti i poetit, i cili në punë të formës gjithashtu krijon vargje njëmbëdhjetërrrokëshe dhe heksametrike. Duke i lexuar me vëmendje të dy shtyllat e librit ose më drejt, në të dy (tri) giuhët kuptojmë saktësisht se struktura e vargëzimit nuk përputhet në asnjë poezi midis varianteve të ndryshme giuhësore, sepse të njëmbëdhjetat poezi mbi sibilat në giuhën shqipe P. Bogdani i ka kënduar

47) Këto vargje janë përkthim nga vargjet latine:
Sed postquam triduo lucem reperiverit, atque
Monstrarit somnum mortalibus, atque docendo
Nubibus invectus. (I, IV, 11, 1).

48) I, IV, 11, 1.

49) Vetëm e para dhe e dyta poezi nga kjo shkallë (IV) në shtyllë e parë të tekstit janë disi të përfolura italisht, kurse të gjitha të tierat latinisht.

50) Bogdani vetëm në versionin italisht thotë «sono tradotti del Greco», kurse në tekstin shqip shprehimisht thotë «Disa vjersha të tyre janë... nxjerrë Gërqijet».

në oktavën, sipas modelit të Tasos⁵¹, në poezinë e parë tri strofa (24 vargje), në poezinë e dytë një strofë (8 vargje), në poezinë e tretë dy strofa (16 vargje), në poezinë e katërt një strofë (8 vargje), e kështu me radhë. Ndërkaq, për poezitë në gjuhën latine (dhe italiane) mbi sibilat nuk mund të themi se janë kënduar në të njëjtën mënyrë. Për shembull, te Sibila Samia⁵², vetëm katër vargjet e fundit janë kënduar në heksametër (latinisht), sikundër edhe shumica e vargjeve nga poezitë e tjera. Në këtë mënyrë, P. Bogdani bëhet edhe poet latinist, duke iu bashkuar pantenonit të madh të atyre humanistëve evropianë, që këndonin vargjet e tyre në gjuhën latine.

Ja si mund të këndohet heksametri i parë nga «ligjë-rata» VII:

Salve casta Sion. nermultaque passa Puella

— — | — — | — V V | — V V | — V V | — V

Në fakt, nuk është kënduar vetëm kjo poezi (shqip dhe latinisht) në frymën dhe në lidhjen përmbajtësore me tërësinë e veprës së autorit tonë, i cili subjektin e interesimeve të veta e shtjellon krvesisht mbi bazë të këtvre emërtimeve (të kësaj poezie): Hvi, Sioni, Krishti, apostujt, Vajza (shën Maria), ievrejtë, kungimi, Pashtriku.

Sipas të gjitha shkasave edhe poezia më e gjatë «të kësaj Sibile (janë) ata viersh greqisht të paratë lettera tërthuer mbanë këto fjalë: Jesus Christus filius Dei servatore»⁵³ është origjinale e P. Bogdanit në të dy versionet, të cilat ia im-

51) Sa për ilustrim, po citojmë një strofë tetëshe të T. Tasos:

Vuol ne l'armi provarla un nom l'istima,

degno accui sua vertu si paragone.

Va girando colei l'alpestre cima

verso altra porta, ove d'entrar dispone.

Segue egli impetuoso: onde, assai prima

che giunga, inguisa, avien che d'armi suone.

ch'ella si volgie, e grida: O tu, che porte

che corre. si? — Risponde — E guerra o morte.

Cituar sipas: *Anthologia italiana con epica ed avviamento all'educazione linguistica*, II. Napoli, 1980, f. 785).

52) T'falem Sion i shenjtë, ti vajzë e vuajtur pa masë.

53) I, IV, 6, 2.

ponon përcaktimi i vargut anësor. Këtë akrobaci poetike, në të cilën secila shkronjë e kësaj fjale i shërben për të filluar një varg të ri (29 vargje) duhet kuptuar si një «program» metrik për një anagram (të gjatë), vërtet jo të zakonshëm, disi, siç kishte vepruar P. Ritter, në poezinë e tij përshëndetëse në fillim të librit (pa numër faqesh)⁵⁴. Tashiti shtrohet pyetja a ka kënduar P. Bogdani vargje heksametrike vetëm në gjuhën latine apo edhe në gjuhën shqipe. Krahasimi është i mundshëm me këto vargje të tij në gjuhën shqipe, të cilat fort bukur skandohen në heksametrin solemn:

Mpson Historia, godijtë: qish besson Allegorjtë
Vepron Trapologia se shperen Anagogia⁵⁵

Në «Çetën e profetëve» mund të konstatohen edhe vargje të tjera heksametrike⁵⁶ dhe se edhe në këtë pikë shfaqet karakteri novator në letërsinë shqiptare dhe kontributi i P. Bogdanit në zbatimin me sukses të vargëzimit klasik, përkatësisht të vargut më të përhapur në letërsinë antike greke-romake (Homeri, Virgjili). Tri vargjet e Marcialit të përkthyer nga P. Bogdani, më sa dihet, janë heksametrat e parë në gjuhën shqipe. Ja si e kemi skanduar heksametrin e parë të vargjeve të Marcialit:

54) Programma:

Patrus Bogdanus Archiepiscopus Scopiensis
Anagramma.

Hic puros, ad pingves botros suscipiens, pasce.

Hic, ubi producit Pingues tua vinea botros:

Plena ubi vatidico stillat et uva mero;

Puros pasce greges, o felix incola: verum

Qui secolunt pura mento; animoq; Deum.

His vivifica, donec de vite propines

Ambrosium aetherei nectar in axe poli

(Paulus Ritter)

55) Përkthimi bëhet nga vargjet latine: Littera Gesta docet: quod credis, Allegoria / Moralis quid agit: quo tendis Anagogia. (I, II, 1, 8).

56) Krh. I, I, 4, 37.

As donji begati ke me shpum nde ujet e Ferrit⁵⁷

— V V | — — | — V V | — — | — V V | — V

Ndoshta pikërisht në këtë pikë shfaqet origjinaliteti më i madh në krijimtarinë poetike të P. Bogdanit si dhe vetëdija e lartë letrare. Përsosmëria e këtij vargu heksametrik qëndron në organizimin e atyre rrokjeve të gjata e të shkurtëra për të krijuar renditjen më të preferuar të daktilave dhe të spondeve (daktil, sponde, daktil, sponde, daktil, troke), të numrit të barabartë të tyre.

Pikënisja e mesazhit poetik në këto poezitë e sibilave është shumë reale, në njërën anë, e mbështetur në klasikët e mëdhenj siç është Virgjili dhe T. Akvini, dhe, në anën tjetër, në identifikimin etnikonomik të sibilave me trevat shqiptare (dhe serbe)⁵⁸ në një topografi: *Hasnjana (Sibilla Delfica)*, Prizrenasja, Shkodranja, Shkupjanja etj. Hasnjana madje edhe e mban librin në dorë, në të cilin shkruan (shqip):

Kendonj Birr' e madh mbi Qiellt të Lumit Atë.

Në këtë mënyrë ky poet i frymëzuar ka arritur që para botës së huaj (të qytetëruar) të paraqesë gjërat më pak të njohura të vendit të tij lërthorazi sibilave magjepëse, të skalitura mirë dhe të formësuara pothuajse në të gjitha artet e lira. Pikërisht në këtë pikë është realizuar me sukses ai parimi *notum in novum* (e njohura në të renë) dhe *proprie dicere* (shprehje e posaçme)⁵⁹, të cilin ngrohtësisht e preferon Horaci. Ky koncept i P. Bogdanit arrihet pra jo vetëm

57) II, I, 6, 17. Dy heksametrat e tjerë janë:

Po duoshiune ke me kjanë hjekun mbe lundre

Dobitessi, me të dobjtunit ende kanë meu përziem ndë Terr;
të përkthyer nga vargjet latine:

Neque vllas portabis apas Acherontis ad undas

Nudus ad infernas stulte vehere rates

Victor oum victo pariter mscebitur umbris.

58) Në një letër të tij dërguar nga Padova më 16 nëntor 1685, P. Bogdani shkruan: «Le sibile ho voluto forle far vestite alla albana e serviana per dare in humore povera gente e consolare al meglio che ho potuto» (Sibilat kam dashur t'i punoj të veshura sipas veshjes shqiptare dhe serbe për t'ia dhënë një ngjyrë atij populli të varfër dhe për ta ngushëlluar aq sa kam mundur (Cituar italisht sipas: Radonić, *Rimska kurija*, 389).

59) Horatius, *Ad Pisones*, 128.

në planin e qëndresës etnogjuhësore dhe kulturore, por edhe në shkallën e lartë të realizimeve artistiko-letrare. Prandaj, edhe vajza *Mri*, që është «e bukura më fortë se zanë», është evokim në funksion të bukurisë së traditës shqiptare dhe njëherësh panevropiane, Figurat stilistike «diell» dhe «hanë» që i vishen *Mrisë*, të kujtojnë bukurinë e shpirtit, të përmbushur me elementet e natyrës ato të kujtojnë pastërtinë e trupit dhe të shpirtit. Elementi «zanë», i mishëruar me sakrificën filantropike të Krishtit, shpëtimtarit të njerëzimit, sublimohet në bukurinë e harmonishme të artit helen, që bashkonte virtytet njerëzore të trupit dhe të shpirtit. Prandaj, tematika universale e poezive të P. Bogdanit ka një vlerë të madhe ideore dhe artistike, që modelojnë ndjenjat e personazheve përmes strofave tetëshe me një kadencë muzikale, të transmetuar me një sugjestion shqetësues në shpirtin e lexuesit ose të dëgjuesit.

Me një fjalë, filozofia e këtyre vargjeve poetike të njëmbëdhjetë këngëve të sibilave, me figuracione të shumta dhe të ngjeshura, pothuajse me të gjitha mjetet artistiko-letrare, kanë një vlerë të qëndrueshme në gjithë poezinë shqiptare dhe, pa dyshim, janë krijime me vlerë antologjike⁶⁰.

R é s u m é

LES POESIES ORIGINALES ET TRADUITSS DE PJETER BOGDANI

Dans l'article du prof. Engjëll Sedaj portant le titre susmentionné, on analyse un aspect peu connu de l'oeuvre de cet auteur; sa créativité poétique.

Le chercheur s'arrête d'abord au problème de la paternité des vers cointenu dans l'oeuvre «Çeta e Profetëve» en s'assumant la tâche de préciser quels parmi les vers anonymes qui s'offrent à nous peuvent être attribués à Bogdani et quels autres peuvent être considérés comme tradiuts.

E. Sedaj est d'avis que la poésie dédiée à A. Zmajeviç, compo-

60) Krh. Ismail Belaj, *Krijime me vlerë antologjike*, te: «Rilindja», dt. 8.IV.1981, f. 14-15.

sée de 24 vers de 8 syllabes écrite en quatrains, appartient à Bogdani

L'auteur pense que beaucoup de vers latins (et italiens) chantés en l'honneur des sybilles, peuvent être considérés comme originaux de Bogdani.

L'auteur apprécie la richesse des figures de la poésie de Bogdani, la volubilité du vers et surtout l'exploitation de l'expérience de la poésie populaire, un trait que l'auteur de l'article considère comme une expression de nouveauté qui se manifeste, non seulement par des formes, vers et des strophes, mais aussi par des phraséologies et des rythmes aussi. Il affirme que P. Bogdani est un créateur même dans son travail de traducteur.

E. Sedaj aboutit à la conclusion que les poésies originales de Bogdani sont riches en idées et en valeurs artistiques qui assurent à leur auteur une place honorable dans toute la poésie albanaise. Ces créations, d'après, l'auteur, ont une valeur antologique,

SEIT MANSAKU

**VEPRA E PJETËR BOGDANIT SI BURIM PËR HISTORINË
E GJUHËS SHQIPE**

Vepra e Pjetër Bogdanit është pjellë dhe vijim i mëtejshëm i asaj tradite kulturore dhe asaj lëvizjeje mendore humaniste që kishte nisur që më parë, dhe që u shfaq sidomos në shekujt XVI-XVII jo si një dukuri e rastësishme, por si pasojë e kushteve të caktuara historike, shoqërore e kulturore të kohës në rrafshin kombëtar dhe evropian.

Nga pikëpamja e historisë së gjuhës shqipe, e periodizimit të saj, qoftë mbi kritere gjuhësore, qoftë mbi kritere historiko-gjuhësore, tekstet e vjetra shqipe, letërsia e vjetër shqiptare do të shënojnë gjithmonë hapjen e një epoke të re me rëndësi të jashtëzakonshme për gjuhën dhe kulturën tonë.

Me veprat e letërsisë së vjetër shqiptare hapet epoka e gjuhës letrare shqipe. Gjuha shqipe rradhitet tashmë krahas gjuhëve të tjera të Evropës me një letërsi të shkruar, duke u zbutur në një farë mënyre ajo situatë paradoksale e kontradiktore, e krijuar nga fakti që gjuha shqipe, një nga gjuhët më të lashta të Evropës, përfaqësuese e vetme e një qytetërimi origjinal, krejtësisht brenda sferës së kulturave

të mëdha të botës antike, kulturës greke dhe romake, kishte mbetur deri në shekullin XV një gjuhë vetëm e folur, ende e padokumentuar me shkrim ashtu si edhe ndonjë gjuhë tjetër e vjetër e Ballkanit, siç ishte rumanishtja, e dëshmuar arersisht në të njejten kohë. Por nga ana tjetër, është po kaq interesant fakti që gjuha shqipe, mrekullisht, edhe ashtu e pashkruar me sa dihet, deri në shek. XV, mundi t'i snpëtojë forcës asimiluese të perandorive më të mëdha që ka njohur njerëzimi.

Këto dy dukuri në dukje kontradiktore, besoj, jo pa lidhje njëra me tjetrën, presin një shpjegim edhe më bindës, edhe më të thelluar nga shkencat tona historike-filologjike. Me sa duket, ky ishte fati i një gjuhe të një populli të lashtë e të vogël me troje të rrudhura nga historia, e cila u ruajt dhe u zhvillua me shumë vështirësi nën peshën e rëndë të sundimeve të perandorive të fuqishme.

Në rrafshin e marrëdhënieve me gjuhët e tjera, shkrimet e para shqipe shënojnë fillimin e periudhës disashekullore të kontakteve intensive të shqipes me turqishten në të cilën ajo dha provën e fundit të qëndrueshmërisë së saj ndaj presionit asimilues të një perandorie të fuqishme, siç ishte perandoria osmane. Por tashmë në ndryshim nga etapat e mëparshme parashkrimore të saj, gjuha shqipe qëndronte përballë turqishtes jo vetëm si gjuhë e folur, por edhe si gjuhë e shkruar. Veprat e letërsisë së vjetër, që tregojnë në një farë mase shkallën e depërtimit të turqiz-mave në shekujt XVI-XVII, japin mundësi për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe. Vepra e P. Bogdanit «Çeta e profetëve», duke qenë e fundit të shekullit XVII (1685) përmban më shumë fjalë të burimit turk sesa veprat e shkrimtarëve të tjerë para tij. Kështu te kjo vepër gjejmë fjalë të tilla të sferave të ndryshme si: *amanet, bahçe, bajrak, begenis, bojë, bori, bylezik, çohë, çardak, çelevi, daulle, dervish, elçi, gjemi, hajn, hatër, haraç, hesap, hoxhë, kurban, mahanë* «shkak i kotë», *mehqeme* «gjyq», *mejdan, myhyr, myfti, pashallarë, qehaja, sanxhak, saraj, sejmen, synet, vergji, veqil, vezir, xhelat* etj. Një pjesë e këtyre fjalëve nuk gjenden te paraardhësit, gjë që tregon se ndikimi turk në gjuhë sa vinte e shtohet, dhe kjo është e kuptueshme¹.

1) Shih edhe E. Çabej, *Studime gjuhësore* III, Prishtinë, 1976, f. 68.

Tekstet e letërsisë së vjetër shqiptare janë relativisht të vona, por të begata. Kështu që mosnjohja e një tradite më të hershme (dëshmia e vonë), plotësohet në një farë mënyre me pasurinë e materialit që këto sjellin. Vëllimi i gjerë i tyre lejon të ndërtohet në mënyrë pothuajse të plotë sistemi fonetik e gramatikor i gjuhës shqipe në shekujt XVI-XVIII dhe të dalë në dritë një pasuri relativisht e gjerë e leksikut të saj. Nga ana tjetër, që nga libri i parë shqip «Meshari» i Gjon Buzukut deri në filimet e Rilindjes Kombëtare në shek. XIX kemi një vazhdimësi të pandërprerë të shkrimit të shqipes, me një farë rënie në shek. XVIII, çka lejon të ndiqet mirë evolucioni i sistemit fonetik e gramatikor të saj që nga fillimet e shkrimit deri në ditët tona. Mund të themi se vetëm me zbulimin dhe njohjen e teksteve të vjetra, krahas njohjes së dialekteve dhe të folmeve të shqipes në të gjitha trojet e saj, duke përfshirë edhe diasporën, u krijuan premiset e domosdoshme për studimin me metodat e gjuhësisë shkencore të historisë së brendshme të gjuhës shqipe, sidomos për periudhën e saj të dokumentuar. Por letërsia e vjetër shqiptare për qëllimet e historisë së gjuhës mund të vështrohet jo vetëm si një pikënisje e sigurt për të ndjekur evolucionet e brendshme të dukurive të ndryshme gjuhësore që nga shekulli XVI deri në ditët tona, por edhe si pikëmbërritje e fazave më të hershme, si një bazë e njohur për t'u ngjitur e depërtuar në fazat më të hershme më pak të ndriçuara të gjuhës. Në këtë mënyrë edhe ajo që konvencionalisht quhet histori e jashtme e shqipes, mbështetet në të dhëna shkencore më të sigurt, krahasimet me gjuhë të tjera indoevropiane bëhen më të afërta në kohë, prandaj edhe më bindëse dhe më të drejta nga ana e metodologjisë shkencore.

Është pikërisht mosnjohja e teksteve të letërsisë së vjetër dhe e dialekteve një nga të metat që i ka çuar mjaft albanologë të njohur në vlerësime të pasakta për përbërjen e leksikut të gjuhës shqipe. Kjo ka qenë një nga dobësitë edhe e një vepre themelore albanologjike të fundit të shekullit XIX, siç është «Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe» i Gustav Majerit.

Për të përmbyllur këto vlerësime të përgjithshme për tekstet e letërsisë së vjetër shqiptare do të thoja se rëndësia e tyre për historinë e gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi është e pazëvendësueshme. Po kështu edhe kontributi i autorëve të tyre. Ata qenë jo

vetëm shkrimtarë e përkthyes me kulturë të gjërë, por mund të themi edhe gjuhëtarë me njohuri të thella. Këtu nuk është fjala vetëm për Frang Bardhin, i cili hartoi një vepër të mirëfilltë gjuhësore, por edhe për autorët e tjerë që shndërruan të parët gjuhën e folur shqipe në një gjuhë të shkruar, materien tingullore, dëgjimore në vepër të shkruar të lexueshme, punë shumë e vështirë që kërkon kulturë të gjerë gjuhësore, njohje të thellë të gjuhës amtare, të strukturës së saj dhe vetëdije gjuhësore të lartë etj. Në një farë mase puna e atyre dijetarëve që kanë shkruar për herë të parë një gjuhë mund të krahasohet me punën e atyre që zbuluan shkrimin fonetik për të cilët gjuhëtari i shquar francez Antuan Meje shkruan: «Njerëzit që zbuluan dhe perfeksionuan shkrimin kanë qenë gjuhëtarë të mëdhenj dhe janë pikërisht ata që krijuan shkencën gjuhësore»².

Duke pasur parasysh rolin e madh që kanë luajtur këta shkrimtarë për historinë e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare dhe kohën kur shkruan ata, në mugëtitirën mesjetare, përmbajtja kryesisht fetare e veprave të tyre, nuk duhet të çojë peshë aspak në vlerësimin e punës dhe personalitetit të tyre, aq më tepër kur dihet se fillimet e shkrimit të shumicës së gjuhëve evropiane kanë nisur me përkthime tekstesh biblike. Në këtë vështrim edhe pyetja që bëhet shpesh herë a shkruan këta shkrimtarë për t'i ardhur në ndihmë dheut të Arbënit, popullit dhe gjuhës së tij apo për qëllime fetare, për të mbrojtur krishtërimin, përveçse për arsye studimore, nuk ka kuptim të shtrohet kur është fjala për vlerësimin e figurës së tyre. Kjo aq më tepër për kohën e tyre, kur ideja e atdheut dhe e fesë ishin të pandara dhe kur lufta për të mbrojtur krishtërimin kundër islamizimit ishte e lidhur me luftën kundër pushtuesve osmanë.

Rëndësia e veprës së P. Bogdanit si burim për historinë e gjuhës shqipe zbulohet duke e parë atë në kontekstin e veprave të tjera të letërsisë së vjetër shqiptare, duke e krahasuar me veprat e paraardhësve dhe të pasardhësve të tij. «Meshari» i Gjon Buzukut ruan përparësinë e monumentit të parë të shqipes së shkruar, kurse vepra e P. Bogdanit ka përparësinë e veprës së parë origjinale në gjuhën shqipe dhe të veprës me të cilën u arrit shkalla më e lartë e për-

2) Cituar sipas Georges Mounin, *Histoire de la linguistique des origines au XX^e siècle*, Paris, 1970, p. 40.

punimit gjuhësor dhe letrar në të gjithë letërsinë e vjetër shqiptare, duke e kapërcyer edhe shekullin XVIII.

Karakteri origjinal i veprës i bën më autentike dëshmitë gjuhësore të P. Bogdanit, sidomos ato që lidhen me strukturën morfologjike dhe sintaksore të gjuhës, sepse mundësitë e ndikimit nga strukturat e gjuhëve të tjera janë më të pakëta sesa në përkthimet e mirëfillta, siç ishin kryesisht veprat e paraardhësve.

Së dyti, edhe larmia tematike e veprës, përmbajtja e gjerë e saj teologjike, filozofike, historike e shkencore ka sjellë si pasojë që të dalë në dritë një pasuri e madhe leksikore, formash gramatikore e sidomos ndërtimesh sintaksore, duke nxjerrë në pah fjalë e shprehje, forma e ndërtime që nuk takohen te veprat e mëparshme ose duke dëshmuar me më shumë fakte e shembuj dukuri gjuhësore të dëshmuara edhe më parë. Për nga pasuria leksikore, sa për ilustrim mjafton të përmendim se ndërsa te «Meshari» i Gjon Buzukut me shkronjën -s, ka 107 fjalë, te «Çeta e profetëve» e Bogdanit ka 176 fjalë me këtë shkronjë³.

Së treti, me veprën e Bogdanit baza dialektikore e njohjes së gegërishtes zgjerohet me grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore me dukuri fonetike sidomos, por edhe gramatikore me shumë interes për dialektologjinë historike, por edhe për historinë e gjuhës shqipe në përgjithësi. Kështu pas veprës së Buzukut që ka si bazë dialektore gegërishten veriperëndimore dhe pas veprave të Pjetër Budit, që nga ana dialektore përfaqëson gegërishten qendrore, me veprën e P. Bogdanit vjen e plotësohet kuadri i të folmeve të gegërishtes në shekujt XVI-XVII. Kështu që vepra e P. Bogdanit nuk ishte vetëm një vepër më shumë në letërsinë e vjetër shqiptare, por edhe një dëshmi më shumë për një zonë të gjerë gjuhësore të truallit të shqipes me interes të veçantë për studimet historike e dialektologjike të shqipes.

Së katërti, duke parë veprën e P. Bogdanit nga raporti midis bazës së saj dialektore dhe shkallës së përpunimit të gjuhës së saj sipas një koineje gege, mund të nxirren disa

3) Kjo statistikë mbështetet në punën e lavdërueshme që ka bërë studiuesi Kolë Ashta për nxjerrjen dhe shpjegimin e leksikut të autorëve të vjetër botuar në disa numra të revistës «Buletin Shkencor» të Institutit të Lartë pedagogjik të Shkodrës.

përfundime me interes për prirjet e zhvillimit të gegërishtes veriore në shekullin XVII.

E vështruar në krahasim me veprat e autorëve të mëparshëm, sidomos me librin e parë shqip, «Meshari» i Gjon Buzukut, vepra e P. Bogdanit jep mundësi të zbulohen zhvillimet që ka pësuar gjuha shqipe nga mesi i shekullit XVI deri në fund të shek. XVII. Por në këtë mes duhet pasur parasysh se ndryshimet midis gjuhës së Buzukut dhe gjuhës së Bogdanit nuk janë vetëm ndryshime në kohë, të kryera në periudhën rreth 130 vjeçare që i ndan këta autorë, por edhe ndryshime në hapësirë, ndryshime dialektgjeografike midis të folmeve mbi të cilat mbështetet gjuha e këtyre autorëve. Në mjaft raste është vështirë të dallohen këto dy tipe ndryshimesh, sepse mund të jenë rezultat i të dy faktorëve: kohës dhe hapësirës që i ndan. Sidoqoftë krahasimi i këtyre teksteve është i domosdoshëm, sepse me anë të tij mund të vërejmë se disa dukuri që te Buzuku paraqiten *in statu nascendi*, te Bogdani janë tashmë konsoliduar, nga ana tjetër, disa dukuri arkaike të dëshmuara më gjerësisht te Buzuku, te Bogdani shkojnë drejt zhdukjes. Të gjitha këto tregojnë prirjet e zhvillimit historik të shqipes në një periudhë të caktuar.

Kështu p.sh. te «Meshari» i Gjon Buzukut dhe te veprat e Budit ruhet ende togu i vjetër zanor *uo: kujtuom, shk uom, muor* etj., kurse te Bogdani, para tij edhe te Bardhi, kemi sistematikisht togun *ue: ndimuem, shumuem, ndër ruem* etj. Megjithatë te Kuvendi i Arbënit, i fillimit të shek. XVIII. d.m.th. pas veprës së Bogdanit, mbizotëron togu *ue*, por dalin edhe raste me *uo*, si: *muoj, huoj, ruoj tun* etj., gjë që tregon se zhvillimi *uo:ue* nuk u krye në të njëjtën kohë në të gjitha të folmet e gegërishtes. Te kuvendi i Arbënit. me sa duket. mund të ketë ndikuar gjuha e P. Budit prej Guri të Bardhë, i cili në veprën e tij ruan togun *uo*⁴.

Nga sistemi gramatikor ka gjithashtu mjaft forma që duket se u zhvilluan dhe u konsoliduan nga Buzuku te Bogdani. Kështu, p.sh., forma e paskajores së tipit *nër të nunuar* te libri i parë shqip paraqitet në formim e sipër. Për disa raste është vështirë të thuhet nëse kemi të bëjmë me një tog të lirë sintaksor të përbërë nga parafjala *nër* + emër asnjane apo me një formë foljore. Kurse në veprën e Bog-

4) Shih për këtë edhe R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit*, Prishtinë, 1985, f. 109.

danit kjo formë foljore paraqitet e përfunduar, e përftuar nga gramatikalizimi i togut përkatës. Këtë e provon, ndër të tjera, edhe fakti te ky autor takohet për herë të parë kundërvënia diatezore: *për të dëgjuar*; *për t'u dëgjuar*. P.sh. Tash pra jet *për t'u shqyrëtuem* si anshtë «Hora resta da vedersi come e». (Bogdani I. 5/19); ... nuk ka me çelë gojën *për t'u nënkuem* (Bogdani II, 34/5).

Po kështu në veprën e P. Bogdanit del për herë të parë forma e së ardhmes së tipit *kam për të mësuar*. P.sh. Të parën herë *ka për të ardhunë* i përvutë e i butë përse *ka për t'ardhunë* me çpërblem shekullinë (Bogdani II, 34/5).

Edhe forma foljore e habitores, e cila del që në librin e Buzukut, në veorën e Bogdanit ndeshet më dendur se në veprat e mëparshme dhe paraqitet e kristalizuar mirë si nga ndërtimi ashtu edhe nga kuptimi modal kohor.

Nga ana tjetër, në veprën e P. Bogdanit ka edhe dukuri morfologjike arkaike si elemente mbeturinore të një faze më të hershme që shkojnë drejt zhdukjes. siç është p.sh. dukuria e biflektivizmit në togfjalëshat e tipit emër + mbiemër i nyjshëm ose pronor. P.sh. *dëshirevet mirave, bjeshkëshit së naltash, vëllaznet tuve, malësorëvet tinëve, mpkatevet tonavet, ështënashit së miash duarshit sonash*⁵ etj.

Një dukuri e tillë ndihmon për të ndriçuar çështjet e përshtatjes së përcaktorëve me emrat përkatës në një fazë të hershme të shqipes si edhe çështjen e përfittimit të klasës së mbiemrave të nyjshëm. Ndoshta në një fazë të hershme parashkrimore të shqipes mbiemri merrte edhe mbaresat rasore të emrit, ashtu sic ndodhte. p.sh., në gjuhët klasike në greqishten e vietër dhe në latinishten. Përfittimi i nyjes së paravendosur te mbiemrat dhe lakimi i saj i bëri të panevojshme mbaresat rasore.

Disa veçori fonetike dhe gramatikore të Bogdanit të ndrvshme nga Buzuku, lidhen me komponenten dialektore të gjuhës së tyre. Të tilla janë ndër të tjera prania në disa raste e grykoreve të thjeshta *k. a.* si zhvillim i grupeve të hershme *kl, gl,* që dalin te Buzuku. përdorimi i formave *të del, të merr* për *të dalë, të marrë,* etj., përdorimi *mia^{ft}* i shpeshtë i vetës së tretë njëjës të së pakryerës me mbaresën *-ke kthueke, merrke* etj.

Përsa i përket sistemit grafik, P. Bogdani ndoci traditën

5) Shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 557.

e çelur nga autorët e mëparshëm të mbështetur në alfabetin latin me disa gërma cirilike dhe me ndonjë gërmë të veçantë jolatine. Bogdani pohon vetë në faqen XXII të vepërës së tij se në gjuhën shqipe përdoren shkronjat latine me përjashtim të katër prej tyre. Gjejmë kështu të njëjtin pohim që bën rreth 350 vjet më parë më 1332 Guillelmus Adae, i cili thotë se shqiptarët përdorin në librat e tyre shkronjat latine. Kjo traditë e shkrimit të shqipes me shkronja latine, e konsoliduar që në tekstet e vjetra, përcaktoi ndoshta rrugën e mëtejshme të alfabetit të shqipes që u caktua përfundimisht më 1908 në Kongresin e Manastirit. Nga ana tjetër, krijimi i një tradite të shkrimit të shqipes që në fillimet e tij, tregon në një farë mënyre se ndërhyrja e pushtimit të gjatë sllav nuk kishte mundur të ndërpriste lidhjet e gjata shumëshekullore të kulturës ilire e arbërore me botën romane për të krijuar një traditë të re me orientim sllav. Ky arsyetim, i shikuar edhe në lidhje me faktin se terminologjia kishtare në gjuhën shqipe, ashtu siç del edhe në veprën e Bogdanit dhe në tekstet e tjera të vjetra, është e burimit latin, nuk është pa peshë për problemin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e sotme. Kjo gjithashtu e bën të paqëndrueshme tezën e formuluar nga ndonjë studiues sipas së cilës përpara hyrjes së alfabetit latin që u bë nën ndikimin e kishës katolike, në Shqipërinë Veriore ka qenë përdorur alfabeti cirilik⁶.

Alfabetit të përdorur nga shkrimtarët e tjerë para tij Bogdani i bëri disa plotësime e përmirësime që synonin në mënjanimin e përdorimit të mëse një shkronje për të shënuar një tingull ose të përdorimit të një shkronje për të shënuar më se një tingull. Kështu disa nga risitë që i solli Bogdani sistemit grafik të autorëve të mëparshëm janë shënimi i hundorësisë së zanoreve, duke shtuar pas tyre tingullin *n* si p.sh. *anshtë*, *pensë*, *manzë* etj., dallimi grafiksht i tingullit *ë* nga tingulli *e*, duke shënuar një theks mbi të, dallimi i l-së nga ll-ja, duke e shënuar këtë të fundit me λ greke, përdorimi i apostrofit për të shënuar elidimin e zanoreve etj.⁷

6) E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut* (1565), botim kritik, pjesa e parë, f. 60.

7) Shih dhe Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, krestomati thjeshtë gjuhësore, Tiranë, 1961, f. LX.

Duke e plotësuar dhe përmirësuar sistemin grafik të autorëve të mëparshëm, Bogdani e bëri atë më të përshtatshëm për të dhënë sistemin fonematik të gegërishtes së kohës së tij. E thënë me fjalë të tjera, sistemi grafik i Bogdanit jep më shumë mundësi për të ndërtuar sistemin fonematik të gegërishtes veriore të shekullit XVII. Ai ndihmon gjithashtu për të saktësuar interpretimin e disa grafive të dyshimta të autorëve të mëparshëm.

Shënimi rregullisht i hundorësisë së zanoreve jep një bazë shkencore të sigurtë për ta studiuar historikisht këtë dukuri të rëndësishme të fonetikës së gjuhës shqipe. Përveç kësaj shënimi i hundorësisë me anë të bashkëtingëllores *n* i bëri më të qarta, më të kapshme interpretimet etimologjike historike të mjaft fjalëve. P.sh. grafia me *n* *pensë* e numërorit *pesë* e bëri më të afërt krahasimin në planin indoevropian të kësaj fjale me gr. πέντε, lat. *quinque*, sankr. *pañca* etj. ku tingulli *n* është i pranishëm. Po kështu forma me *n* *manz* e shqipes së sotme mëz geg. *maz* e bën më bindës afrimin e kësaj fjale me mesapishten e Salentinëve *Jupiter Menzana* (*Menzana*, sipas shkrimtarit latin Festus, ishte hyjnia së cilës i flijonin kuaj). Për të dhënë edhe një shembull tjetër, grafia *ren* e Bogdanit për fjalën *re* ka nxitur imagjinatën shkencore të studiuesve për ta lidhur këtë fjalë me një glosë greke *rhinos* «ῥῖνος» me kuptimin «errësirë» nga gjuha e Enotrëve në Itali, të cilët mbahen si të burimit ilir. Ky afrim bëhet i besueshëm po të kemi parasysh se prof. E. Çabej⁸ fjalën *re* e lidh brenda shqipes me *errët* që i përgjigjet kuptimisht plotësisht glosës *rhinos* ῥῖνος. Në këtë mënyrë shtohet një argument në të mirë të burimit ilir të gjuhës shqipe.

Për historinë e gjuhës shqipe sidomos për studimet etimologjike të saj ka rëndësi të veçantë leksiku i veprës së P. Bogdanit. Vepra e Bogdanit njihet në kohën e hartimit të Fjalorit etimologjik të shqipes nga G. Majeri (1891). Autori e jep në bibliografinë e veprës bashkë me Fjalorin e Bardhit, por, me sa duket nga trajtimi etimologjik i fjalëve, nuk është shfrytëzuar prej tij. Vepra e Bogdanit u shfrytëzua gjerësisht në studimet etimologjike të prof. E. Çabejt. Kjo vepër origjinale me përmbajtje të larmishme, që trajton edhe aspekte të botës shqiptare, të historisë së saj, nxjerr në pah një pasuri të madhe të leksikut të shqipes me interes

8) E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, f. 27.

të veçantë edhe për studime etimologjike. Aty dëshmohej për herë të parë mjaft fjalë të visarit autokton të shqipes si: *bigë*, *bjeshkë*, *bindunë*, *bashkë* «bashkë leshi», *bletë*, krahas fjalës *mjaltë*, *mjalcezë* me të cilat ka konkuruar e para gjersa u bë mbizotëruese dhe fitoi etj. Ka pastaj shumë fjalë të tjera me kuptime e forma të veçanta, që kanë dhënë shkas për zgjidhje etimologjike të reja, pa përmendur këtu neologjizmat e shumtë që krijoi vetë autori dhe që kanë zënë vend nëpër fjalorë të shqipes.

Vepra e Bogdanit ka rëndësi edhe për dialektologjinë historike. Edhe pse gjuha e saj është e përpunuar si një koine geqe, prapëseprapë ka mjaft elemente të gegërishtes verilindore që mund të shërbejnë si bazë për krahasime me gjendjen e sotme të kësaj të folmeje për të ndjekur evolucionin e saj historik.

Proza e përpunuar e veprës së Bogdanit, me periudha të gjata, por të ndërtuara drejt, me lidhje sintaksore e logjike të brendshme që e paraqesin mendimin sa më të qartë, me një larmi mjetesh shprehëse ku bashkëjetojnë ndërtime të sintaksës popullore e dialektore me ato të një sintakse të përpunuar letrare, të gjitha këto e bëjnë veprën e P. Bogdanit një burim të rëndësishëm edhe për sintaksën historike të gjuhës shqipe.

Së fundi, nuk mund të lihet pa përmendur vlera e kësaj vepre si burim studimor edhe për onomastikën historike. Duke qenë se në veprën e Bogdanit trajtohen edhe aspekte nga bota dhe historia shqiptare, përmenden aty edhe mjaft emra vendesh në formën mesjetare të kohës, që japin mundësi për shpjegime e interpretime gjuhësore me rëndësi për historinë e gjuhës. Sa për ilustrim po përmendim se emri i qytetit të Raguzës të Dalmacisë në veprën e Bogdanit del në formën *Rushë*: *ndë fisnikshet qytetë Rushësë*, it. *nella nobilissima Citta di Ragusa* (Bogdani II. 20/6), duke na dhënë kështu barazimin *Ragusa-Rushë*. një zhvillim në përputhje të plotë me rregullat e fonetikës historike të shqipes, me zhdukjen e rregullt të *g*-së ndërzanore, me errësimin dhe pastaj me rënien e *a*-së së patheksuar dhe me shndërrimin e hershëm *s* : *sh* të shqipes. Etimologjikisht pra emri *Raguzë* lidhet me fjalën *rrush* e cila, siç e ka shpjeguar E. Çabej⁹, është refleks i një baze të vjetër **ragus* e afërt me gr. $\rho\alpha\tilde{\epsilon}$,

9) E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, f. 102.

παρύος «kokërr rrushi». Kështu që Raguzë s'është gjë tjetër veçse një emër vendi nga një emër botanik, sikurse *Dardania*, *Fishta*, *Driza*, *Shkozet*, *Qerret*, *Mullet* etj., një mënyrë emërtimi e zakonshme për viset shqiptare.

Gjithashtu emri i lumit të *Bunës* në veprën e Bogdanit del në formën *Buenë*. *Drini e Buena kur dalënë jashtë brigjeshit së tyne* (II, 12/5) dhe ... *m'Urë të Buenësë* (II, 40/12), duke u dhënë kështu studiuesve një çelës për ta lidhur dhe për ta shpjeguar emrin e këtij lumi brenda shqipes me apelativin *buenë* «vërshim ujrash»¹⁰. Në veprën e Bogdanit dalin edhe mjaft emra të tjerë gjeografikë si *Shkupja*, *Preserend*, *Peshtrik*, *Dukagjin*, *Durrëci* etj. si dhe antroponime e etnonime që janë me interes për historinë e gjuhës, por që kërkojnë një shtjellim më vete.

Përsa i përket emrit të vendit, të popullit tonë dhe të gjuhës shqipe, Bogdani ashtu si paraardhësit e tij, përdor fjalën *Arbën* për vendin, *i arbëneshi*, *t'arbëneshëtë* për popullin dhe *gjuhë e arbëneshë* për gjuhën. Si ndajfolje krahas *arbënisht* përdor një herë fjalën *shqip* në parathënje të veprës, duke bërë fjalë për një gramatikë *fort të godiçme latin e shqip* të Andrea Bogdanit; Fjala *shqip* si ndajfolje del edhe një herë tjetër në një vjershë të Lukë Bogdanit kush-tuar Pjetër Bogdanit, botuar në veprën «Çeta e profetëve» «*shqip*, latin e taljani».¹¹

Në veprën e Bogdanit del për herë të parë dhe një herë të vetme me sa dimë ne, *fjala arbënorëtë për të arbëneshëtë: Arbënorëtë janë trima të fortë e fort të durueshëm*. Emri *shqiptar* ende nuk shfaqet te Bogdani, megjithëse formimet me prapashtesën *-tar* janë të shpeshta te ky autor si: *gjuhëtar* «gojëtar», *këshilltar*, *landëtar*, «zdrukthtar», *fjalëtar*, *lodërtar* etj. Nuk kalojnë veçese 20 vjet dhe emri *shqiptar* del te Kuvendi i Arbënit: ... *a dijnë mirë gjuhën e shqiptarëvet* (105). Është vështirë të thuhet a njihet ky emër i ri në kohën e Bogdanit apo ky autor parapëlqeu emrin *të arbëneshëtë* sipas traditës së mëparshme dhe krijoi vetë edhe fjalën *arbënorë* nga *arbën* me prapashtesën *-or*.

Vepra dhe jeta e P. Bogdanit, për dashurinë për dheun

10) E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* II, Tiranë, 1976, f. 346.

11) Shih dhe Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 214.

e Arbënit dhe për gjuhën e arbëneshë, për zellin që tregoi dhe përpjekjet që bëri në kushtet e rënda të pushtimit osman e të obskurantizmit mesjetar për të shkruar dhe përpunuar gjuhën amtare, për ta bërë atë një mjet të denjë edukimi, dijeje, përparimi dhe afirmimi kombëtar, nuk është për ne vetëm një burim studimi, por edhe një burim i fuqishëm frymëzimi për një punë të mëtejshme për të nxjerrë në dritë edhe më mirë vlerat e shumta të veprave të letërsisë së vjetër shqiptare.

Një detyrë e ngutshme për filologjinë tonë është botimi kritik me transkriptim dhe me një studim të gjërë filologjik e gjuhësor të veprës së Pjetër Bogdanit sipas modelit të «Mesharit» të Gjon Buzikut, përgatitur në mënyrë aq mjeshtërore nga prof. E. Çabej.

R é s u m é

L'OEUVRE DE PJETËR BOGDANI EN TANT QUE SOURCE DE L'HISTOIRE DE LA LANGUE ALBANAISE

L'ouvrage de Pjetër Bogdani «Cuñeus prophetarum» (1685) fait partie des textes anciens de la littérature albanaise qui marquent le début d'une époque très importante de la langue et de la culture albanaise, le début de l'époque de la langue littéraire.

Grâce à ces textes anciens des XVI^e-XVII^e siècles, la langue albanaise se range déjà parmi les autres langues littéraires de l'Europe avec une littérature écrite.

Les textes de l'ancienne littérature albanaise sont relativement tardifs mais abondants. La richesse des matériaux linguistiques qu'ils apportent, permet de construire presque complètement le système phonématique et grammatical de la langue albanaise des XVI^e-XVII^e siècles. L'étendue dans les temps de ces textes donne la possibilité de suivre l'évolution de la langue albanaise du XVI^e siècle à nos jours. D'autre part, la connaissance de la première période de l'albanais écrite sert d'une base sûre pour pénétrer dans les périodes plus anciennes de cette langue.

L'importance de l'ouvrage de P. Bogdani en tant qu'une source de l'histoire de la langue albanaise se révèle mieux en le mettant dans

le contexte des autres oeuvres de la littérature ancienne. Le «Meshari» (Missel) de Gjon Bozuku a la priorité d'être le premier livre de l'albanais écrit, tandis que «Cuneus Prophetarum» de P. Bogdani a la priorité d'être le premier ouvrage original de cette langue. C'est avec cet ouvrage que la littérature ancienne a obtenu le niveau le plus élevé de l'élaboration linguistique et littéraire.

Le caractère original de l'ouvrage de P. Bogdani fait que les témoignages linguistiques fournis soient plus authentiques que dans le cas des traductions.

Deuxièmement, l'ouvrage de P. Bogdani ayant un contenu large et assez varié: théologique, philosophique, historique et scientifique, a mis en lumière une grande richesse du lexique de l'albanais et plusieurs formes grammaticales et constructions syntaxiques qui ne se trouvent pas si abondamment chez les autres précédents.

Troisièmement, l'ouvrage de P. Bogdani a élargi notre connaissance sur le dialecte de l'albanais du Nord avec les parlers du nord-est.

L'ouvrage «Cuneus prophetarum» de P. Bogdani, vu dans son ensemble, fournit des données d'un grand intérêt pour la phonétique et morphologie historique de l'albanais, ainsi que pour les études étymologiques et onomastiques.

**PJETËR BOGDANI
DHE MENDIMI I TIJ PEDAGOGJIK**

Ndërsa Ballkani, ku u shtri sfera e veprimtarisë së Bogdanit, kishte mbetur prapa nga procesi i zhvillimit ekonomik, kulturor-arsimor, Evropa perëndimore kishte bërë hapa përpara. Gjatë Rilindjes së saj edhe më vonë ishin botuar vepra madhore si «Filozofia e provuar me anën e shqisave» dhe «Qyteti i Diellit» të T. Kampanelës, «Metoda për kërkime shkencore» e F. Bekonit, «Didaktika e madhe» e J.A. Komeniusit, «Arsyetimi mbi metodën» e R. Dekartit e të tjera, të cilat kishin ndikuar thellë në çuarjen përpara dhe të mendimit pedagogjik botëror. Ndërkaq në shekullin XVII ndjehej gjithnjë e ndezur fryma e luftës që ushtronte presioni i vendimeve të Koncilit të Trentos (Tridentinos) kundër rrymës luteriane-kalviniste e që në pedagogji pasqyrohej në kontradiktat në mes tezave, pikëpamjeve e praktikave të pedagogëve si Trotzendorfi, Melanhtoni, Knoksi e Shturni nga njera anë dhe J. Kalasansi, K. Boromeu dhe etnit jezuitë nga ana tjetër. Në Ballkan vazhdonte procesi

i konvertimit të popullatës në islamizëm dhe i përhapjes së institucioneve arsimore të kultit nga pushtuesi.

Në këto rrethana politike, kulturore e ideore u përgatit P. Bogdani. Në këtë periudhë u zhvillua veprimtaria e tij, në këtë kohë bëri shenjë në mjediset shqiptare origjinaliteti i punës së tij. Me veprën e tij ai solli mjaft elemente të rinj të karakterit didaktik në praktikën e transmetimit të njohurive. Pas trashëgimisë që kishin lënë në këtë fushë P. Budi, L. Matrënga, A. Bogdani dhe F. Bardhi, elementët e rinj që futi P. Bogdani shënuan hapa përpara në mendimin pedagogjik shqiptar të shekullit XVII. Nga më të rëndësishmit e tyre janë: përdorimi i gjuhës amtare shqipe si gjuhë mësimi, futja e konkretizimit të mësimi në procesin e transmetimit të njohurive, arsimimi i popullit dhe ngritja e tij kulturore përmes përfshirjes së njohurive shkencore në përmbajtjen e njësive homelike, përsnkimi i mësimi nga edukimi mendor dhe ai patriotik dhe bashkërendimi i ndërshjelltë në mes tyre, aparati shkencor i «Cuneus-it».

Në krahasim me hopet që kishte bërë shkenca në përgjithësi dhe pedagogjia në veçanti, vëmë re se edhe Bogdani në trajtimin dhe shtjellimin e përmbajtjes së veprës mori kthesen që diktonte epoka dhe njeriu i kohës.

Objekt i edukatës për te u bë njeriu, që përpiqet për të «dijtunë shekullin e dishron me xanë e me u bamë i urtë». Në funksion të këtij synimi ai përiçiu krahas doktrinës fetare informacionin shkencor. Këtu spikat dualiteti i tij. P. Bogdani shkëputet nga mugëtira mesjetare për t'u afruar me konoren, e lë mbrapa Buzukun dhe afronet me të rejat shkencore. Pra njeriu, të cilin P. Bogdani e bën objekt të edukatës së tij nuk është konceptuar vetëm në korizat e doktrinës fetare për t'u përgatitë për jetën e përtejme, por është edhe ai real, i ditës, jetësor, të cilin Bogdani do që ta arsejë, do t'i japi dije, do ta ndritë, do që të mos besojë në bestytni e paragjykime, do ta përgatisë për jetën. Të gjitha keto, sipas P. Bogdanit, litoheh përmes edukimit dhe mësimi, në bazë të të cilëve vuri të mësuarit në gjuhën amtare, që nëpërmjet «Cuneusit» u ngrit në një stad të ri, në përkatësi me kërkesat didaktike.

Ashtu si dhe pedagogu V. Ratkeja, pararendës i J.A. Komeniusit, i cili mbronte tezën se çdo gjë duhet të mësohet që në fillim në gjuhën amtare, edhe P. Bogdani mbron pikëpamjen se njohuritë duhen marrë në gjuhën e nënës. Përfitimi nga leximi i një vepre, theksonte ai, kushtëzohet

nga qëllimi që niset njeriu: «për të marrë vesh dijen në gjuhën e vet». Pra P. Bogdani si pedagog vlerësoi me të madhe mësimin në gjuhën amtare.

Shqipja si gjuhë mësimi kishte filluar të praktikohej kohë më parë se sa P. Bogdani të zhvillonte veprimtarinë e tij. Ajo hyri si e tillë në tri rrugë: nëpërmjet teksteve katekistike në formë dialogu (L. Matrënga), nëpërmjet manualeve me karakter mësimor (gramatika e A. Bogdanit, fjalori i F. Bardhit) dhe nëpërmjet mësimin që zhvillohej «in vernacula lingua» në disa shkolla që mundën të hapen në Kurbin, Pđhanë, Blinisht, Himarë e Janjevë. Por me botimin e veprës së P. Bogdanit roli i shqipes si gjuhë mësimi hyri në një fazë të re. Ajo fitoi specifikën e vet sipas kërkesave lëndore me karakter shkencor.

Shqipja e P. Bogdanit shkëputet nga mbyllja në guacën e terminologjisë fetare që qe p.sh. karakteristike për L. Matrëngën. Gjuha e P. Bogdanit e marrë në aspektin pedagogjik shquan për fjalorin e saj që përfaqëson një terminologji shkencore dhe mësimore të re. Ajo iu përgjigj me dinjitet kërkesave të transmetimit të mesazhit shkencor në shkencat natyrore e astronomike si dhe atij shoqëror, duke na dhënë në përmasa të konsiderueshme fjalorin e gjuhës së mësimin. Me këtë provoi se gjuha shqipe është një gjuhë e pasur, solide dhe e fuqishme për t'iu kundërvënë trysnisë disashekullore të pushtimit të huaj dhe njëherazi të përballjeve interpretive shkencore e filozofike me zhdërvjelltësi sa edhe gjuhët e tjera të lëvruara.

Përdorimi i gjuhës shqip si gjuhë mësimi në këtë nivel shkencor dhe me këto përmasa, qe një arritje e rëndësishme për arsimin shqip, veçanërisht një armë e fuqishme kundër shkollave në gjuhë të huaja në trevat shqiptare.

Në historinë e didaktikës sonë P. Bogdani skicoi i pari metodikën e drejtshqiptimit. Që në fillim të «Cuneus-it», nga pozita krejtësisht didaktike, jep udhëzime mbi mënyrën e leximit drejt e pa gabime të gjuhës shqipe. Ai ndikon me këtë që të fiksohen mirë te lexuesit të gjithë tinguj-fonemat e gjuhës shqipe dhe të konsolidohet drejtshqiptimi i saj.

Por gjuha shqipe megjithëse ishte element bazë për arsimimin e arbërve, duhej pasuruar dhe nga dhënia, përmes saj, e njohurive shkencore, pa të cilat shoqëria nuk ecën përpara. P. Bogdani i bëri njohuritë shkencore objekt të përmbajtjes së ligjëratave të «Cuneus-it». Vëllimi i tyre nga ana sasiore dhe e larmisë ka peshën e vet, kurse nga

ana cilësore, duhet vlerësuar për rolin formues që ka. Informacioni shkencor është futur mbi bazën e kriterëve që po ndiqnin shkollat evropiane bashkëkohore, të cilat kishin filluar të përfshinin në programet e tyre shkencat e natyrës. P. Bogdani, nuk u ndrojt të përfshijë në veprën e tij njohuri shkencore, duke u mbështetur në të dhënat e savantëve, filozofëve, matematikanëve, kozmografëve, poetëve etj. Me këto të dhëna ai futi në përmbajtjen e mësimin elementin shkencor dhe historinë e Arbërisë, dy drejtime që kishin të bënin me dhënien e individualitetit arsimit tonë, në krahasim me shkollat e huaja që funksiononin në trevat shqiptare.

Në informacionin shkencor që përfshiu ai dha njohuri për trupat qiellorë me hollësi deri në madhësitë e tyre, shpjegoi eklipsin e Diellit e të Hënës, baticat e zbaticat; shtjelloi shadërrimet e ujit në avuj, në shi, vesë, brymë, mje-gull, borë e akull; shpjegoi funksionet e skeletit të njeriut, rolin e punës në bujqësi; përshkroi ndërtimin e veprave të mëdha të artit si produkt i aftësive të njeriut; zbuloi lashtësinë e Arbërisë dhe na dha të dhëna për historinë e saj të re deri te kryengritjet antiosmane të shekullit XVII; përshkroi malet, fushat, lumenjtë, qytetet, pasuritë nënto-kësore e mbitokësore të saj.

Për të justifikuar përfshirjen e këtij informacioni në një libër, destinacioni i të cilit ishte edukimi fetar, ai shfaqësohet duke thënë: «nuk më duket se bëmë keq duke përfshirë në këtë libër disa nocione të shkencave të natyrës».

Në historinë e arsimit shqiptar P. Bogdani çel i pari rrugën e përdorimit të ilustrimeve si mjet konkretizimi. Duke iu përmbajtur sentencës se asgjë nuk bëhet pronë e trurit pa kaluar më parë nëpër shqisë. P. Bogdani e vlerësoi konkretizimin si një didakt i mirë dhe për kushtet që pati e realizoi atë me nivel didaktik-metodik. Njohurive shkencore iu bashkëngjiti ilustrimet.

Konkretizimi figurativ në veprat me karakter mësimor ishte i dukshëm edhe para P. Bogdanit. Matematikani dhe astronomi ynë, pedagogu Gjon Gazulli, i ka përdorur ato dy shekuj para Bogdanit. Por në funksion didaktik, për konkretizimin e mësimin në një tekst shkollor, ilustrimet gjetën përdorim të gjerë nga J. A. Komeniusi me botimin e tekstit mësimor «Bota ndijore në figura», ku parimi i konkretizimit gjen zbatim në planin metodik, në bazë të shtjellitimit që ky pedagog kishte bërë te vepra «Didaktika e madhe» (1632). «Cuneus-i» i P. Bogdanit nuk ka atë vëllim figurash sa vepra

e J.A. Komeniusit, por intuita në të cilën mbështetet Bogdani dhe realizimi nga ana e tij nuk është më e pakë. Kjo për faktin se erudicioni i gjerë i P. Bogdanit si doktor i shkencave të natyrës dhe si njohës i një letërsie të pasur e diktonte nivelin e lartë pedagogjik e në disa raste origjinal të këtyre tablove me karakter mësimor-shkencor.

Përveç konkretizimit figurativ, në veprën e Bogdanit ndeshemi edhe me konkretizimin verbal, të cilin ai e shfrytëzon sidomos kur do të vejë në dukje veti morale ose ngjarje historike. Ky konkretizim merr shpeshherë formën e tregimit, këshillës, rrjedhojës. Në bazë të tij qëndron raporti shkak-pasojë. Shembujt konkretë ai i merr nga vendlindja, nga jeta e dheut të Arbërit, nga cilësitë që i dallojnë arbërit, duke u mbështetur gjithnjë në përfytyrime të qarta.

Mbështetja e P. Bogdanit në parimin e konkretizimit ka një bazë të shëndoshë shkencore. Ilustrimet për Sferën e rruzullimit, Eklipsët e Hënës e të Diellit, Sibilat etj. që shoqërojnë temat e mësimt, e bëjnë «Cuneus-in» më të afërt për shfrytëzuesit dhe lexuesit e tij. Me këto ai dha një ndihmesë të re në fushën e mendimit didaktik shqiptar të shekullit XVII.

Rilindësit tanë, duke filluar nga K. Kristoforidhi me «Abetaret» e në vazhdim Samiu me «Gjithësinë», Nami me «Dituritë», Gjergj Qiriazi me «Fisikën», përse i përket ilustrimit të librave të tyre ecën në vazhden e trashëguar nga P. Bogdani. Kjo provon historikisht se ne kemi traditën tonë të përpunuar që ze vend në historinë e mendimit pedagogjik që nga shekulli XVII.

Në veprën e P. Bogdanit përveç edukimit fetar që jepet përmes doktrinës tomiste, kemi të pranishëm edhe edukimin mendor, edukimin moral, edukatën e punës dhe aftësimin gjuhësor, që jepet sidomos nëpërmjet njohurive shkencore dhe «të duhmeve», siç i quan J. Vretoja.

Lidhur me edukimin mendor, duhet pasur parasysh se P. Bogdani e shkroi veprën e tij kur mendimin pedagogjik evropian e përshkonin dy rryma të fuqishme: racionalizmi, që për bazë të njohjes merrte principet ose proceset e brendshme të arsyes, duke e arritur këtë përmes metodës deduktive si dhe empirizmi, që për bazë të njohjes merrte përvojën, duke e arritur këtë përmes metodës induktive. Ndodhëse në shtrimin dhe zberthimin e të dhënave me karakter shkencor P. Bogdani priret dukshëm nga racionalizmi, duke u mbështetur në të menduarit, siç është rasti kur shpjegon

dukuritë natyrore, në disa raste ai merr për bazë edhe përvojën. Mendjen ose të menduarit P. Bogdani e merr si bazë të të kuptuarit. Vetëm «njeriu, — pohon Bogdani, — është i lirë në veprimet e veta: mundet të bëjë ose mos të bëjë, gjithë qish do».

Tërësia e njohurive që përfshihen në «Cuneus», siç janë ato mbi Kozmosin, Tokën, dukuritë natyrore, ngjarjet historike etj., përbën një bazë të shëndoshë për zhvillimin e përgjithshëm mendor dhe intelektual të përdoruesve të këtij teksti.

Ndërsa shkolla e periudhës bogdaniene mbështetej mbi kujtesën dhe jepte një mësim abstrakt dhe urdhërdhënës, normativ e dogmatik, P. Bogdani shkëputet herëpashere nga kjo traditë. Sipas tij rruga e njohjes shkon nëpërmjet të menduarit, në bazë të së cilit ai ve dy shqisat kryesore: të parit dhe të dëgjuarit.

Ai megjithëse nuk e citon Xhon Lokun, kur sjell tezën «Nihil est in intellectu, quod non prius fuerit in sensu», por i referohet filozofit (që nënkupton Aristotelin), i përmbahet tezës themelore të sensualizmit, çka hamendëson se ai duhet të ketë qenë në dijeni. Nga një analizë e bërë rreth pohimeve të P. Bogdanit si anatomist dhe pedagog njëkohësisht, vëmë re që ndijimet ai i konceptoi nga pozita shkencore, nga një kënd realist, larg mistifikimit të tyre. Ai gjeti tek ato një veçori kryesore, pikën ku bashkohet bota subjektive me atë objektive. Në këto raste ai largohet nga mësimi dogmatik. Kjo bën pjesë në ato ndihmesa të mëdha që P. Bogdani dha në fushën e mendimit pedagogjik të periudhës kur ai jetoi.

Edukata morale në «Cuneus» ka vendin e vet dhe tiparet e kohës. Duke u përqëndruar te ky aspekt, i cili e përshkon veprën si një nga lajtmotivet kryesorë ideorë të saj, nuk kemi aluzione as për «moralin» që na paraqet këtu argjipeshkvi P. Bogdan, as për «freskinë» e edukatës që ruan kjo vepër. Natyrisht me tërë ndryshimet shoqërore, politike, ideologjike etj. që ka pësuar shoqëria gjatë këtyre 300 vjetëve e bëjnë të largët dhe të vështirë për të gjetur këtu aktualen. Por, në bazë të atyre normave morale që njerëzimi i ka pranuar gjithnjë si absolute, siç janë p.sh. të duash vendin tënd, prindërit, shokët, të thuash të vërtetën, të mos tradhëtosh, të mos përvetësosh, të mos përtosh etj. do vlerësuar edhe P. Bogdani. Megjithatë këto «të duash» P. Bogdani i përfshiu në tekstin bibliik, nga ana didaktike ato

kanë vlerat e tyre mësimore-edukative në këndvështrimin historik, sepse hedhin dritë mbi drëjtimitet që kishtë edukata e arbërve në shekullin XVII. Paralelizma me këto do të gjejim dhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në se do të ndaleshim për një studim të krahasuar.

P. Bogdani ka bërë edhe *periodizimin e moshave të njeriut*. Moshën 14-22 vjeçare e njih si periudhën e të mësuarit dhe të përvetësimit të dijeve, që e përgatit djelmëninë për shekullin. Në historinë e pedagogjisë sonë ai është i pari që përcaktoi moshën e të mësuarit dhe zgjatjen e saj tetë vjet. P. Bogdani me këtë periodizim nuk ka pretendimin e grupimit të tyre në vartësi të hallkave shkollore.

Një dukuri e re me shumë rëndësi në historinë e librit shqiptar është *aparati shkencor* që i bashkëngjitet tekstit. Ky aparat përfshin këta komponentë: 1. Udhëzime metodike për të lexuar pa gabime gjuhën shqipe, 2. Treguesi i termave më të rëndësishme që përfshihen në këtë vepër (= *Indice delle cose piu notabili che si contengono in quest'Opera*), 3. Kallëzori i shkallëve e i ligjëratave me sa të tjera kafshë (që) janë shkruem ndë këtë librë», 4. Pasqyra kronologjike e ngjarjeve më të shënuara historike e titulluar «Për mbi të gjashtë jetët e shekullit», 5. Referencat e citatet, nxjerrë nga vepra të autorëve të lashtë: poetë, filozofë, shkencëtarë, teologë etj.

Aparati shkencor ka funksion didaktik. Ai është ndër-tuar mbi bazën e një konceptimi të shëndoshë metodik-praktik që të ndihmojë lexuesit ose shfrytëzuesit për të kuptuar dhe zbërthyer sa më mirë përmbajtjen e «Cuneus-it».

Nga ana tjetër, qenia e një aparati shkencor që në atë kohë, në një botim shqip, ku lexuesit, në vazhdim të përmbajtjes i vihej në dispozicion një aparat i tillë shkencor, tregon se në Arbëri ekzistonte që në shekullin XVII një publik i ngritur nga ana intelektuale, që dinte të shfrytëzonte vepra të këtij niveli për qëllim arsimimi e kulture.

Fragmentet dhe citatet që sjell P. Bogdani bënë që të flasin shqip: Homeri, Platoni, Aristoteli. Virgjili, Avarroesi etj. Me këtë ndihmesë hyri në historinë e letërsisë shqipe si përkthyesi i parë i autorëve greko-latinë, e të tjerë. Nëpërmjet «Cuneus-it» shqiptarët, ndonëse në mënyrë fragmentare, u bënë të niohur që para tre shekujsh, jo vetëm me letërsinë fetare biblike, por edhe me botën e kulturës së lashtë klasike dhe arritjet shkencore e nëpërmjet të dhënave të ndryshme edhe me historinë e prejardhjes së tyre.

Kjo qe një armë tjetër që i shtohet rezistencës që bënin
arbrit për të mos u asimiluar.

Vepra e P. Bogdanit, me risitë që solli në fushën e me-
ndimit pedagogjik shqiptar, dallohet për individualitetin e
saj. Aty gjejmë të skicuar për të parën herë metodikën e
drejtshqiptimit, shohim të realizuar parimin e konkretizimit
të mësimi, të përfshirë informacionin shkencor në përma-
sat e një programi mësimor. Me ekstraktet e shumta të vje-
lur nga autorë të ndryshëm klasikë ajo përfaqëson në vet-
vete një mikrokrestomaci. Duke qenë dygjuhëshe shërbeu
edhe si një metodë mësimi e gjuhës së huaj. P. Bogdani na
dha i pari modelin e pajisjes së një teksti me aparat shken-
cor.

Vetëdijen atdhetare ai e ngriti në vetëdije ideore.

Ndaj përsërisim: në veprën e tij Arbëria takohet me
Evropën.

R é s u m é

PJETËR BOGDANI ET SA PENSEE PEDAGOGIQUE

Dans l'histoire de l'école et de la pensée pédagogique albanaise
du XVII^e siècle Pjetër Bogdani occupe une place de premier ordre par
les nouveautés qu'il apporta dans le domaine théorique et pratique.
Ses principales idées sont: la langue maternelle devient langue d'en-
seignement; l'information scientifique est comprise dans un pro-
gramme d'enseignement; il donne également le modèle de la struc-
turation de l'appareil scientifique d'un texte; il réalise le principe
de la concrétisation à travers les illustrations de «Cuneus»; il donne
à la bibliothèque albanaise les éléments d'une microchrestomatie des
auteurs classiques grecs et latins etc., à travers des fragments, des
maximes et leurs citations.

En ce qui concerne la langue P. Bogdani abaucha le premier la

méthode de sa orthoépie. Il fit cela en bon connaisseur des 36 sons-phonèmes de la langue albanaise et en connaisseur également des systèmes phonétiques de beaucoup de langues étrangères.

Mais il faut s'avoir bien aussi le fait que la langue albanaise était entrée à l'usage scolaire avant P. Bogdani, par les textes du catéchisme, tel celui de Matrënga par les manuels scolaires comme c'était la grammaire de A. Bogdani et le dictionnaire de F. Bardhi et enfin par les écoles ouvertes à Kurbini, Pdhana, Blinishti, Himara et Janjeva, dans lesquelles l'enseignement se fai sait en langue vernaculaire «in vernacula lingua». P. Bogdani mena plus avant la langue.

Dans cet article l'auteur souligne également que P. Bogdani est le premier à nous avoir fourni le modèle de l'appareil scientifique du texte, ce qui témoigne d'une technique élevée dans la conception et la structure d'un texte. Il comprend: les instructions méthodiques afin de lire sans fautes la langue albanaise: l'index alphabétique des termes les plus importants, les tableaux chronologiques des événements historiques les plus importants ainsi que les nombreuses références tirées des théologues, des poètes, des philosophes, des scientifiques etc. Ceci témoigne du fait qu'au XVII^e siècle en Albanie il y avait une couche d'intellectuels qui exploitaient des oeuvres d'un bon niveau.

L'auteur s'arrête également à l'information scientifique comprise dans l'oeuvre de P. Bogdani, en en faisant une évaluation tant du côté quantitatif que qualitatif. Du côté quantitatif il souligne que l'information vient de divers domaines: des sciences naturelles, de l'astronomie, de l'histoire, de la géographie, de la philosophie, de l'éthique, de la psychologie etc.. Par ces données il comprend l'élément scientifique et l'histoire de l'Albanie dans le contenu de l'enseignement, deux aspects qui visaient à donner à notre enseignement l'empreinte de l'individualité nationale face aux écoles étrangères qui fonctionnaient dans les contrées albanaises.

Le problème des illustrations qui est à la base du principe de la concrétisation de l'enseignement, constitue une contribution particulière de niveau didactique dans l'histoire de la pédagogie albanaise. En somme l'oeuvre de P. Bogdani, par le nouveautés apportées présente l'individualité de l'école albanaise du XVII^e siècle.

PASQYRA E LËNDEËS

	Faqe
Dy fjalë lexuesit	5
Fjala e hapjes	10
Fjala e mbylljes	11
A. KOSTALLARI Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe	17
K. FRASHËRI Pjetër Bogdani dhe lëvizja çlirimtare në shekullin e 17-të.	53
Z. XHOLI Pjetër Bogdani — humanisti ynë i shquar.	85
M. DOMI Pjetër Bogdani dhe letërsia e vjetër shqipe.	115
E. SEDAJ Poezitë origjinale dhe të përkthyerat të Pjetër Bogdanit.	127
S. MANSAKU Vepra e Pjetër Bogdanit si burim për historinë e gjuhës shqipe.	145
SH. OSMANI Pjetër Bogdani dhe mendimi i tij pedagogjik.	159

Pjetër Bogdani dhe v
gjegjës: A. Kostallari
... cm. — (Akad. e
Shqipërisë. Inst. i G
sisë. Sekt. i Historisë
mastikës) / Kostalla
// Bogdani, Pjetër p

809.198.3(092)

891.983(092)(0

008(496.5)(092)

929:809.198.3(0

B 72

Tirazhi 1500 kopje

Forma

Shtypur Kombi

Shtypshkronja «8 Nën

epura e tij / Red. për-
— T., 1990. — 172 f.;
shkencave e RPS të
juhësisë dhe i Letër-
së gjuhës dhe i Ono-
ri, Androkli etj. red.
r atë.

(063) +

(063) +

(063) +

(063) [Bogdani, Pjetër]

ti 60x88/16

Stash 2204-82

nati Poligrafik

tori» — Tiranë, 1991